بسم الله الرحمن الرحيم

**ME EMRIN E ALLAHUT**
**TË GJITHËMËSHIRSHMIT, MËSHIRËPLOTIT**

FONDACIONI I KUR’ANIT
SHQIPËRI

# DRITA E KUR’ANIT

**REVISTË SHKENCORE E HULUMTIMEVE
DHE E STUDIMEVE KUR’ANORE**

# THE LIGHT OF THE QUR’AN

**SCIENTIFIC JOURNAL OF QUR’ANIC
RESEARCHES AND STUDIES**

TIRANË, 2014

**Drejtor:** H. Vullnet MERJA

**REDAKSIA:**

Prof. dr. Hajri SHEHU ***(kryeredaktor)***

Sabrie FEZA ***(zëvendëskryeredaktore)***
Prof. dr. Bedri BYLYKU ***(anëtar)***
Prof. dr. Feti MEHDIU ***(anëtar)***
H. Jetmir ÇELA ***(anëtar)***
H. Sulejman efendi REXHEPI ***(anëtar)***
H. Selim STAFA ***(anëtar)***

**Sekretare dhe redaktore:** Liseda RAMAJ

**Korrektura teknike:** Vjollca KARAJ

**Përkthyesit:** Mentor ÇADRI, Jetmir ÇELA, Bledar SHEHU

©: Fondacioni i Kur’anit

Del katër herë në vit.

Viti VIII, 2014, Nr. 1 (28)

Shtypur në Shqipëri, në shtypshkronjën “LILO”

**ISSN 2309-3668**

**Adresa e redaksisë:**
Fondacioni i Kur’anit
Rruga “Hoxha Tahsin”, Nr.168, Kutia Postare: 8272
Tel & Fax: 00355 4 2377311 Tirana – Albania
Website: www.fqurani.com E_mail: f_quran114@yahoo.com

**Director:** Haji Vullnet MERJA

**EDITORIAL BOARD:**

Prof. Dr. Hajri Shehu **Editor-in-chief**
Sabrie FEZA **Vice-Editor-in-chief**

Prof. Dr. Bedri BYLYKU **Member**
Prof. Dr. Feti MEHDIU **Member**
Haji Jetmir ÇELA **Member**
Haji Sulejman ef. REXHEPI **Member**
Haji Selim STAFA **Member**

**Secretary and editor:** Liseda RAMAJ
**Proofreader:** Vjollca KARAJ
**Translators:** Mentor ÇADRI, Jetmir ÇELA, Bledar SHEHU,

©: Foundation of the Qur'an – Albania

A Quarterly Journal

Vol 8, issue 28, 2014

Printed in Albania by "LILO" Printing House

**ISSN 2309-3668**

**Address of the Editorial Board:**
Fondacioni i Kur'anit
Rruga "Hoxha Tahsin", Nr.168, Kutia Postare: 8272
Tel & Fax: 00355 4 2377311 Tirana – Albania
Website: www.fqurani.com E_mail: f_quran114@yahoo.com

# PASQYRA E LËNDËS

Koncepti i dashurisë për Zotin..............................................9
UMM ABDUR RAHMAN HIRCHFELDER
Të drejtat e Profetit Muhamed ...........................................15
ABDU DAIM AL KAHIIL
Argumente shkencore nga Kur'ani IV................................26
VULLNET MERJA
Çështje të moralit sipas Kur'anit.........................................41
XHEMAL BALLA
Personaliteti i njeriut në dritën e Kur'anit...........................49
HAJRI SHEHU
Rreth betimeve sipas Kur'anit.............................................55
HAJRI MANDRI
Estetika e ligjërimit në Kur'an..............................................65
Trashëgimia kur'anore te shqiptarët: Surja "El-Gashije".....77
ALI MUHAMED ALI DUHAJJIL DEHILI
Profeti Hud...........................................................................80
QANI BANAJ
Për çdo sëmundje ka ilaç: Mjalti .........................................87
HOXHA TAHSIN
Sekretet e ujit........................................................................94
Fjalor kur'anor: Iblisi .........................................................101
LISEDA RAMAJ
Bibliografi e revistës "Drita e Kur'anit", 2013...................105
Botime.................................................................................110
Veprimtari kur'anore..........................................................113
Përmbledhjet në gjuhën angleze........................................116
Përmbledhjet në gjuhën arabe...........................................123

# TABLE OF CONTENTS

The Concept of Love for God..................................................9
**UMM ABDUR RAHMAN HIRCHFELDER**
The Rights of the Prophet Mohammad ...............................15
**ABDU DAEM AL KAHEEL**
Scientific Arguments from the Qur'an IV...........................26
**VULLNET MERJA**
Questions on the morality according to the Qur'an...........41
**XHEMAL BALLA**
The Human Personality in the Light of the Qur'an.............49
**HAJRI SHEHU**
On the Oaths according to the Qur'an.....................................55
**HAJRI MANDRI**
The Aesthetic Discourse in the Qur'an.................................65
Surah "Al-Ghashiyah"...........................................................77
ALI MUHAMED ALI DUHAJJIL DEHILI
The Prophet Hud ..................................................................80
**QANI BANAJ**
There is a remedy for evry disease: Honey..........................87
**HOXHA TAHSIN**
The Secrets of Water............................................................94
Qur'anic glossary: Iblis....................................................... 101
LISEDA RAMAJ
Bibliography of "Drita e Kur'anit" Journal, 2013................105
Publications.........................................................................110
Quranic Activities...............................................................113
Summaries in English.........................................................116
Summaries in Arabic...........................................................123

# المحتويات


مفهوم الحب لله.................................................... ٩

أم عبد الرحمن هرتشفَلْدَر

حقوق النبي (عليه الصلاة والسلام)........................ ١٥

عبد الدائم الكحيل

أدلة علمية من القرآن (٥)............................... ٢٦

وُلْنَتْ مَرْيا

الخُلُق في القرآن الكريم.................................. ٤١

جمال بالا

شخصية الإنسان في ضوء القرآن الكريم.................. ٤٩

خيرى شهو

حول الاقسام فى القرآن..................................... ٥٥

خيري ماندري

جمالية الخطاب في القرآن.................................. ٦٩

التراث القرآني عند الألبانيين- سورة الغاشية............... ٧٧

على محمد على الدحيل

النبي هود (عليه السلام)...................................... ٨٠

تشاني باناي

العسل........................................................... ٨٧

حوجا تحسين

أسرار الماء..................................................... ٩٤

المعجم القرآني - إبليس..................................... ١٠١

ليسدا راماى

بيبلوغرافيا للقرآن (بحث فهرسى) فى مجلة "نور القرآن" ٢٠١٣........ ١٠٥

منشورات....................................................... ١١٠

نشاطات علمية و قرآنية..................................... ١١٣

ملخص بالغة الانجليزية..................................... ١١٦

ملخص بالغة العربية.......................................... ١٢٣

# KONCEPTI I DASHURISË PËR ZOTIN*

Abstrakt

*Koncepti i dashurisë për Zotin dhe të mirat që sjell ky koncept për shoqërinë njerëzore është një e përbashkët për të gjitha besimet në traditën abrahamike. Për më tepër, është një e përbashkët në traditat shpirtërore të njerëzimit rreth bazave filozofike të lidhura me konceptin e dashurisë për Zotin. 'Dashuria' në përkufizimet sipas mendimeve dhe praktikës islame paraqet një pastrim (përmirësim) të konceptit në harmoni me realizimin e mesazhit të Zotit ndaj njerëzimit . Këtu, 'dashuria' shihet jo si një koncept abstrakt i mbyllur në marrëdhëniet mes Krijuesit dhe Krijimit. Përkundrazi, ajo mbart peshën e një kuptimi të plotë të Ad –Deen (fe), duke krijuar dhe duke rivendosur një bashkësi që është përkufizuar në një marrëdhënie dyfishe organike, së pari, me Krijuesin dhe së dyti, mes krijesave të Tij.*

## Tradita abrahamike para Islamit

Perspektivat e mëparshme në konceptin e dashurisë në traditën abrahamike, si një shenjë paralajmëruese për vizionin kur'anor, janë shprehur kryesisht në Judaizmin e shenjtë dhe në tekstet e krishtere të Dhiatës së vjetër dhe Dhiatës së re. Para shpalljes së Kur'anit, shihet se edhe traditat paraislame e abrahamike patën krijuar një lidhje midis konceptit të dashurisë dhe bashkësisë. Te "Daniel", 9:4, besëlidhja e Zotit me Fëmijët e Izraelit është përshkruar si një besëlidhje e dashurisë. Duhet të theksohet se në traditën çifute, besëlidhja me Zotin është me bijtë e Izraelit në tërësi. Këtu, ne shohim rolin kryesor që luan dashuria në përcaktimin e karakterit të një bashkësie. Disa arsyetime të Dhiatës së vjetër theksojnë marrëdhëniet e njeriut me Zotin si një bindje ndaj Tij të bazuar thjesht, në

* Marrë nga *Royal Aal al-Bayt Institute for Islamic Thought*

një besëlidhje të pastër. Tekstet e Dhiatës së vjetër e shohin dashurinë e të Plotfuqishmit si një nga dy pikat qendrore e besëlidhjes midis Tij dhe njerëzimit, qenieve të bindura. Ashtu si në "Daniel" cituar më lart, në "Eksodi", 20:6, Zoti premton bekimin e tij për ata që e duan dhe i binden urdhërimeve të Tij. Larg nga të qenit "hakmarrës": "**Zoti është i Mëshirshëm dhe i Dhembshur; është i Ngadalshëm në zemërim dhe i Madh në dashuri dhe besnikëri. Ai ruan dashuri për mijëra. Ai është Falës i ligësive, i rebelimeve dhe i mëkateve.**" ( Eksodi 34:6-7 ). Kështu, besëlidhja me Zotin, siç përshkruhet në Dhiatën e vjetër është e bazuar në të dyja: në dashuri dhe në bindje. Ndërsa besëlidhja me Zotin është një temë qendrore në shkrimet e shenjta çifute, tradita e krishterë flet për dashurinë si urdhërimi i parë dhe i madh, mbi të cilën varen të gjitha ligjet dhe kërkesat e tjera. (Mat. 22:34-40 ). Kështu, në Dhiatën e re, inkurajimi për dashurinë është dhënë shpesh në format e fjalëve që i ngjajnë urdhërimeve. Kështu, Zoti urdhëron: "**Të duash Zotin, Perëndinë tënd, me gjithë zemër, shpirt dhe forcë**." (Duet, 6:4-5; Marku, 12:29-30 ) dhe "**Të duash të afërmit e tu si veten tënde.**" (Lev 19:18). Në traditën shpirtërore abrahamike si dashuria për Zotin, edhe dashuria për fqinjin është e theksuar. Kështu, dashuria në traditën abrahamike shtrihet nga marrëdhëniet e dikujt me Krijuesin. Në të vërtetë, kjo bëhet themeli i bashkësisë. "**Zoti respekton besëlidhjen e Tij të dashurisë me të gjithë ata që e duan dhe i binden urdhrave të Tij.**" (Daniel, 9:04)

## Tradita kur'anore

Dashuria është prirje e natyrshme e njeriut drejt një objekti që i jep gëzim.[1] Ajo është magnetizëm[2] që tërheq njërin ndaj tjetrit. Dashuria ndaj Allahut të Plotfuqishëm

1 Imam el – Gazali.
2 Shejh Muhamed Zoki Syed Shah, *Sar - e- Dilbaraan*.

është një atribut i besimtarëve. Ajo është magnet absolut për zemra e njeriut. Dashuria e besimtarëve është e veçantë në aspektin e fuqisë së saj dhe për këtë arsye, i bën ata të dallojnë në sjelljet dhe në veprimet e tyre. Kjo është një shenjë e besimit të plotë dhe të përsosur (Imanit). Për këtë arsye kjo dashuri është e përhapur kudo dhe e paprekur nga kushtet e jetës gjithnjë në ndryshim. Fjala kur'anore *hubb* është rrënja e fjalës *muhabbah* (dashuri). Ajo e ka prejardhjen nga fjala arabe *habe* (farë)[3]. Kështu shpjegon origjinën e saj me lidhjen mes lindjes së njeriut dhe natyrës së brendshme të tij. Dashuria është futur brenda nesh me natyrën. Me kalimin e kohës, ajo rritet brenda nesh dhe përfshin të gjitha aspektet e modelet e sjelljes njerëzore. Po kështu, dashuria për Krijuesin mbillet në krijimin e njeriut. Kjo dashuri është nderi që njerëzimi mbart duke dalluar nga krijesat e tjera.

## Drejtësia si një mjet për të fituar dashurinë e Zotit

Në vizionin islam të *hubb* ka disa metoda për të tërhequr dashurinë e Zotit. Një nga këto metoda është vendosja e drejtësisë. *Hubb* është e lidhur rrënjësisht me vendosjen e drejtësisë dhe ndershmërinë në komunitet. Kur dashuria ofron motorin për rritjen ekonomike të një shoqërie, atëherë ajo shoqëri është ndërtuar mbi ngrehinën e drejtësisë. Kjo është në qendër të Islamit si vizion i progresit njerëzor. Kur'ani thotë se rezultati i themelimit të drejtësisë është dashuria e Zotit për themeluesit e drejtësisë. Drejtësia duhet të vendoset në marrëdhënien e dikujt me Krijuesin, duhet brenda familjes, në sferat ekonomike dhe ligjore, në sferat politike dhe shoqërore në përgjithësi etj. Edhe një herë, ne e shohim rolin kryesor që luan dashuria në krijimin dhe zhvillimin e komunitetit.

3 Shejh Zulfiqar Ahmed, *Dashuria për Pejgamberin* (Chicago: Faqir Publikime).

## Pastërtia si një mjet për të fituar dashurinë e Zotit

Një tjetër metodë për të tërhequr dashurinë e Zotit ndaj komunitetit është arritur me anë të pastërtisë në çdo formë, si fizike, ashtu edhe shpirtërore. **"Në të vërtetë, Ne i kemi nderuar bijtë e Ademit…"** ("El- Isra": 70). "**Allahu nuk ju ndalon të silleni mirë dhe të jeni të drejtë ndaj atyre që nuk luftojnë kundër jush për shkak të fesë dhe që nuk ju dëbojnë prej shtëpive tuaja. Me të vërtetë, Allahu i do të drejtët**." **("El– Mumtehine" : 8)** **"…Allahu i do ata që veprojnë me drejtësi."** ("El- Huxhurat": 9) "**...Allahu i do ata që pastrohen shpesh."** ("Teube": 108) Në Kur'an thuhet se Zoti i do ata që e bëjnë veten të pastër. Kjo pastërti i përshkon të gjitha aspektet e shoqërisë, duke filluar me nivelin individual dhe të gjitha aspektet e ndërveprimit të komunitetit brenda vetvetes. Kjo tregon rolin që mund të luajë jeta e komunitetit në tërheqjen e dashurisë së Zotit në drejtim të zhvillimit të komunitetit.

## Veprat e mira si një mjet për të fituar dashurinë e Zotit

Veprat e mira janë mjete të tjera, me të cilat komuniteti mund të tërheqë dashurinë e Zotit. Allahu thotë: "**Në të vërtetë, atyre që besojnë dhe bëjnë vepra të mira, i Gjithëmëshirshmi do t'u dhurojë dashuri."** ("Merjem": 96) Natyrisht, veprat e drejta nuk duhet të jenë vetëm individuale, por edhe vepra të mira në nivelin e familjes dhe të komunitetit. Kështu, duke ngulitur vepra të mira në nivel të përbashkët arrihet një tjetër mjet për të tërhequr dashurinë e Zotit.

## Dashuria e Zotit dhe përmbushja e detyrimeve të bashkësisë ndaj Tij

Duhet të theksohet se dashuria e Zotit për komunitetin është e lidhur edhe me përpjekjen e komunitetit në rrugën e Tij dhe në përmbushjen e detyrimeve të komunitetit ndaj Zotit. Zoti paralajmëron në Kur'an se nëse bashkësia e besimtarëve do të largohej nga feja, Ai do ta zëvendësonte atë bashkësi me një komb, të cilët, Allahu do t'i donte dhe ata do ta donin Allahun. "**Në të vërtetë, atyre që besojnë dhe bëjnë vepra të mira, i Gjithëmëshirshmi do t'u dhurojë dashuri.**" ("Merjem": 96 )

## Ta duash Krijimin është përmbushje e dashurisë së Zotit

Kur bashkësia tërheq dashurinë e Zotit, formohet themeli i komunitetit. Zemrat janë të tërhequra me njëra-tjetrën. Profeti (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!) i ka urdhëruar besimtarët që të duan për vëllezërit e tyre atë që duan për veten e tyre. Prandaj, për të dashur atë që ka krijuar Allahu, atë që Ai ka urdhëruar në dashuri, është në të vërtetë një përmbushje e dashurisë për Allahun. Kështu, në mendimin islam dashuria për Allahun dhe dashuria për Krijimin e Tij janë të ndërthurura. Për shembull, Allahu thotë: "**Të gjithë mbahuni fort për litarin e Allahut (Kur'anin) dhe mos u përçani! Kujtoni dhuntinë e Allahut për ju, sepse, kur ishit në armiqësi, Ai i pajtoi zemrat tuaja e, në saje të dhuntisë së Tij, u bëtë vëllezër. Dhe ju ishit buzë greminës së zjarrit, ndërsa Ai ju shpëtoi prej saj. Kështu, Allahu jua shpjegon shpalljet e Veta, që ju të drejtoheni në udhën e drejtë." ("Al – Imran": 103)** Kështu, lidhja e përbashkët e dikujt me Zotin dhe dashuria, i kthen armiqtë në vëllezër. Ajo gjithashtu, mban premtimin e një komuniteti që garon për dashurinë e të Plotfuqishmit. Dashuria për Krijuesin duhet të pasqyrohet në dashurinë për atë që ka krijuar Ai. Këtu fjala *hubb* gjen mbështetje nga

koncepte të tjera të fuqishme, të tilla si: *Rrahman* dhe *Ihsan*.

## Përfundim

Koncepti i dashurisë për Zotin ndërlidhet me konceptin e dashurisë për atë që ka krijuar Ai. Kjo është një temë e zakonshme jo vetëm në Kur'an, por edhe në traditat abrahamike si të mishëruara në Dhiatën e vjetër dhe të re. Siç shihet më lart, dashuria, në këtë kuptim të plotë të saj, ka fuqinë të jetë baza e krijimit dhe e zhvillimit të jetës në komunitet.

**Umm Abdur Rahman Hirchfelder**

# TË DREJTAT E PROFETIT MUHAMED

*(paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!)*[1*]


Abstrakt

*Nuk ka asnjë dyshim se e drejta e parë e Profetit tonë (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!) është të besojmë në atë dhe në mesazhin, me të cilin ai u dërgua. Allahu thotë: "Besoni në Allahun dhe në të Dërguarin e Tij dhe në dritën që Ai zbriti." (64:8) Atëherë, të besosh në Profetin (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!) do të thotë të jetosh sipas udhëheqësísë së Allahut. Të besosh në Profetin (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!) është shumë më shumë sesa një njohje e thjeshtë e faktit se ai është Profet. Një e drejtë tjetër që i përket Profetit tonë të dashur (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!) është që ne t'i bindemi atij. Allahu thotë: "O ju që keni besuar! Bindjuni Allahut dhe të Dërguarit të Tij…!" (Surja 8:20) Dashuria për Profetin (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!) është detyrim, që vjen me shpërblim të madh. Ta respektosh Profetin (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!) do të thotë, gjithashtu, të respektosh familjen e tij. Një e drejtë shumë e rëndësishme e Profetit Muhamed (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!) është t'i dërgosh atij salavate dhe selame.*


1 * Marrë nga Al Jumuah, vëll. 11, nr. 3. E përktheu nga gjuha angleze Bledar Shehu.

## Të besosh në Profetin *(paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!)*

Nuk ka asnjë dyshim se e drejta e parë e Profetit tonë (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!) është të besojmë në atë dhe në mesazhin, me të cilin ai u dërgua. Allahu thotë: "**Besoni në Allahun dhe në të Dërguarin e Tij dhe në dritën që Ai zbriti**." (Surja 64:8). Kadhi Ejadhi ka thënë në librin e tij të njohur dhe të rëndësishëm për të drejtat e Profetit, "Ash - Shifaa": "*Besimi në Profetin Muhamed (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!) është detyrim për çdo njeri. Besimi nuk është i plotë pa atë dhe Islami është i vlefshëm vetëm me të*." Allahu e ka lidhur besimin në Të (Allahun) me besimin në të Dërguarin e Tij. Këto dy besime janë të pandashme. Kjo është ajo që thotë shehadeti - dëshmia e besimit. Madje, edhe kur një njeri ndjek profetë të tjerë, si Musanë dhe Isanë (paqja e Allahut qoftë mbi ta!), ai nuk është besimtar derisa të ndjekë plotësisht mësimet e Muhamedit (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!). Ebu Hureire ka transmetuar se i Dërguari i Allahut (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!) ka thënë: "*Jam urdhëruar t'i luftoj njerëzit derisa ata të dëshmojnë se nuk ka zot tjetër përveç Allahut dhe të besojnë tek unë dhe tek ajo që kam sjellë. Kur ta bëjnë këtë, gjaku i tyre dhe pasuria e tyre mbrohen nga unë për të drejtën (që kanë). Gjykimi i tyre është tek Allahu*." (Buhariu dhe Muslimi).

Atëherë, të besosh në Profetin (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!) do të thotë të jetosh sipas udhëheqësísë së Allahut. Të besosh në Profetin (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!) është shumë më shumë sesa një njohje e thjeshtë e faktit se ai është Profet. Allahu thotë: "**Kur vijnë tek ti dyfytyrakët, thonë: 'Ne dëshmojmë se ti je, vërtet i Dërguari i Allahut.' Allahu e**

**di se ti je i Dërguari i Tij, por Ai dëshmon se dyfytyrakët janë gënjeshtarë.'"** (Surja 63:1).

Në kohën e Profetit Muhamed (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!), hebrenjtë që jetonin në Arabi, ishin në pritje të Profetit të premtuar, që ata e dinin nga Libri i tyre. Por, kur Profeti Muhamed (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!) erdhi, ata e mohuan nga arroganca e tyre, sepse ai nuk ishte hebre. Shumë nga rabinët e njihnin se ai ishte Profet, por nuk e pranonin atë ose nuk i besonin atij. Allahu thotë për ata: "**Ata, të cilëve u kemi dhënë Librin, e njohin atë** (Profetin / paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!)**, ashtu siç i njohin bijtë e tyre, por disa prej tyre e fshehin të vërtetën, duke e ditur mirë.**" (Surja 2:146).

Ibn Is'hak tregon në jetëshkrimin e tij për Profetin (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!) se Safia bint Hujaji ka thënë: "*Unë isha fëmija që më donin më shumë babai dhe xhaxhai, Ebu Jasir. Kur unë isha aty, ata nuk i shikonin fëmijët e tjerë. Kur i Dërguari po qëndronte në Kuba me vëllanë, Amr ibn Auf, këta të dy shkuan ta shihnin atë para se të zbardhte dita. Ata u kthyen pasi ra muzgu, të lodhur, të raskapitur, kokulur. Unë u ngjita në dhomën e tyre me atë kënaqësinë fëminore si gjithmonë. Mirëpo ata ishin zhytur kaq shumë në mërzitinë e tyre, sa nuk më vunë re fare. Unë vetëm dëgjova xhaxhanë që po i thoshte babait tim: 'Ky është ai? E njeh ti atë? A je i sigurt?' 'Po', - tha tjetri. 'Dhe çfarë ndien ti për të?' 'Për Zotin, unë do të jem armik i tij sa të jem gjallë', - qe përgjigjia e tij.'"* E pra, të besosh në dikë a në diçka është më shumë se thjesht ta dish se dikush a diçka ekziston. Shejtani, siç shpjegohet në Kur'an, e di se Allahu ekziston e megjithatë ai është jobesimtari më i madh.

## T'i bindesh atij

E drejta e dytë që i përket Profetit tonë të dashur (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!) është që ne t'i bindemi atij. Allahu thotë: "**O ju që keni besuar! Bindjuni**

**Allahut dhe të Dërguarit të Tij**…!" (Surja 8:20). Allahu e ka përmendur bindjen ndaj të Dërguarit (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!) lidhurazi me bindjen ndaj Tij. Nuk mund të ekzistojnë njëra pa tjetrën. T'i bindesh të Dërguarit (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!) do të thotë të zbatosh porositë e tij dhe të qëndrosh larg asaj që ai ka ndaluar. Ebu Hureire ka transmetuar se Profeti (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!) ka thënë: "*I gjithë ymeti im do të hyjë në Xhenet përveç atyre që nuk pranojnë.*" Ata e pyetën: "*O i Dërguar i Allahut kush do të refuzojë?*" Ai u përgjigj: "*Kush më bindet mua do të hyjë në Xhenet. Kush nuk më bindet mua, nuk ka pranuar.*" (Buhari).

## Ta ndjekim atë

Allahu thotë: "**Në të Dërguarin e Allahut ka një shembull të mrekullueshëm për atë që shpreson tek Allahu dhe tek Dita e Fundit dhe e përmend shumë Allahun.**" (Surja 33:21). Kur komenton këtë ajet, imam Tirmidhiu thotë: "*Ta marrësh të Dërguarin (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!) si shembull, do të thotë ta imitosh atë me ndezulli (zell), të ndjekësh Synetin e tij dhe të mos e kundërshtosh atë as me fjalë e as me veprime.*" Ne duhet të përpiqemi t'i ndjekim mënyrën e tij të jetesës, thëniet e tij, veprimet e tij, qëndrimin e tij dhe sjelljen e tij.

Nga sahabët, ne mund të shohim mënyrën se si ata e ndiqnin pas Profetin (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!), se si ndiqin shembullin e tij dhe se si i modelonin sjelljet e tyre sipas sjelljes së Profetit (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!). Kjo është mënyra si ndiqet Profeti Muhamed (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!). Një burrë nga familja e Khalid ibn Asidit e pyeti Abdullah ibn Umerin: "*O Ebu Abdurrahman! Në Kur'an gjejmë namazin në rast rreziku dhe në shtëpi, por nuk gjejmë dot namazin kur je në udhëtim.*" Ibn Umeri i tha: "*Nipi im, Allahu na ka dërguar Muhamedin (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!), kur*

*nuk dimë diçka. Dhe ne bëjmë siç bënte ai, ashtu siç e kemi parë. "Kur Umeri pa Gurin e Zi, ai tha: "Ti je gur dhe nuk më bën dot as mirë, as keq. Po të mos ta kisha parë të Dërguarin e Allahut të të puthte ty, nuk do të të kisha puthur as unë.* "Pastaj ai e puthi gurin. Umar ibn Abdul Azis ka thënë: "*I Dërguari i Allahut bënte një Synet dhe njerëzit bënin synetet pas tij. T'i pranosh ato do të thotë të konfirmosh Librin e Allahut dhe të veprosh sipas tyre do të thotë t'i bindesh Allahut dhe ta forcosh fenë e Allahut. Askush nuk duhet ta ndryshojë Synetin, ta amendojë atë ose të shohë opinonin e atyre që e kundërshtojnë atë. Kushdo që e pason atë, është i udhëzuar. Kushdo që kërkon ndihmë nga ai, do të ketë sukses. Kushdo që e kundërshton atë dhe nuk ndjek rrugën e besimtarëve, Allahu do t'i japë atë që do dhe do të digjet në zjarrin e Xhehenemit, i cili është një fund i keq.*"

## Ta duam atë

Myslimani duhet ta dojë Profetin (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!) me shpirt. Allahu thotë: "**Thuaj: 'Nëse etërit tuaj, bijtë tuaj, vëllezërit tuaj, gratë tuaja, farefisi juaj, pasuria juaj që e keni fituar, tregtia për të cilën keni frikë se nuk do të shkojë mirë dhe shtëpitë ku e ndieni veten rehat janë më të dashura për ju sesa Allahu, i Dërguari i Tij dhe lufta në rrugën e Tij, atëherë pritni derisa Allahu të sjellë vendimin** (dënimin) **e Tij. Allahu nuk e udhëzon në rrugën e drejtë popullin e pabindur**.'" (Surja 9:24). Kurse Profeti (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!) ka thënë: "*Askush nga ju nuk do të besojë nëse nuk do të jem për ju më i dashur se fëmijët tuaj, etërit tuaj dhe të gjithë njerëzit.*" Umer ibnul Khatabi i tha Profetit: "*Unë të dua më shumë se gjithçka tjetër, përveç shpirtit tim, që është ndërmjet dy anëve të mia.*" Profeti iu përgjigj: "*Asnjë nga ju nuk ka besuar, derisa unë të jem më i dashur për të se vetë shpirti i tij.*" Umeri tha: "*Pafsha Atë që të ka zbritur ty Librin, unë të dua ty më shumë sesa shpirtin tim që është midis dy anëve të mia.*" Profeti (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!) tha:

*"Tani, po, o Umer."*

Kjo dashuri është nasihat. Nasihati përkthehet zakonisht me "këshillë e mirë dhe sjellje e çiltër". Fjala përdoret për të shënuar "dëshirën për diçka që është e mirë për dikë". Gjuhësisht do të thotë "pastërti". I Dërguari i Allahut (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!) ka thënë: "*Feja (dini) është nasihat. Feja është nasihat. Feja është nasihat.*" Ata e pyetën: "*Ndaj kujt, o i Dërguar i Allahut?*" Ai tha: "*Ndaj Allahut dhe Librit të Tij dhe ndaj të Dërguarit të tij dhe ndaj imamëve të myslimanëve dhe ndaj njerëzve të zakonshëm.*" Nasihati ndaj të Dërguarit të Allahut është të vërtetosh profetësinë e tij, t'i bindesh atij, ta përkrahësh dhe ta mbrosh atë dhe të pasosh Synetin e tij. Ebu Beker al - Axhuri ka thënë: "*Nasihati për Profetin përfshin dy lloje sjelljesh të çiltra. Njëri nasihat është gjatë jetës së tij dhe tjetri pas ndërrimit të jetës së tij. Gjatë jetës së Profetit (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!) ka qenë ndihma, mbrojtja dhe bindja ndaj tij. Pas ndërrimit të jetës, nasihati është ruajtja e nderit, e respektit dhe e dashurisë së madhe për Profetin (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!), duke ngulmuar në mësimin e Synetit të tij dhe në kuptimin e Sheriatit të tij; është dashuria për njerëzit e familjes së tij dhe për shokët e tij, duke shmangur gjëra që nuk pëlqehen në Synetin e tij dhe gjëra që të largojnë nga Syneti i tij.*"

Dashuria për Profetin (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!) është detyrim, që vjen me shpërblim të madh. Enesi ka thënë se një burrë erdhi te Profeti (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!) e pyeti: "*Kur do të vijë Ora e Fundit, o i Dërguari i Allahut?*" I Dërguari tha: "*Çfarë ke përgatitur ti për të?*" Burri tha: "*Nuk kam përgatitur shumë namaz ose agjërim ose sadaka për të, por unë i dua Allahun dhe të Dërguarin e tij.*" Profeti i tha: "*Ti do të jesh me atë që e do.*" Ai tha, gjithashtu: "*Kush më do mua, do të jetë në Xhenet me mua.*"

Dashuria për Profetin Muhamed (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!) tregohet në shumë mënyra. Njeriu duhet të parapëlqejë mbi dëshirat e tij atë me të cilën

erdhi Profeti (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!). Zemërimi i njeriut ndaj dikujt tjetër duhet të vijë për hir të Allahut. Ai duhet ta përmendë shpesh Profetin (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!). Ai duhet të ketë mall për Profetin (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!). Ai duhet ta lartësojë dhe ta respektojë Profetin (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!) dhe të përulet kur dëgjon që përmendet emri i tij. Ai duhet të ketë dashuri për Kur'anin, të cilin e solli Profeti (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!). Ai duhet të ketë mëshirë për bashkësinë (ymetin) e tij, duke u përpjekur për qëllimet dhe interesat më të mira të saj. Një shenjë tjetër e dashurisë për Profetin (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!) është se ai që e aspiron atë, nuk kërkon pasuri në këtë botë dhe parapëlqen varfërinë. Profeti (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!) ka thënë: "*Për ata që më duan mua, varfëria vjen më shpejt sesa një vërshim nga maja e malit në fund të tij.*"

## Ta respektojmë atë

Allahu thotë: "**O Profet, ne të kemi dërguar ty si dëshmitar dhe si sjellës i lajmeve të mira dhe paralajmërues. Prandaj besoni tek Allahu dhe tek i Dërguari i tij dhe ndihmojeni dhe respektojeni atë**!" (Surja 48:8, 9). Respekt për Profetin (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!) do të thotë ta nderosh atë, ta lartësosh atë, ta thërrasësh atë me titullin më fisnik, të tillë si, i Dërguari i Allahut ose Profeti i Allahut. Respekt për Profetin (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!) do të thotë ta vësh fjalën e tij mbi fjalën tënde dhe ta mbrosh atë kur të tjerët abuzojnë me të verbalisht.

Ta respektosh Profetin (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!) do të thotë, gjithashtu, të respektosh familjen e tij. Profeti (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!) ka thënë: "*Ta njohësh familjen e Muhamedit, do të thotë të shpëtosh nga Zjarri. Ta duash familjen e Muhamedit,*

*do të thotë të kalosh Siratin. Miqësia për familjen e Muhamedit është siguri nga Zjarri.*" Ai, gjithashtu, ka thënë për Hasanin dhe Hysenin, nipërit e tij: "*Kushdo që i do këta të dy dhe babanë e tyre dhe nënën e tyre, do të jetë me mua Ditën e Ringjalljes.*" Ebu Bekri ka thënë: "*Respektojeni Muhamedin duke respektuar njerëzit e familjes së tij!*"

Ta respektosh Profetin (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!) do të thotë, gjithashtu, të respektosh shokët e tij. Për ata që i dhanë besën Profetit (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!) në Hudejbije, Allahu thotë: "**Allahu është i kënaqur me besimtarët, kur t'u betuan për besnikëri nën hijen e pemës**." (Surja 48:18). Kurse Profeti (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!) ka thënë: "*Mos i fyeni shokët e mi! Edhe sikur ndonjëri nga ju të shpenzonte flori sa Uhudi, përsëri ai nuk do të peshonte sa njëri prej tyre, madje as sa gjysma e peshës së tij.*"

Po kështu, është e ndaluar të fyesh Profetin Muhamed (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!). Allahu thotë: "**Pa dyshim, ata që fyejnë Allahun dhe të Dërguarin e Tij, i mallkon Allahu në këtë botë dhe në Botën Tjetër. Ai ka përgatitur për ta ndëshkim poshtërues**." (Surja 33:57). Kurse Profeti (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!) ka thënë: "*Kush fyen një profet, vriteni! Kush fyen shokët e mi, rriheni!*"

Është e ndaluar, gjithashtu, edhe të bësh shaka për Profetin ose për Islamin. Allahu thotë: "**Nëse i pyet, ata do të të përgjigjen: 'Ne vetëm po bënim shaka dhe po luanim'. Thuaj: 'A mos vallë me Allahun, Shpalljen dhe të Dërguarin e Tij po talleni**?'" (Surja 9:65). Transmetohet se gjatë betejës së Tabukut, erdhi një burrë dhe tha: "*Nuk kemi parë njerëz më hamës, më gënjeshtarë e më frikacakë në betejë sesa Profeti i Allahut dhe shokët e tij.*" Auf ibn Malik u ngrit e tha: "*Përkundrazi, ti je gënjeshtari. Ti je dyfytyraku që mëton të jesh mysliman. Do t'i them Profetit të Allahut për ty.*" Pastaj Aufi shkoi te Profeti për ta informuar për këtë ndodhi, por mësoi se Shpallja tashmë kishte ardhur para atij. Ndërkohë, burri

i hipi devesë, kërkoi dhe e gjeti Profetin dhe i tha: "*Ne po bënim, thjesht shaka për të kaluar kohën në udhëtim.*" Ibn Umeri thotë: "*Ai u kap për rripi të shalës së devesë së Profetit, ndërkohë që ajo vraponte. Këmbët e burrit përplaseshin në tokë, ndërkohë që ai përsëriste e përsëriste: 'Por ne po bënim vetëm shaka.'*" Dhe Profeti, pa i kthyer sytë nga ai tha: "*Shaka? Shaka me Allahun, me Shpalljen e tij? Shaka me Profetin e tij?*"

## Të gjykojmë sipas Sheriatit të tij

E drejta e Profetit Muhamed (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!) është të gjykojmë sipas atij dhe të jemi të kënaqur me gjykimin e tij. Allahu thotë: "**O ju që keni besuar! Bindjuni Allahut, bindjuni të Dërguarit dhe atyre që drejtojnë punët tuaja! Nëse nuk pajtoheni në ndonjë gjë, drejtojuni Allahut dhe të Dërguarit, nëse besoni Allahun dhe Ditën e Kiametit! Kjo për ju është më e mira dhe shpjegimi më i bukur**." (Surja 4:58). Prandaj, është detyrë për ne të shohim në Kur'an dhe në hadithet e të Dërguarit të Allahut (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!) kur kemi ndonjë pyetje për diçka. Ne duhet të ndjekim ligjet që solli Profeti Muhamed (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!), të gjykojmë sipas tyre dhe të drejtojmë sipas tyre.

Në kohën e Profetit (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!), njëherë, kur ai po këndonte ajetin,
"**Në vend të Allahut, ata kanë zgjedhur për zot rabinët dhe murgjit e tyre, si dhe Mesihun, birin e Merjemes, ndërkohë që qenë urdhëruar të adhuronin vetëm Një Zot, përveç të Cilit nuk ka tjetër që meriton të adhurohet. I lartësuar qoftë Ai mbi gjithçka që ia shoqërojnë** (në adhurim)" (Surja 9:31), një ish i krishterë, Adi ibn Hatim tha: "*O i Dërguar i Allahut! Nuk i adhurojnë ata.*" *I Dërguari i Allahut tha: "Ata sigurisht i adhurojnë. Ata ( rabinët dhe murgjit) i bënë gjërat e ligjshme si të paligjshme dhe gjërat e paligjshme si të ligjshme dhe ata (hebrenjtë dhe të krishterët) i ndoqën ato dhe*

*duke bërë kështu, ata, në të vërtetë i adhuruan.*"

Ne nuk mund t'i vëmë dëshirat tona mbi ligjet e Allahut dhe mbi atë që solli i Dërguari i Allahut (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!). Po të bësh kështu, do të thotë të besosh se di më mirë se Allahu (!). Allahu është Krijuesi ynë dhe Ai na njeh më mirë se ç'e njohim ne vetë veten tonë. "**Vërtet, Ai di çfarë flisni ju, fshehtas apo haptas; Ai e di mirë ç'ka në zemrat tuaja**." (Surja 67:13). Ai di çfarë është më e mirë për ne dhe Ai ka urtësinë e përsosur dhe Ai është i Drejti në gjithçka që Ai urdhëron. Të mos drejtosh me atë që ka zbritur Allahu, është baras me mosbesim.

## T'i dërgosh salavate dhe selame

E drejta e shtatë e Profetit Muhamed (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!) është t'i dërgosh atij salavate dhe selame. Allahu thotë: "**Vërtet, Allahu e bekon të Dërguarin dhe melekët e Tij, gjithashtu, luten për të. O ju që keni besuar! Lutuni për atë dhe përshëndeteni me selam!**" (Surja 33:56). Kurse Profeti Muhamed (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!) ka thënë: "*Kushdo që më bekon mua një herë, Allahu e bekon atë me dhjetë lutje dhe dhjetë veprime të gabuara i falen atij dhe ai gradohet dhjetëfish.*" Dhe: "*Ditën e Ringjalljes, njerëzit më të afërt me mua do të jenë ata që kanë bërë më shumë lutje për mua.*"

Profeti (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!) na ka mësuar si të lutemi për të. Ebu Humejd as-Saidi ka thënë. E pyetën Profetin (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!): "*O i Dërguar i Allahut, si duhet të lutemi ne për ty?*" Ai u përgjigj: *'Thoni: o Allah, bekoji Muhamedin dhe familjen e tij dhe pasardhësit e tij, siç ke bekuar Ibrahimin dhe familjen e tij! Ti je i Madhëruari.'*" Ky është teshehudi, i cili thuhet kur jemi ulur në namaz. Një tjetër mënyrë është të thuash 'sallallahu alejhi ue selëm (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!)', kur përmendet Profeti.

Kuptimi i selamit për Profetin (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!) është t'i kërkosh Allahut ta ruajë atë nga ndonjë dëm që mund t'i vijë atij; selami është, gjithashtu, përshëndetje për Profetin (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!). Ebu Hureire ka transmetuar se i Dërguari i Allahut (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!) ka thënë: "*Sa herë që dikush më përshëndet me selam, Allahu e rikthen shpirtin tek unë; prandaj edhe unë mund t'ia kthej selamin*." Profeti (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!) ka thënë, gjithashtu: "*Unë do të dëgjoj këdo që më bekon mua te varrin im. Edhe kur dikush është larg dhe më bekon mua, edhe ky bekim më përcillet mua*."

Meqë Allahu na ka urdhëruar që t'i dërgojmë salavate dhe selame Profetit Muhamed (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!), atëherë ky është detyrim i përgjithshëm dhe i gjithmonshëm dhe jo i kufizuar në kohë të veçantë. Detyrimi është që ne duhet ta bëjmë atë së paku një herë në ditë. Por ta thuash atë më shumë se një herë këshillohet shumë dhe është Synet.

Herët e tjera dërgohen salavate dhe selame për Profetin Muhamed (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!), kur i lutemi Allahut për diçka. Ibn Mesudi ka thënë: "*Kur duam t'i lutemi Allahut për diçka, duhet ta fillojmë me lavdërimin dhe madhërimin e Atij, siç e meriton Ai dhe pastaj, vazhdojmë me bekimin e Profetit. Atëherë, lutja jonë ka më shumë mundësi të pranohet*." Po kështu, të xhumanë, kur hyjmë në xhami dhe kur dalim nga xhamia, në namazin e xhenazes dhe kur shkruajmë letra, janë çaste të tjera që këshillohen shumë. Profeti (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!), ka thënë: "*Kushdo që më bekon mua në një libër ose në një letër, melekët vazhdojnë të kërkojnë falje për të sa kohë emri im është në të*."

**Abdu Daim al Kahiil**

# ARGUMENTE SHKENCORE NGA KUR'ANI IV

## Abstrakt

*Në këtë artikull janë përfshirë disa argumente shkencore nga Kur'ani, të tillë, si: Retë dhe vetëtima, Vendndodhja e yjeve, Yjet që shpërthejnë, Tymi kozmik, Vrimat e zeza, Nata mbulon ditën, Bletët dhe gjumi, Deti që digjet, Shtyllat e maleve, Hëna është çarë më dysh, Shërimi me ngjyra etj.*

## Retë dhe vetëtima

Shkencëtarët kanë provuar se retë peshojnë miliona tonë dhe që të ndodhë vetëtima, duhet që ato të grumbullohen. Kështu, fakti shkencor është ky: Ka një lidhje ndërmjet reve të rënda ose reve të grumbulluara dhe vetëtimës. Kjo është ajo që ka thënë Kur'ani i Shenjtë në Suren 13, ajeti 12: "Është Ai, i Cili ju shfaq vetëtimën për frikë dhe shpresë. **Është Ai, i Cili i ngre retë e rënda nga shiu (**që mbartin**).**" Ky ajet është veçse dëshmi për mrekullitë e mëdha të Kur'anit të Shenjtë në kohën tonë.

## Vendndodhja e yjeve

Shkencëtarët thonë se e shohim galaktikën tonë siç ka qenë miliona vjet më parë. Por, përsa i përket vendndodhjes së saj reale, ata thonë se nuk mund ta konceptojmë sepse

dritës, që ajo transmeton, i duhen miliona vjet që të arrijë deri te ne. Kjo do të thotë se vendndodhja reale e yjeve dihet vetëm nga Allahu, i Gjithëfuqishmi dhe kjo është arsyeja përse Allahu është betuar për to. Në Kur'anin e Shenjtë, në Suren 56, ajeti 75, Allahu thotë: "**Betohem në perëndimin e yjeve**." Kush ia ka dhënë këtë informacion të Dërguarit të Allahut (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!) për këtë të vërtetë për kozmosin?!

## Yjet që shpërthejnë

Skena e shpërthimit të yjeve është një mikrokozmos i Ditës së Kiametit, kur qielli do të çahet copë - copë. Shkencëtarët kanë zbuluar se ylli që shpërthen, është si një trëndafil që jep ngjyra të ndritshme. Ky fakt është përmendur në Kur'anin e Shenjtë katërmbëdhjetë shekuj më parë, në ajetin që flet për Ditën e Kiametit: "**E, kur të çahet qielli e të bëhet i kuq si vaji i shkrirë.**" (Surja 55:37). I Madhëruar është Allahu.

## Malet dhe uji

Shkencëtarët thonë se malet e pastrojnë ujin që ne pimë. Malet ndihmojnë, gjithashtu, për formimin e reve dhe rënien e shiut. Ato konsiderohen edhe si një burim i rëndësishëm uji. Ky fakt shkencor është përmendur katërmbëdhjetë shekuj më parë në Kur'anin e Shenjtë, kur ai na flet për ujin dhe lidhjen e tij me malet. Allahu i Gjithëfuqishëm e ka shpallur këtë në Kur'anin e Shenjtë, në Suren 77, ajeti 27: "**Dhe kemi bërë male të forta e të larta dhe ju kemi dhënë ujë të ëmbël**." Kur'ani i Shenjtë përmend malet e larta dhe ujin e ëmbël, të cilin e pranon shija jonë. Kjo është, vërtet një mrekulli mahnitëse e Kur'anit të Shenjtë, që ia vlen të përsiatet (të meditohet) për të.

## Tymi kozmik

Shkencëtarët e NASA-s kanë provuar se universi përmban sasi të mëdha tymi. Një sasi e këtij pluhuri nga ky tym kozmik është sjellë në tokë. Studimet laboratorike kanë treguar se ky pluhur ka të bëjë me tymin e hershëm kozmik. Shkencëtarët kanë ardhur në përfundimin se fjala më e saktë që mund ta emërtojë lëndën e këtyre molekulave është "tym". Është për t'u habitur - kjo është ajo që Kur'ani i Shenjtë e ka thënë katërmbëdhjetë shekuj më parë. Në Suren 41, ajeti 11, Allahu i Gjithëfuqishëm thotë: "**Pastaj iu drejtua qiellit (**krijimit të qiellit**) e ai ishte tymnajë dhe atij e edhe Tokës u tha: 'Bindjuni urdhrit Tim, me dëshirë ose pa dëshirë!' Qielli dhe Toka thanë: 'Po, i bindemi me dëshirë!'"** I Madhëruar është Allahu**.**

## Vrimat e zeza

Shkencëtarët kanë zbuluar kohët e fundit yje, të cilat i kanë quajtur 'vrima të zeza'. Këto yje dallohen nga tri karakteristika: 1. Ato nuk mund të shihen. 2. Lëvizin me shpejtësi të madhe. 3. Tërheqin çdo gjë, sikur të pastronin qiellin. Prandaj shkencëtarët i kanë emërtuar të tilla yje 'vakuum kozmik'. Është për t'u mahnitur që pikërisht këto karakteristika aludohen në Kur'anin e Shenjtë, në Suren 81, ajetet 15, 16: "**Kështu, vërtet unë jam për të dëshmuar për planetet - që largohen, që shkojnë drejt, ose që fshihen**." Fjala "khonnas" ka kuptimin "ato që nuk shihen; ato që pastrojnë; ato që tërheqin gjithçka drejt vetes me anë të forcës së tyre shumë të madhe të rëndesës." Fjala "alxhauari" ka kuptimin "ato që lëvizin andej - këtej." A nuk është ky ajet një skup shkencor i Kur'anit të Shenjtë?

## Nata mbulon ditën

Shkencëtarët kanë zbuluar se nata e mbulon ditën në një proces shumë të ndërlikuar. Shkencëtarët përdorin kompjutera për ta studiuar këtë dukuri të habitshme. Ata kanë zbuluar se nata lidhet me ditën dhe dita lidhet me natën - një proces që ndodh pa ndalim në çdo 24 orë. Kur'ani i Shenjtë e ka përshkruar këtë proces si më poshtë: "**Allahu e fut natën në ditë dhe ditën në natë dhe, vërtet është Allahu Ai, i Cili dëgjon dhe shikon**." (Surja 22:61) Pyetja është: Kush e dinte katërmbëdhjetë shekuj më parë se dita dhe nata janë në një harmonizim të vazhdueshëm dhe se ky proces është një nga Shenjat e Allahut, të Gjithëfuqishmit?

## Erërat dhe retë

Shkencëtarët kanë zbuluar se erërat luajnë një rol të madh në formimin e reve. Ato shtyjnë avullin e ujit dhe pjesëzat e pluhurit. Çdo pikë e vetme uji formohet nga miliona pikla. Era e shtyn renë që të bjerë shiu. Kjo është thënë në Kur'anin e Shenjtë shekuj më parë, para se njerëzimi ta dinte. Në Kur'anin e Shenjtë, në Suren 15, ajeti 22 Allahu ka thënë: "**Ne i dërgojmë erërat mbarësuese, pastaj bëjmë që të bjerë shi nga qielli, duke ju dhënë ujë** (me mbushullí/me bollëk**) e ju nuk mund të jeni rojtarët e depove të tij**." Ky ajet i thotë besimtarit të reflektojë për madhërinë e Krijuesit, Allahut, të Gjithëfuqishmit.

## Fëmijët dhe loja

Studimet shkencore të kohëve të fundit vërtetojnë se loja për fëmijët është shumë e rëndësishme për shëndetin e tyre fizik dhe mendor. Amikasingh, bashkëpuntore e vjetër shkencore në Holandë, thotë se veprimtaria fizike lidhet më mirë me veprimtarinë shkollore dhe arrihen rezultate më të mira në testimet standarde. Studimet tregojnë se

sa më shumë veprimtari fizike të bëjnë fëmijët, aq më të larta janë rezultatet e tyre në shkollë, sidomos në lëndët themelore: matematikë, gjuhë angleze dhe lexim. Allahu i Gjithëfuqishëm i përmend fëmijët dhe lojën në Kur'an, në tregimin e famshëm historik për profetin Jakub (paqja qoftë mbi të!), kur djemtë e tij iu lutën ta merrnin vëllanë e tyre, Jusufin të luante me ta. Allahu i Gjithëfuqishëm thotë: "**Dërgoje atë nesër me ne, të luajë e të kënaqet me ne dhe ne, patjetër do të kujdesemi për të**." (Surja 12, ajeti 12) I Madhëruar qoftë Allahu!

## Bletët dhe gjumi

Studiuesit kanë provuar se bletët kanë nevojë të flenë, ashtu si njeriu. Mungesa e gjumit ndikon në aftësinë e bletës për prodhimin e mjaltit dhe gjithashtu, për komunikimin me njëra-tjetrën. Gjumi është i rëndësishëm për të gjitha gjallesat sepse ai ndihmon për stabilizimin e të gjitha sistemeve të tyre dhe për të vepruar ashtu siç duhet. Allahu i Gjithëfuqishëm thotë për këtë në Kur'anin e Shenjtë: "**Nuk ka gjallesë që lëviz në Tokë dhe as shpend që fluturon me dy krahë, që të mos jetë në bashkësi si ju. Ne nuk kemi lënë asgjë pas dore në Libër. Dhe te Zoti i tyre ata** (të gjithë) **do të tubohen**." (Surja 6, ajeti 38)

## Veprat më të mira për Allahun

Shumë shkencëtarë thonë se ka të dhëna që falja (namazi) ka fuqi shëruese. Shumë studime vërtetojnë se ajo ka ndikim pozitiv në funksionin e sistemit imunitar, të zemrës etj. Allahu i Gjithëfuqishëm i urdhëron myslimanët ta kryejnë faljen në kohën e caktuar: "**Kryejeni namazin me**(xhemat)**! Vërtet, namazi u është urdhëruar besimtarëve në orë të caktuara**." (Surja 4, ajeti 103). Kurse

Profeti Muhamed (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!), kur e kanë pyetur se cila është vepra më e mirë që mund të bëjë një njeri, është përgjigjur: "*Kryerja e faljes në kohë.*" (Hadith i saktë, nga Ebu Daudi).

## Shtëpi luksoze në male

Arkeologët kanë zbuluar kohët e fundit pallate shumë luksoze, të ndërtuar në shkëmbinjtë e maleve nga njerëzit e lashtë. Habia është se Kur'ani Fisnik ka folur për këto zbulime. Fisi Themud dhe popuj të tjerë të mëparshëm patën mëkatuar, prandaj Allahu i Gjithëfuqishëm i ka shkatërruar ata dhe asgjë nuk ka mbetur përveç gjurmëve të tyre. Nga rrënojat e zbuluara kohët e fundit të shtëpive luksoze në male, është gjetur një skulpturë mijëravjeçare. Kur'ani Fisnik e përmend këtë fakt: "**Dhe ju me mjeshtëri po ndërtoni shtëpi në male shkëmbore.**" (Surja 26:149)

Kush ia tha Profetit (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!) se kanë ekzistuar pallate të gdhendura në faqe malesh?

## Dielli është burim i lirë nxehtësie dhe drite

Shkencëtarët thonë se po të përfitonte njeriu një sekondë nga e gjithë energjia e emetuar e Diellit, ajo (energjia) do të ishte e mjaftueshme për më shumë se njëqind mijë vjet. Shikoni sa lirë e marrim energjinë e Diellit çdo sekondë në tokë. Allahu thotë: "**Ai i ka nënshtruar Diellin e Hënën. Edhe Dielli, edhe Hëna udhëtojnë deri në një afat të caktuar. Ai i rregullon të gjitha çështjet** (e gjithësisë), **duke i shpjeguar Argumentet me hollësi, që të besoni me bindje në takimin** (pas Ringjalljes) **me Zotin tuaj**." (Surja 13:2)

## Zgjerimi i kozmosit

Shkencëtarët kanë pasur dyshime se universi është statik dhe nuk ndryshon. Por, më vonë kanë zbuluar se universi zgjerohet me një shpejtësi shumë të madhe. Këtë fakt shkencor, të cilin shkencëtarët e kanë zbuluar në shekullin XX, Allahu e ka shpallur në Kur'anin e Shenjtë, në Suren 51, ajeti 47: "**Ne, me fuqinë Tonë dhe me mjeshtërinë Tonë e ndërtuam Qiellin dhe jemi Ne që e zgjerojmë atë**."

## Deti që digjet

Është zbuluar kohët e fundit se ka plasaritje në fund të oqeaneve dhe të deteve, nga të cilat shkëputet llavë e shkrirë. Kjo dukuri ka qenë e panjohur gjatë kohës kur zbriste Kur'ani i Shenjtë; por Allahu, i Gjithëfuqishmi na e ka thënë këtë në Suren 52, ajeti 6: "**Pafsha detin e ndezur flakë!**" Fjala "almsegeor" në arabisht ka kuptimin "i nxehtë". Shkencëtarët kanë parë pamjet e kësaj dukurie, që është një dëshmi për mrekullitë e Kur'anit të Shenjtë në kohën tonë.

## Lumenjtë e Gadishullit Arabik

Shkencëtarët konfirmojnë se Gadishulli Arabik ka qenë dikur plot me lëndina dhe lumenj. Fotografitë e NASA-s provojnë se Gadishulli Arabik ka gjurmë lumenjsh dhe liqenesh, groposur nën tokë mijëra vjet më parë. Ky Gadishull do të bëhet siç ka qenë më parë, domethënë, do të mbushet me lëndina dhe me lumenj për arsye të të ashtuquajturit "cikli i motit". Ne na është thënë ky fakt nga i Dërguari i Allahut (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!): "*Nuk do të ndodhë Dita e Kiametit derisa toka e arabëve të kthehet siç ka qenë përpara - me lëndina dhe me lumenj.*" (Hadithi është përcjellë nga imam Myslimi).

Lutem, mendoni bashkë me mua për këtë mrekulli

që vërtetëson të vërtetën e të Dërguarit të Allahut (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!)!

## Sekretet e zemrës

Zemra nuk është një pompë e thjeshtë për gjakun, por shumë më tepër se kaq. Sot, shkencëtarët flasin për një tru që ekziston në zemër, i cili përbëhet nga 40.000 neurone. Kjo do të thotë se ajo që ne quajmë "mendje", është në qendrën e zemrës. Zemra drejtohet nga truri për të kryer funksionet e saj. Është për t'u mahnitur: Kur'ani i Shenjtë ka folur për këtë fakt mjekësor. Allahu, i Gjithëfuqishmi e ka shpallur këtë në Kur'anin e Shenjtë, në suren 22, ajeti 46: "**A nuk udhëtojnë ata nëpër tokë e të kenë zemra, me të cilat të kuptojnë dhe veshë, me të cilët të dëgjojnë? Në të vërtetë, nuk janë sytë e tyre që verbohen, por verbohen zemrat e tyre në kraharorë.**" Ky ajet vërteton se zemra e njeriut mendon, kupton dhe arsyeton. I Madhëruar është Allahu, i Gjithëfuqishmi.

## Shtyllat e maleve

Shkencëtarët kanë zbuluar se çdo mal në Tokë ka një rrënjë, që është thellë në tokë disa kilometra. Ky fakt shkencor nuk njihej nga askush, kur zbriste Kur'ani i Shenjtë. Por ai e ka përmendur në Suren 78, ajeti 7: "**Dhe malet si shtylla**." Kush ia tha këtë të Dërguarit të Allahut (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!)?!

## Të flesh në krahun e djathtë

Profeti Muhamed (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!) na ka këshilluar 1400 vjet më parë të flemë në krahun e djathtë. Përse?

Shkencëtarët thonë se të flesh në krahun e majtë, nuk është mirë sepse zemra është nën presionin e mushkërisë së

djathtë - më e madhja e të dyja mushkërive dhe kjo ndikon në tkurrjen (kontraktimin) e saj, sidomos kur njeriu është i moshuar. Ata thonë, gjithashtu se stomaku i mbushur është vetë nën presionin e organit të madh të sistemit të tretjes - mëlçisë, e cila e vonon zbrazjen e tij dhe shtyp, gjithashtu, zemrën. Prandaj ata i këshillojnë njerëzit të flenë në krahun e djathtë, sidomos për ata me sëmundje zemre.

I Madhëruar qoftë Allahu! Kush ia tha Profetit tonë (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!) këtë këshillë mjekësore?

## Hëna është çarë më dysh

Astronomët e mëparshëm kanë zbuluar një gjurmë të gjatë në Hënë. Ky zbulim është bërë dyqind vjet më parë me anë të një teleskopi të vogël. Kurse astronomët e sotëm kanë zbuluar plasaritje që zgjaten qindra kilometra. Për këto plasaritje Allahu i Gjithëfuqishëm na ka thënë 1400 vjet më parë: "**Ora (**e Kiametit**) është afruar e Hëna është çarë më dysh**[1**]." (Surja 54:1) A nuk është kjo një dëshmi e qartë se Libri i Shenjtë i Kur'anit është zbritur nga Allahu i Gjithëfuqishëm dhe është një provë se nuk është bërë nga njeriu?

## Islami do të përhapet në të gjitha vendet e botës

Studiuesit thonë se ka më shumë se 4200 fe në botë. Statistikat e kohëve të fundit tregojnë se Islami ka përhapjen më të shpejtë ndër të gjitha fetë. Islami po përhapet në të gjitha kontinentet e botës. Në vitin 1997, numri i myslimanëve në gjashtë kontinente ishte: 780 milionë në Azi, 308 milionë në Afrikë, 32 milionë në Europë, 7 milionë në Amerikë dhe 385 mijë në Australi. Tani, janë rreth 1.6 miliardë myslimanë, që

1 ** Njerëzit e Mekës e patën pyetur Profetin Muhamed (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!) t'u tregonte atyre një mrekulli dhe ai u tregoi çarjen e Hënës.

zënë rreth 21 - 23 % të popullsisë së botës.

Islami po shtohet me 2.9 % çdo vit dhe në vitin 2025 do të bëhet feja e parë në botë. Ky është ritmi më i lartë i shtimit të myslimanëve në botë. Në vitin 1900, numri i myslimanëve në të gjithë botën ishte më pak se gjysma e numrit të të krishterëve; kurse në vitin 2025, numri i myslimanëve do të bëhet më i madh se numri i të krishterëve për arsye të rritjes domethënëse të fesë islame.

Profeti Muhamed (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!) ka thënë një mrekulli të mahnitshme profetike: "*Islami do të përhapet në të gjitha vendet që kanë ditë dhe natë.*" (Treguar nga Ibn - Hiban). Kjo do të thotë se Islami do të mbërrijë në çdo pjesë të tokës, që ka ditë dhe natë dhe kjo është ajo që ka ndodhur, vërtet sot: Myslimanë ka në të gjithë botën.

## Fundi i universit

Më sipër është një foto imagjinare e Diellit, kur Allahu i Gjithëfuqishëm e mbështjell atë rrotull dhe kur ai humbet dritën e tij. Shkencëtarët konfirmojnë se kjo që u tha, një ditë do të ndodhë; kështu, jeta në Tokë do të shuhet. Allahu i Gjithëfuqishëm thotë për atë që do të ndodhë Ditën e Kiametit: "**Kur Dielli të mbështillet dhe të errësohet e të humbasë dritën e tij dhe të përmbyset**." (Surja 81:1)

Pyetja është, kush ia tha Profetit Muhamed (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!) këtë fakt shkencor në kohën kur askush nuk mendonte për të ardhmen e Diellit? Allahu i Gjithëfuqishëm, i Cili është Bërësi i gjithçkaje dhe i Cili thotë për Veten e Vet: "**Thuaju (**o Muhamed njerëzve**): 'Si adhuroni ju diçka tjetër përveç Allahut, e cila nuk ka asnjë fuqi as t'ju bëjë dëm e as t'ju bëjë dobi?! Dhe është Allahu Ai, i Cili dëgjon gjithçka (**që thoni ju**) dhe di gjithçka (**që bëni ju**).'**" (Surja 5:76)

## Shërimi me anë të agjërimit

Sot, mjekët thonë se agjërimi është i vetmi mjet që i jep mundësi trupit të njeriut të shpëtojë në mënyrë të sigurt dhe pa ndikime anësore nga të gjitha toksinat e grumbulluara. Ata pohojnë, gjithashtu se agjërimi riaktivizon imunitetin e trupit të njeriut. Ka qindra studime shkencore që vërtetojnë se agjërimi ndihmon në trajtimin dhe kurimin e çrregullimeve të zemrës. Ka edhe studime të tjera që vërtetojnë se agjërimi parandalon arteriosklerozën dhe infarktin kardiak. Në disa vende perëndimore ka qendra të specializuara mjekësore që mjekojnë vetëm nëpërmjet agjërimit. Allahu i Gjithëfuqishëm thotë për agjërimin: "**Mirëpo po ta dinit, agjërimi është më i mirë për ju.**" (Surja 2:184)

Të gjitha falënderimet janë për Allahun, që e ka bekuar Islamin.

## Bamirësia e buzëqeshjes

Buzëqeshja na ndihmon të kemi gjendje të mirë shpirtërore sepse kur buzëqeshim, trupi ynë dërgon një mesazh: "Jeta është e mirë". Psikologët thonë se kur buzëqeshim, trupi ynë funksionon më mirë, përmirësohet shëndeti ynë, ulet stresi dhe bëhemi më tërheqës për të tjerët. Ata thonë se buzëqeshja mund t'u japë të tjerëve më shumë kënaqësi se diçka që hahet a pihet. Prandaj ata besojnë se po të buzëqeshësh, të zgjatet jeta. Ja disa nga të mirat që ka buzëqeshja:

1. Njerëzit u afrohen atyre që buzëqeshin sepse i bëjnë për vete me gëzueshmërinë e tyre.
2. Buzëqeshja na ndihmon të kemi gjendje të mirë shpirtërore sepse kur buzëqeshim, trupi ynë dërgon një mesazh: "Jeta është e mirë".
3. Buzëqeshja na bën të dukemi të suksesshëm sepse ai që buzëqesh, ka më shumë besim në vetvete.

4. Buzëqeshja e forcon sistemin tonë imunitar sepse e ndihmon atë (sistemin tonë imunitar) të funksionojë më mirë.

Profeti Muhamed (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!) na nxit të buzëqeshim, kur thotë në një hadith: "*Buzëqeshja juaj për të tjerët është bamirësi.*"

## Kush e mësoi zogun

Ky zog po mundohet shumë të ushqejë të vegjëlit e tij, por pa pasur asnjë dije të mëparshme për këtë punë. Prandaj shkencëtarët thonë se zogjtë janë paraprogramuar për ta kryer një punë të tillë, për ta mbajtur gjallë llojin e tyre dhe për ta shumuar llojin e tyre. Ata janë krijuar me një program në trurin e tyre për t'i ushqyer të vegjëlit e tyre.

Kush ua mësoi këtyre krijesave një teknikë kaq të ndërlikuar? Natyra apo Allahu i Gjithëfuqishëm - Krijuesi i natyrës? Allahu i Gjithëfuqishëm thotë në Kur'anin e Shenjtë: "**Zoti ynë është Ai, i Cili i dha gjithçkaje formën dhe natyrën e saj, pastaj e udhëzoi.**" (Surja 20:50)

## Merrni një sy gjumë

Profeti Muhamed (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!) ka thënë: "*Merrni një sy gjumë në mesditë sepse shejtani nuk merr asnjë sy gjumë!*" (Treguar nga El - Tabarani).

Gjumi i natës është një nga mrekullitë e Allahut për njeriun. Por përse Profeti Muhamed (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!) na ka thënë të marrim një sy gjumë ditën? A ka ndonjë arsye shkencore për këtë?

Një studim i ri shkencor ka provuar se një sy gjumë gjatë punës pakëson mundësitë për të pasur probleme serioze me zemrën. Një sy gjumë në mesditë në zyrë i bën mirë zemrës dhe pakëson lodhjen dhe stresin sepse puna është shkaku kryesor i lodhjes, - thotë studimi. Një sy

gjumë gjatë ditës është i nevojshëm për njeriun sepse gjumi i natës mund të mos jetë i mjaftueshëm. Jo vetëm kaq, por se gjumi i natës mund të jetë i dëmshëm kur flihet gjatë, - thonë studiuesit në një studim tjetër. Për këtë arsye mjekët këshillojnë të zgjohemi natën e të bëjmë ndonjë veprimtari dhe të mos flemë gjatë sepse dëmtohet zemra.

Tani, le të vështrojmë ajetin e Kur'anit të Shenjtë që na flet për mrekullinë e gjumit të natës dhe të gjumit të ditës. Allahu thotë në Kur'an: "**Nga argumentet e Tij është edhe gjumi juaj natën dhe ditën dhe përpjekja juaj për të fituar nga mirësitë e Tij. Dhe në këtë ka Argumente për njerëzit që dëgjojnë**." (Surja 30:23)

## Fruta përpara mishit

Në Kur'an, shohim se kur përmendet ushqimi që do të hanë njerëzit në Xhenet, Allahu përmend gjithmonë frutat në fillim dhe pastaj mishin. Urtësia e madhe mjekësore e këtij urdhri është se frutat përmbajnë sheqerna të thjeshtë, të lehtë për t'u tretur dhe për t'u përvetësuar dhe konsiderohen burim thelbësor i energjisë për organizmin e njeriut e prandaj mund ta shuajnë urinë shpejt. Përkundrazi, kur dikush e fillon ngrënien me mish, organizmit të njeriut do t'i duhen rreth tri orë për ta përfunduar tretjen e tij. Këtë fakt mjekësor e tregon ajeti: "**Dhe me frutat, që ata mund të zgjedhin dhe me mishin e shpendëve, që ata mund të dëshirojnë.**" (Surja 56:20, 21) Atëherë, le të përpiqemi ta zbatojmë këtë sidomos gjatë Muajit të Agjërimit (Ramazanit), duke e filluar çdo ngrënie me fruta.

## Pafsha detin që digjet!

Polit të Veriut. Aty mund të shihet sesi llava vullkanike rrjedh në det dhe sesi e ndez atë. Në kohën kur ka zbritur Kur'ani, kjo lloj dukurie nuk është vënë re. Por Kur'ani e ka përmendur atë si betim nga Allahu. Allahu

thotë: "**Pafsha Turin! Dhe librin e shkruar në rreshta në lëkurë të shtrirë! Pafsha Beit - ul - Mamurin** (Shtëpinë mbi qiej që është paralel me Shtëpinë / Qaben në Mekë, që vizitohet vazhdimisht nga melekët)**! Pafsha çatinë e ngritur lart** (qiellin)**! Pafsha detin që digjet flakë! Vërtet, dënimi i Zotit tënd do të vijë sigurisht. Atë nuk mund ta shmangë askush.**" (Surja 52:1 - 8)

I Madhëruar qoftë Allahu, i Cili i ka përmendur zjarrin dhe ujin, që mund të përzihen qindra vjet përpara se ne t'i shohim!

## Shërimi me ngjyra

Kromoterapia është një metodë mjekësore alternative që ul depresionin. Studiuesit thonë se kur shikon parqe e lulishte, njeriu ndien gëzim. Një orë meditim midis luleve shumëngjyrëshe dhe drurëve është një metodë e frytshme për të pakësuar depresionin, mërzitinë dhe probleme të tjera psikologjike. Këtu mund të shihet lidhja shkencore midis ndjenjës së brendshme të lumturisë dhe meditimit në natyrë.

Kur'ani e ka thënë me pak fjalë dhe në mënyrë elokuente këtë fakt me fjalët e Zotit: "**A nuk është Ai më i Miri Krijues? Kush i ka krijuar qiejt dhe Tokën dhe kush ju lëshon ju shi nga qielli? Me të** (shiun) **Ne bëjmë të lulëzojnë kopshte gjithë bukuri e kënaqësi, kurse ju nuk mund të bëni të rriten bimë në to. A mund të ketë ndonjë zot tjetër përveç Allahut?! Jo. Por ata janë një popull që e shtrembërojnë të Vërtetën.** (Surja 27:60)

Shihni ç'lidhje të shkëlqyer ka në Kur'an midis ndjenjës së gëzimit dhe lulishteve e parqeve! Kur'ani e ka thënë këtë shumë kohë përpara se ta thoshin shkencëtarët e Lindjes dhe të Perëndimit.

## Dy detet

Pamja e mësipërme mësohet sot në universitetet e mëdha të botës. Ajo ilustron një fakt shkencor të pranuar

në fushën e hidrologjisë. Aty shihet sesi uji i ëmbël i shijshëm i lumit rrjedh dhe përzihet me ujin e kripur të detit. Shkencëtarët kanë zbuluar se midis dy ujërave është formuar një pengesë. Pengesa bën që uji i kripur të mos e pushtojë ujin e ëmbël të lumit. Allahu i Lartësuar na e ka zbuluar këtë fakt shkencor katërmbëdhjetë shekuj më parë në Kur'an: "**Dhe është Ai, i Cili i ka bërë dy detet të rrjedhin lirshëm - njëri i ëmbël, që shuan etjen me ëmbëlsinë e tij dhe tjetri i kripur, që të djeg me kripësinë e tij dhe midis të dyve Ai ka bërë një pengesë, që nuk mund të shpërfillet.**" (Surja 25:53)

**Vullnet Merja**

# ÇËSHTJE TË MORALIT SIPAS KUR'ANIT

Abstrakt

*Morali është prej çështjeve të rëndësishme të Kur'anit. Ai ka qenë prej synimeve të larta të profetëve, sepse po të mos ishte morali, jeta e njerëzve do të ishte skëterrë dhe do të zhdukej. Njeriu është njeri me plot kuptimin e fjalës vetëm nëpërmjet moralit të tij, përndryshe do të ishte shtazë e humbur.*

*Misioni i profetëve në përgjithësi dhe i vulës së tyre në veçanti, profetit Muhamed (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!) ka qenë pastrimi, mësimi dhe edukimi i njerëzve. Këtë mision madhështor na e sqaron edhe Fjala e fundit e Allahut që iu shpall profetit Muhamed, Kur'ani i shenjtë. Në këtë artikull do të lexoni për durimin, si një forcë përballuese me qëllim që njeriu të mos goditet nga zemërimi, stresi e depresioni dhe për nxitimin. S'ka dyshim se humbjet që e godasin një njeri, një familje a shoqëri për shkak të nxitimit janë aq të shumta, saqë është vështirë t'i përkufizosh. Kur'ani i shenjtë i porosit dhe i këshillon njerëzit për një program të mirëfilltë në jetën e tyre. Ai u thotë atyre që të mos nxitojnë në fjalë e në vepra dhe të studiojnë jetën e profetëve, të udhëheqësve dhe të popujve të tyre, me qëllim që të njihen me dëmet e nxitimit.*

Morali është prej çështjeve të rëndësishme të Kur'anit. Ai ka qenë prej synimeve të larta të profetëve, sepse po të mos ishte morali, jeta e njerëzve do të ishte skëterrë dhe do të zhdukej, siç thuhet në vargjet e një poeme:

**Vërtet, popujt ekzistojnë me ekzistencën e moralit**
**Nëse morali zhduket edhe ata zhduken.**

Njeriu është njeri me plot kuptimin e fjalës vetëm nëpërmjet moralit të tij, përndryshe do të ishte shtazë e humbur.

Misioni i profetëve në përgjithësi dhe i vulës së tyre në veçanti, profetit Muhamed (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!) ka qenë pastrimi, mësimi dhe edukimi i njerëzve. Këtë mision madhështor na e sqaron edhe Fjala e fundit e Allahut që iu shpall profetit Muhamed, Kur'ani i shenjtë.

Allahu i Madhëruar thotë: **"Është Ai që u solli analfabetëve një të Dërguar nga gjiri i tyre, për t'u lexuar atyre shpalljet e Tij, për t'i pastruar e për t'u mësuar Librin dhe Urtësinë, ndonëse ata më parë ishin vërtet në humbje të plotë."**[1]

Dhe: "**Allahu u ka dhënë besimtarëve dhuratë të madhe, kur u solli një të dërguar nga gjiri i tyre, i cili ua lexon shpalljet e Tij, i pastron nga gjynahet dhe u mëson Librin** (Kur'anin) **e urtësinë** (diturinë e thellë fetare)**, edhe pse më parë, me të vërtetë, ata ishin në rrugë krejt të gabuar."**[2]

Dhe: **"Po kështu,** (për të plotësuar mirësinë Time ndaj jush) **ju kam sjellë një të Dërguar, nga mesi juaj, i cili ju lexon shpalljet Tona, ju pastron** (nga gjynahet)**, ju mëson Librin** (Kur'anin) **e Urtësinë** (rregullat e fesë) **dhe ju mëson ato**

---

1 Sure "Xhumua", ajeti 2.
2 Sure "Ali Imran", ajeti 164.

**gjëra që nuk i keni ditur."**[3]

Dhe: **O Zoti ynë! Dërgo tek ata një të dërguar nga gjiri i tyre, që t'u lexojë shpalljet e Tua, t'ua mësojë Librin dhe Urtësinë** (rregullat e fesë) **e t'i pastrojë** (nga gjynahet)**! Vërtet, Ti je i Plotfuqishmi dhe i Urti!"**[4]

Dhe: **"Vërtet, kushdo që e pastron shpirtin, do të shpëtojë, ndërsa kushdo që e shtyp atë** (me punë të këqija)**, do të dështojë."**[5]

Dhe: **"I shpëtuar është ai që pastrohet; që e përmend emrin e Zotit të vet dhe që fal namaz!"**[6]

Dhe: **"Ne i dhamë Lukmanit urtësinë** (duke i thënë)**: "Falënderoje Allahun! Kush është falënderues, e bën për të mirën e vet dhe, kush mohon, ta dijë se vërtet Allahu është i Vetëmjaftueshëm dhe i Denjë për lavdërim".**[7]

Nga këto ajete, e të tjera të ngjashme me to në Kur'anin e shenjtë, mësojmë dhe kuptojmë rëndësinë dhe përkujdesjen e madhe që i kushton Kur'ani çështjes së moralit, pastrimit, mësimit dhe edukimit të njerëzve.

Profeti Muhamed (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!) ka thënë: *"Vërtet, unë jam dërguar që të përsos moralet e njerëzve."*[8]

3 Sure "Bekare", ajeti 151.
4 Sure "Bekare", ajeti 129.
5 Sure "Shems", ajetet 9-10.
6 Sure "A'la", ajetet 14-15.
7 Sure "Lukman", ajeti 12.
8 Kenzul Ummal, vëll. 3, f. 16, hadithi 52175.

## Durimi

Është mëse e vërtetë se jeta e kësaj bote është e mbushur me probleme, vështirësi dhe fatkeqësi të ndryshme, të cilat njeriu i përjeton në jetën e tij individuale, familjare dhe shoqërore. Për këtë, është e domosdoshme prania e një force përballuese me qëllim që njeriu të mos goditet nga zemërimi, stresi, depresioni, e në fund, në humbjen e shpresës. Kjo forcë përballuese është durimi. Nëse njeriu i përballon problemet, vështirësitë, fatkeqësitë dhe sfidat e kësaj jete me durim, padyshim që do t'i tejkalojë ato me fitore. Përndryshe, ai nuk e arrin synimin e kërkuar dhe do të jetë i nënshtruar dhe i gjunjëzuar ndaj ndodhive dhe dukurive negative e shkatërruese.
Feja e drejtë islame, e cila ka si bazë Librin e fundit të Allahut, Kur'anin e shenjtë, na porosit që të interesohemi për cilësinë e durimit dhe të jemi durimtarë përballë sprovave të ndryshme të jetës së përditshme. Në Kur'an, fjala durim "sabr" përmendet disa herë. Më poshtë po përmendim disa nga ajetet e Kur'anit në të cilat përmendet durimi.
Allahu i Madhëruar thotë:

**"...Ne e gjetëm atë të durueshëm, rob të mrekullueshëm..."**[9]

**"Dhe sollën këmishën e tij të përgjakur, me gjak të rremë. Ai tha: "Nuk është kështu, por ju keni sajuar diçka** (tjetër nga sa thoni)**. Por, durim! Allahut i kërkoj ndihmë kundër asaj që po tregoni ju."**[10]

(Kujto) **Ismailin, Idrizin dhe Dhulkiflin! Të gjithë këta kanë qenë të durueshëm."**[11]

9 Sure "Sad", ajeti 44.
10 Sure "Jusuf", ajeti 18.
11 Sure "Enbija", ajeti 85.

**"Ai u përgjigj: "Ti nuk mund të durosh dot me mua!"**[12]

**"...Por ata që ishin të bindur se do të takoheshin me Allahun, thanë: "Sa herë, me ndihmën e Allahut, një ushtri e vogël ka ngadhënjyer mbi një ushtri të madhe! Allahu është me të durueshmit."**[13]

**"Prandaj, ti bëhu i durueshëm** (o Muhamed), **ashtu siç kanë duruar me këmbëngulje të dërguarit e vendosur dhe mos kërko shpejtimin e dënimit për ata! Ditën, kur të përjetojnë atë që u është premtuar, atyre do t'u duket se kanë qëndruar** (në Tokë) **vetëm një çast të ditës..."**[14]

**"Prandaj, duro, me durim të hijshëm."**[15]

**"O ju që keni besuar! Bëhuni të durueshëm dhe nxiteni njëri-tjetrin të jeni të tillë; bëhuni të vendosur dhe vigjilentë** (në vepra të mira dhe në ruajtjen e kufijve) **dhe kijeni frikë Allahun, që të shpëtoni!"**[16]

**"O ju që keni besuar! Kërkoni ndihmë për veten nëpërmjet durimit dhe namazit! Në të vërtetë, Allahu është me të duruarit."**[17]

**Thuaj: "O robtë besimtarë** (të Allahut), **frikësojuni Zotit tuaj! Ata që bëjnë mirë në këtë jetë, do të kenë të mira. Toka e Allahut është e gjerë. Vetëm ata që janë të durueshëm, do të shpërblehen pa masë."**[18]
"(e do t'u thonë): **"Shpëtimi qoftë mbi ju, për durimin që**

---

12 Sure "Kehf", ajeti 67.
13 Sure "Bekare", ajeti 249.
14 Sure "Ahkaf", ajeti 35.
15 Sure "Mearixh", ajeti 5.
16 Sure "Ali Imran", ajeti 200.
17 Sure "Bekare", ajeti 153.
18 Sure "Zumer", ajeti 10.

**keni treguar** (në jetën e kësaj bote)**! Sa vendbanim i bukur që është ky!"**[19]

**"Njerëz të tillë do të shpërblehen me Xhenet të lartë për durimin e tyre dhe do të mirëpriten e do të gjejnë paqe."**[20]

**"Sigurisht që Ne do t'ju provojmë me frikë dhe uri, me dëmtim të pasurisë, të njerëzve dhe të të lashtave! Prandaj, përgëzoji të duruarit."**[21]

**"...përveç atyre që besojnë dhe bëjnë vepra të mira, i këshillojnë njëri-tjetrit të vërtetën e i këshillojnë njëri-tjetrit durimin."**[22]

**Nxitimi**

S'ka dyshim se humbjet që e godasin një njeri, një familje a shoqëri për shkak të nxitimit janë aq të shumta, saqë është vështirë t'i përkufizosh. Kur'ani i shenjtë i porosit dhe i këshillon njerëzit për një program të mirëfilltë në jetën e tyre. Ai u thotë atyre që të mos nxitojnë në fjalë e në vepra dhe të studiojnë jetën e profetëve, të udhëheqësve dhe të popujve të tyre, me qëllim që të njihen me dëmet e nxitimit. Më poshtë do të përmendim disa ajete nga Kur'ani i shenjtë që flasin për historinë e profetëve, që të marrim mësime për jetën tonë të përditshme individuale, familjare dhe shoqërore.

Allahu i Madhëruar thotë:

**"Musai i tha atij: "A mund të të pasoj ty, që të më mësosh edhe mua diçka prej diturisë së drejtë që të është dhënë ty?" Ai u përgjigj: "Ti nuk mund të durosh dot me mua!**

19 Sure "Rra'ad", ajeti 24.
20 Sure "Furkan", ajeti 75.
21 Sure "Bekare", ajeti 155.
22 Sure "Asr", ajeti 3.

**E si mund të durosh** (pa pyetur) **para diçkaje për të cilën nuk di asgjë"?** (Musai) **tha: "Do të më gjesh të durueshëm, në dashtë Allahu e nuk do të të kundërshtoj për asgjë."**[23]

**"Kur hynë te Daudi, ai u frikësua prej tyre. Ata thanë: "Mos u frikëso! Ne jemi dy kundërshtarë, një nga të cilët i ka bërë padrejtësi tjetrit, prandaj gjyko me drejtësi dhe mos u shmang** (prej së vërtetës)**, por na udhëzo në rrugë të drejtë".** (Njëri prej tyre tha:) **"Ky është vëllai im. Ai ka nëntëdhjetë e nëntë dele, kurse unë kam vetëm një dele, andaj më tha: "Ma jep mua atë!" - dhe më mundi me fjalë." Daudi tha: "Vërtet, ai të ka bërë padrejtësi që të ka kërkuar delen tënde të vetme, për ta bashkuar me delet e veta. Shumë bashkëpronarë i bëjnë padrejtësi njëri-tjetrit, përveç atyre që besojnë dhe bëjnë punë të mira, por ata janë pak". Daudi e kuptoi, se në të vërtetë Ne e kishim vënë në provë atë, prandaj kërkoi falje nga Zoti i vet, ra në gjunjë dhe u përul, duke u penduar."**[24]

**"Prandaj, duro për gjykimin e Zotit tënd dhe mos u bëj si Njeriu i Peshkut** (Junusi /paqja qoftë mbi të!) **kur iu lut Zotit të vet i dëshpëruar** (në barkun e balenës)**! Sikur të mos i vinte mëshira prej Zotit tënd, ai do të hidhej në një shkretëtirë, i fajësuar! Por Zoti i tij e zgjodhi dhe e futi me punëdrejtët."** [25]

**"...Mos nxito për ta lexuar Kur'anin para se të përfundojë shpallja e tij dhe thuaj: "O Zoti im, shtoma dijeninë!"**[26]

**"Njeriu është krijuar i ngutur. Unë do t'jua tregoj shenjat e Mia, prandaj mos më kërkoni të ngutem."**[27]

23 Sure "Kehf" ajetet 66-69.
24 Sure "Sad", ajetet 21-24.
25 Sure "Kalem", ajetet 48-50.
26 Sure "Ta Ha", ajeti 114.
27 Sure "Enbija", ajeti 37.

**"Njeriu mallkon në të keqe, ashtu siç lutet edhe për të mirë; vërtet që njeriu është i ngutur."[28]**

**"Ata të kërkojnë ty me ngut t'u sjellësh të keqen para së mirës, ndonëse para tyre ka pasur shumë dënime shembullore. Zoti yt është Falës për njerëzit pavarësisht gjynaheve të tyre, por, në të vërtetë, Zoti yt është edhe i ashpër në dënim."[29]**

**"Sikur Allahu, t'ua shpejtonte të keqen njerëzve, ashtu siç e dëshirojnë shpejt të mirën, me të vërtetë që ata do të zhdukeshin. Megjithatë, ata që nuk shpresojnë takimin Tonë, Ne i lëmë të bredhin të verbër në humbjen e tyre."[30]**

**"Ata pyesin: "Kur do të vijë Gjykimi, nëse thoni të vërtetën?" Thuaju: "Ditën e Gjykimit nuk do t'u bëjë dobi mohuesve besimi i tyre e as që do t'u jepet afat". Andaj, mos ua vë veshin atyre dhe prit, edhe ata, me të vërtetë, po presin!"[31]**

**"Prandaj, ti bëhu i durueshëm** (o Muhamed)**, ashtu siç kanë duruar me këmbëngulje të dërguarit e vendosur dhe mos kërko shpejtimin e dënimit për ata! Ditën, kur të përjetojnë atë që u është premtuar, atyre do t'u duket se kanë qëndruar** (në Tokë) **vetëm një çast të ditës. Kjo është shpallje e qartë. E kush do të shkatërrohet tjetër, përveç popullit të pabindur!?"[32]**

28 Sure "Isra" ajeti 11.
29 Sure "Rra'ad", ajeti 6.
30 Sure "Junus", ajeti 11.
31 Sure "Sexhde", ajetet 28-30.
32 Sure "Ahkaf", ajeti 35.

**Xhemal Balla**

# PERSONALITETI I NJERIUT NË DRITËN E KUR'ANIT

Abstrakt

*Personaliteti përmbledh veçoritë individuale të njeriut, bindjet fetare, interesat në jetë, aftësitë për t'i përballuar, prirjet e veçanta, si dhe karakterin. Çdo njeri lë një vend të caktuar si në familje, ashtu edhe në shoqëri. Rëndësi ka roli që luan secili në detyrën e caktuar. Islami, në këtë vështrim, i kushton kujdes të veçantë marrëdhënieve ndërnjerëzore me nenin kushtetues të Kur'anit "Të gjithë besimtarët janë vëllezër". Edukimi i njeriut me mësimin e Kur'anit dhe traditën profetike pasuron ndjenjën shpirtërore, që bëhet rregullatori i parë i sjelljes së tij dhe që i siguron marrëdhënie aktive me realitetin që jeton. Besimi ndaj Zotit përcakton të gjithë veprimtarinë psikike të personalitetit të besimtarit, sjelljen e qëndrimin e tij në jetë, në punë e kudo, sikurse pikësynimet në pozicionin aktiv jetësor. Veçoritë e personalitetit si individ sigurojnë sjellje e veprimtari të qarta, që lidhen më procesin psikik, ku përfshihen aftësitë intelektuale, njohëse, vëzhguese, cilësitë e të menduarit, të të folurit, të vullnetit etj.*

Personaliteti përmbledh veçoritë individuale të njeriut, bindjet fetare, interesat në jetë, aftësitë për t'i përballuar, prirjet e veçanta, si dhe karakterin. Çdo njeri lë një vend të caktuar si në familje, ashtu edhe në shoqëri. Rëndësi ka roli që luan secili në detyrën e caktuar. Islami, në këtë vështrim, i kushton kujdes të veçantë marrëdhënieve ndërnjerëzore me nenin kushtetues të Kur'anit **"Të gjithë besimtarët janë vëllezër".** ("Huxhurat": 10) Këto marrëdhënie shtrihen në të gjitha fushat, si: ekonomike,

juridike, politike etj., mbi bazën e të drejtave dhe detyrave në zbatimin e normave sociale.

Sot, konsiderohet si personalitet një njeri që kryen një funksion shtetëror; por feja islame e konsideron si një njeri normal që jeton në shoqëri dhe që ka përgjegjësi individuale, familjare e shoqërore. Myslimani i vërtetë përfaqëson një personalitet të lartë. Ai është i shumanshëm, i devotshëm në besimin tek Zoti, i drejtë në mendime e veprime, i guximshëm e sakrifikues për të vërtetën, por edhe tolerant e falës. Në suren "El-Bekare", ajeti 143 thuhet: "**Kështu, Ne ju kemi bërë një bashkësi të mesme.",** do të thotë që besimtari qëndron i palëkundur nga devijimet. Në Shpalljen e Zotit, Kur'anin famëlartë gjendet i gjithë legjislacioni Islam, se si duhet ta formojë njeriu personalitetin e tij në të gjitha etapat e jetës, duke filluar që në fëmijëri. Pra, personaliteti nuk trashëgohet, por formohet në kushte të caktuara të jetës e pastaj zhvillohet në vazhdimësi. Në familje hidhen bazat e edukimit të fëmijëve që në moshë të vogël. Prindërit krijojnë kushte psikologjike te fëmijët, që t'i orientojnë drejt në zgjidhjen e detyrave. Këto në vazhdimësi vijnë e ndërlikohen më shumë në adoleshencë e rini, që fitojnë cilësitë themelore e të qëndrueshme të personalitetit dhe e bëjnë të riun pak a shumë të pavarur. Në këtë moshë rriten aftësitë për një zhvillim të mëtejshëm, në varësi të zhvillimit të vetëdijes së besimit tek Zoti, të arsimit, etikës dhe cilësive etiko-morale. Një besimtar i tillë bëhet aktiv në jetë dhe ndihmon me personalitetin e tij shokët që e rrethojnë. Në suren "El-Bekare", ajeti 165 thuhet: **"Ata që besojnë, e duan më shumë Allahun"**. Kjo do të thotë që besimtari, me vetitë e tij psikosociale individuale, ndërton një jetë të qetë e të lumtur, por njëkohësisht, ndikon edhe në mjedisin social. Feja islame, që e ka burimin nga Kur'ani famëlartë, e pasuron dhe e fisnikëron jetën e njeriut, duke e çliruar atë nga paragjykimet e kota e të dëmshme. Personaliteti i besimtarëve është më i pasur në bindjet ndaj fesë islame, besimit tek Zoti, adhurimit dhe falënderimit ndaj Tij

për mirësitë, por edhe në sjellje, interesa, qëndrime e marrëdhënie me të tjerët. Kur flasim për njeriun në tërësi, kemi një shtrirje shumë të gjerë, ku bën pjesë çdo personalitet. Por, jo çdo njeri ka personalitet. Kështu ndodh me fëmijët që nuk e kanë të zhvilluar vetëdijen në marrëdhënie me të tjerët apo njerëzit anormalë. Po kështu, kanë personalitet të dëmtuar njerëzit që kanë rënë në llumin e veseve negative duke filluar nga pijet dehëse, bixhozi, prostitucioni etj. Edukimi i njeriut me mësimin e Kur'anit dhe traditën profetike pasuron ndjenjën shpirtërore, që bëhet rregullatori i parë i sjelljes së tij dhe që i siguron marrëdhënie aktive me realitetin që jeton. Pra, ai merr drejtim me pikësynime të qarta në jetë, në mënyrën e sjelljes me të tjerët dhe me realitetin që jeton. Besimi ndaj Zotit përcakton të gjithë veprimtarinë psikike të personalitetit të besimtarit, sjelljen e qëndrimin e tij në jetë, në punë e kudo, sikurse pikësynimet në pozicionin aktiv jetësor. Veçoritë e personalitetit si individ sigurojnë sjellje e veprimtari të qarta, që lidhen më procesin psikik, ku përfshihen aftësitë intelektuale, njohëse, vëzhguese, cilësitë e të menduarit, të të folurit, të vullnetit etj. Në këtë proces të dukurive psikike ka rëndësi gjendja shpirtërore, që për njeriun, ndryshon me ulje e ngritje, ndërsa për besimtarin, duke u mbështjellë tek Krijuesi, gjen një jetë plot gjallëri, me shpresë e optimizëm, frymëzim, gëzim etj. Gjendja shpirtërore luan një rol të rëndësishëm pozitiv ose negativ në veprimtarinë e njeriut. Tek ai që nuk e ka besimin e shëndoshë tek Zoti, shpeshherë, do të shfaqen gjendje shpirtërore negative, si: pesimizmi në jetë, pasiviteti, pakënaqësia, nervozizmi, hidhërimi, dëshpërimi etj. Këto bëhen rrjedhë e proceseve psikike. Për këtë arsye, ato bëhen tipike për një personalitet të caktuar, besimtar ose jobesimtar. Besimtari, në veprimtarinë e tij teorike e praktike, mbështetet tek Krijuesi i tij për të shfrytëzuar mundësitë fiziko-shpirtërore, me të cilat formohet si personalitet. Në jetë, çdo individ nxitet nga qëllime të ndryshme materiale, shpirtërore, sociale e morale, sipas udhëzimit të

Shpalljes së Zotit. Qëllimet e veprimtarisë së njeriut duhet të kenë si bazë besimin tek Zoti, bindjen ndaj lidhjeve të tij, të cilat e udhëheqin për veprim dhe i japin një kuptim të drejtë jetës. Do të thotë që veprimtaria e njeriut që beson, bëhet e vetëdijshme përpara ditës së kryerjes, në kontroll të plotë të vetëdijes, nga të cilat formohen shprehi të zakonshme për të përballuar me sukses problemet në jetë. Në Kur'an, në suren "El-Bekare", ajeti 213 thuhet: "**Allahu i udhëzoi besimtarët që të kuptonin të vërtetën lidhur me çështjet për të cilat të tjerët nuk pajtohen**". Do të thotë që shoqëria njerëzore nuk mund të jetojë e ndarë nga feja. Myslimani duhet t'i njohë mirë parimet bazë të fesë islame, si dhe ligjet që burojnë prej saj, me qëllim që të qëndrojë i vendosur e të veprojë në çdo rrethanë në mënyrë të vetëdijshme. Nga devotshmëria në besimin tek Zoti, rrjedhin qëndrimet e sjelljet e çdo individi, në zbatimin e normave etiko-morale, si dhe në të gjithë sistemin e shprehive, mendimeve, ndjenjave dhe aftësive të personalitetit. Feja islame për myslimanin është një botëkuptim përparimtar, shkencor, objektiv, logjik, sistematik e i plotë, një botëkuptim universal. Baza ideore e botëkuptimit të fesë islame është Kur'ani famëlartë, si një sistem i plotë e rigoroz i pikëpamjeve mbi njohjen e argumentimin e ekzistencës së Zotit. Ai merr formën e adhurimit, si dhe legjislacionin në të gjitha fushat e veprimtarisë së njeriut. Në një shkollë më të lartë qëndron personaliteti i dijetarit islam, i cili, më mirë se kushdo përfaqëson sistemin e dijeve, të pikëpamjeve e bindjeve fetare për të njohur realitetin. Islami është rregullatori i veprimeve e i sjelljeve të njeriut, i qëllimeve e i motiveve të tij. Ai ndikon në zhvillimin e të gjitha cilësive psikike e sociale. Ai është busull orientimi në çdo veprim, për të gjykuar çdo gjë sipas legjislacionit të tij, e për t'u bërë i vetëdijshëm në kontrollin e ndjenjave, emocioneve, vullnetit të synimeve e motiveve për jetën. Besimtarit, Zoti i shërben si mbështetje, për të përcaktuar e vlerësuar qëndrimin e sjelljen, për t'i mbrojtur me

argumente pikëpamjet e drejta islame. Një besimtar i tillë është parimor, i qëndrueshëm, i drejtë, jeton e vepron sipas legjislacionit Islam. Për të, besimi tek Zoti shërben si orientim, si simbol, si qëllim për të ndërtuar të ardhmen e tij. Në të gjitha shndërrimet e mëdha demokratike të ndodhura në vendin tonë në dy dekada, në individë të veçantë, ende ndeshemi me shfaqje të indiferentizmit ndaj fesë e besimit tek Zoti, me mentalitete, qëndrime e veprime që janë të huaja për moralin Islam, duke dëmtuar personalitetin e tyre. Këto shfaqen në prirjen për t'u pasuruar në mënyrë të pandershme. Në suren "El-Bekare", ajeti 188 thuhet: **"Mos ia merrni pasurinë njëri-tjetrit padrejtësisht dhe mos u bëni mitëdhënës te gjykatësit për të përvetësuar në mënyrë të paligjshme dhe me vetëdije një pjesë të mallit të njerëzve"**. Kjo do të thotë: '*Ndaleni rryshfetin e përhapur në shoqërinë tonë!*'. Ky fenomen është pengesë e madhe për të zbatuar drejtësinë sociale, veçanërisht në shtresat në nevojë. Profeti Muhamed (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe familjen e tij!) ka thënë: *"Allahu e mallkoftë atë që jep rryshfet, atë që e merr rryshfetin dhe atë që punon për të dy!"* Jo vetëm kaq, por ka individë që kanë dëmtuar imazhin e personalitetit të tyre duke u marrë me trafiqe rruge e prostitucion, me tritol etj., të cilat janë bërë pengesë serioze në rrugën e Bashkimit Europian. Për këtë arsye, është detyrë emergjente përforcimi i personalitetit me një botëkuptim të shëndoshë për jetën, të ndërhapur nga bindjet dhe besimi tek Zoti. Ky duhet të jetë një proces dinamik dhe i shumanshëm që të realizohet në familje, në shkollë e shoqëri.

Në Kur'an, në suren "El-Bekare", ajeti 219 thuhet: **"Feja është moral. Materializmi i saj është edukimi."** Por, që të bëhet i plotë ky edukim, është e domosdoshme që prindërit, së pari, për vetveten duhet të mësojnë literaturën fetare, që t'ua mësojnë atë edhe fëmijëve. Kjo vlen për të transmetuar tek ata njohuri të sakta shkencore e shoqërore dhe njëkohësisht, etikën morale. Kur'ani famëlartë krijon përvetësimin bazë për rritjen e personalitetit të njeriut në njohjen dhe shndërrimin

e realitetit. Ai zhvillon motivet për një jetë të qetë e të lumtur. Puna edukative në mesin e njerëzve, pa dallim moshe e gjinie, duhet bërë edhe në mënyrë të diferencuar, në përputhje me veçoritë e tyre individuale, psikologjike e sociale, për të gjetur tek to gjuhën e komunikimit e të ndikimit edukativ. Kështu ishte i Dërguari i Allahut, Muhamedi (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!). Në Kur'an, në suren "El-Bekare", ajeti 151 thuhet: **"Po kështu, Ne kemi sjellë një të Dërguar nga mesi juaj."** Kjo do të thotë që duhet të ndiqet shembulli i Profetit (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe familjen e tij!), i cili ishte njeri si të tjerët, por me aftësi që të jetë edukator i njerëzimit, shembulli për të dhe i ndjeshëm ndaj problemeve të tij. Ai duhet të jetë përçues i drejtë i Shpalljes së Zotit, që është burimi i të gjitha të mirave, për formimin e cilësive të karakterit e personalitetit të njeriut, në ndërtimin e një jete të qetë e të lumtur.

**Hajri Shehu**

# RRETH BETIMEVE SIPAS KUR'ANIT

Abstrakt

*Në Kur'an ka shumë ajete që nisin me betime. Janë betime të Allahut. Allahu, Krijuesi i universit e ç'ka në univers betohet. Më i Madhi, Më i Larti shpalos para njeriut betimin e tij. Mbushamendje më të madhe për njeriun nuk mund të ketë: Unë jam Zoti juaj. Zoti juaj betohet për këtë që thotë. Atëherë, më besoni vetëm Mua dhe ndiqni vetëm Fjalën time! Zoti juaj betohet për këtë që thotë. Atëherë, a ende nuk besoni?! Në Allahun është betuar Profeti Muhamed (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!): "Për Zotin tim! (ajo / Ora e Gjykimit do të vijë …"). (34:3) Dhe: "Thuaj: Për Zotin tim (ju do të ringjalleni …)" (64:7) Edhe Profeti Ibrahim (Paqja qoftë mbi të!) betohet në Allahun: "Për Allahun! Unë do t'i flak idhujt tuaj sapo të largoheni ju." (21:56) Është betimi kundër idhujtarëve. Betimin në Allahun e kërkon edhe Profeti Jakub (Paqja qoftë mbi të!): "Unë kurrsesi nuk do ta dërgoj me ju (Jusufin), derisa të betoheni në Allahun". (12:66) Betimin në Allahun e kërkojnë dhe e bëjnë besimtarët. Sepse besimtarët kanë nevojë për Allahun. Sepse ata kanë nevojë të adhurojnë Allahun dhe vetëm Allahun, sepse siç na mëson Kur'ani, nevoja për Allahun, frika nga Allahu dhe shpresa në Allahun është pjesë e natyrës së njeriut.*

Në Kur'an ka shumë ajete që nisin me betime (shih 4:65; 15:92; 16:56, 63; 19:68; 34:3 etj.). Janë betime të Allahut. Allahu, Krijuesi i universit e ç'ka në univers betohet. Më i Madhi, Më i Larti shpalos para njeriut betimin e tij. Mbushamendje më të madhe për njeriun nuk mund të ketë: Unë jam Zoti juaj. Zoti juaj betohet për këtë që thotë. Atëherë, më besoni vetëm Mua dhe ndiqni vetëm Fjalën time! Zoti juaj betohet për këtë që thotë. Atëherë, a ende nuk besoni?!

Gjuhësisht, fraza e betimit në Kur'an ndërtohet me dy mënyra: me a) *la uksimu*[1] (po, betohem; betohem); b) me *idha*[2]. Te mënyra e parë, kuptimi i betimit vjen me shenjimin e foljes *uksimu* (betohem), domethënë, me përmbajtjen e saj kuptimore: premtoj solemnisht. Te mënyra e dytë, kuptimi i betimit vjen me lidhëzën *idha* (kur): atëherë kur do të ndodhë kjo për të cilën bëhet betimi në Kur'an dhe kjo do të ndodhë patjetër sepse jam Unë Allahu që betohem dhe betimi Im është më Solemni dhe i Pakthyeshmi, sepse urdhëroj Unë

1 Shih në Kur'an:
56:75 / Betohem në çastin e perëndimit të yjeve.
69:38 / Betohem për gjithçka që shihni ju.
70:40 / Betohem në Zotin e lindjeve dhe të perëndimeve.
75:1, 2 / Betohem në Ditën e Kiametit. Betohem në shpirtin qortues.
81:15, 18 / Betohem për ato planete që tërhiqen …, për natën …, për agimin …
84:16-18 / Betohem në kuqërrimin e muzgut …, në natën … dhe në hënën e plotë.

2 Shih në Kur'an:
77:8-11 / Kur yjet të shuhen dhe kur qielli të çahet dhe kur malet të thërmohen si pluhur.
81:1-13 / Kur Dielli të mbështillet.
82:1-4 / Kur qielli të shpërthejë.
44:1-5 / Kur qielli të çahet …
99:1-3 / Kur të dridhet Toka …

dhe vetëm Unë, sepse Unë jam i Gjithëfuqishmi, sepse unë jam Ai, të Cilit i mjafton të thotë vetëm "Bëhu!" për diçka dhe ajo bëhet, sepse ajo që do të ndodhë është e tillë që ti, o njeri nuk e bën, sepse Unë di gjithçka, sepse Unë di atë që nuk e dini ju, o njerëz.[3]

Herë-herë, ajo për të cilën bëhet betimi, vjen në fund të ajeteve. Shih, p.sh.: "(Betohem) për ata (melekë) që janë rreshtuar / Dhe për ata që përgjojnë të keqen / Dhe për ata që e lexojnë Kur'anin / *Se pa dyshim, Zoti juaj është Një.* (37:1-4) (Nënvizimi është imi – H.Sh.). Mjaft shpesh ka numërim (enumeracion) betimesh, që vijnë një pas një në ajete të një sureje. Numërimi ndërtohet me lidhëzën *ue* (dhe), me vlerën gramatikore që ka ajo në gjuhën arabe (ashtu si edhe në gjuhën shqipe). Shih, p.sh. në Suren 51, ajetet 1-4: "(Betohem) për erërat që ngrenë pluhurin / Dhe për retë e ngarkuara rëndë / Dhe për ata që lundrojnë lehtë / Dhe për ata (melekët) që shpërndajnë urdhrat".[4] Enumeracioni vjen gjithnjë në ngjitje, si klimaks, çka sjell një vlerë të veçantë stilistike për frazën dhe për kontekstin. Shih ngjitjen (klimaksin) në ajetet e mësipërme: erërat ® retë ® anijet ® melekët.

Allahu betohet në Veten e Vet: "Betohem në Zotin e lindjeve dhe të perëndimeve" (70:40). Zoti i lindjeve dhe i perëndimeve është vetë Allahu. Solemnitet më të madh betimi nuk mund të ketë. Allahu betohet edhe në krijesat e tij. Është po i njëjti solemnitet sepse është përsëri Allahu,

3 Me këtë mënyrë betimi, Kur'ani na thotë se Allahut nuk mund t'i bëhet shok e ortak, se askush e asgjë tjetër nuk është si Ai, se antropomorfizimi i krishterë i Zotit është shirk.

4 Shih edhe te 89:1-5; 91:1-8; 93:1, 2; 95:1-3; 100:1-5.

më i Larti që betohet. Përse betohet vetë Allahu në krijesat e veta?[5] Përgjigjja më e parë edhe më e përgjithshme do të ishte: Sepse janë shenja të Allahut, janë argumente të Allahut[6] dhe i vlerëson aq shumë si të tilla.

Allahu betohet në melekët: "Betohem) për ata (melekët) që marrin me forcë (shpirtrat e jobesimtarëve) (dhe) për ata (melekët) që marrin me të butë (shpirtrat e besimtarëve) (dhe) për ata (melekët) që nxitojnë (të fusin në Xhenet njerëzit e mirë) (dhe) për ata (melekët) që i rregullojnë punët (në gjithësi sipas urdhrave të Allahut)" (79:21), sepse ata janë gjithnjë të gatshëm për t'i zbatuar menjëherë urdhrat e Tij.

Allahu betohet në Kur'anin:

36:2: "Për Kur'anin plot urtësi".

38:1: "(Betohem) për Kur'anin plot këshilla".

43:2: "Betohem në Librin e qartë".

---

5 Shih në Kur'an: 37:1; 51:1-4, 7; 52:3, 5, 6; 53:1; 56:75; 64:38; 70:40; 74:32-34; 75:2; 77:1-5; 81:15-18; 84:16-18; 85:1-3; 86:1, 4, 11, 12; 89:1-5; 91:1-8; 92:1, 2; 93:1-3; 96:75; 100:1-5; 103:1.

6 Shih në Kur'an, p.sh., betime për:

- qytetin e Mekës, 90:1-3, 95:3;
- Qaben, 52:4;
- Turi Sinain 52:1; 95:2;
- Ditën e Ringjalljes 75:1; 79:6;
- Ditën e Premtuar 65:2;
- çiftin dhe tekun 89:3;
- kohën 103:1-3;
- njeriun 91:7;
- njeriun vetëqortues 75:2;
- prindin dhe atë që lind prej tij 90:3;
- lexuesit 37:3;
- penën 68:1;
- atë që dëshmon dhe për atë që dëshmohet 85:3;
- fikun dhe ullirin 95:1;
- kuajt 100:1.

44:2: "Betohem në Librin e qartë".

50:1: "Betohem në Kur'anin e lavdishëm".

Kuptimi i betimeve: Kur'ani është Fjala e Allahut; prandaj është gjithë urtësi. Kur'ani është për njeriun; prandaj është gjithë këshilla. Kur'ani është Qartësia; prandaj e dallon të mirën nga e keqja. Kur'ani është e Vërteta; prandaj është Mrekullia që Allahu e zbriti për njeriun.

Allahu betohet në Profetin Muhamed (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!) me "Për jetën tënde!" (15:72), sepse e tërë jeta e tij është dëshmi e së Vërtetës.

Në Suren 52, ajetet 1-6, Allahu betohet në këto krijesa të vetat: malin Tur të Sinait, Librin e shkruar në rreshta …, Shtëpinë plot vizitorë, kupën e ngritur të qiellit, detin e mbushur. I gjithë betimi dhe të gjitha betimet vijnë për ajetin 7: "Se dënimi i Zotit tënd do të ndodhë." Kur'ani, siç dihet, është gjithë simbolizma. Në kuptimin konkret, kemi malin: malin Sinai të Musait; Malin e Ullinjve të Isait (shih Mateu XXIV, 3-51); Malin e Dritës të Profetit Muhamed. Në të tria rastet është mali ku shpallet Zbulesa. Është sublimiteti i Zbulesës. Më tej se lartësia e malit vjen lartësia e qiellit. Simbolikisht, ajo është e paarritshme nga mendja e njeriut. Oqeani – me gjerësinë e tij, me paanësinë e tij, me dallgët e stërmëdha - është simbolikisht universalja, e madhja, e fuqishmja që ka krijuar Allahu. Dhe përse betohet Allahu në këto pesë krijesa? Betohet për Ditën që do të vijë, për Ditën kur qiejt do të bëhen si vaj i shkrirë … Rezultati i betimit është: Dhe ti o njeri, ende nuk beson?! Atëherë, shiko betimin e Allahut drejtpërdrejt për Ditën e Gjykimit (75:1 dhe 79:6)!

Allahu betohet në kohën (103:1-3). Tri nga kuptimet e betimit mund të jenë: a) Koha nuk ka ekzistuar. Atë e solli Allahu. b) Po të mos ishte koha, nuk do të ishin as universi e universalja. Është atëherë, një krijesë kaq e madhe. c) Koha është armiku më i egër i njeriut, kur nuk e shfrytëzon për të bërë vepra të mira. Atëherë, çfarë duhet të bësh ti, o njeri?

Në suren 91, ajetet 1-6, Allahu betohet në krijesat e tij - Diellin, Hënën, ditën, natën, qiejt, Tokën – me të mirat e tyre për njeriun.[7] Dhe pastaj vjen ajeti 7, ku Allahu betohet në Njeriun. Vlerësim më të madh për njeriun nuk mund të ketë. Atëherë, çfarë do tjetër njeriu? Allahu betohet veçmas në njeriun vetëqortues (75:1). Sepse e do njeriun vetëqortues - atë që e gjykon veten, për të mos bërë gjynahe, atë që lufton me vetveten, për t'u bërë gjithnjë e më i mirë. Allahu betohet në njeriun, në atë që lind nga prindërit. Por edhe në prindërit (90:3). Sepse pas Allahut, janë prindërit që e sjellin në jetë njeriun, që e rrisin, që e duan. Prandaj Allahu, fill pas urdhrit për të adhuruar vetëm një Zot, urdhëron: "Dhe silluni mirë me prindërit!" (2:83).

Allahu betohet në Mekën sepse ajo është simboli i

7 Shih edhe: "Për qiellin e stolisur me yje!" (51:7)
"Betohem në yllin kur perëndon." (53:1)
"Betohem për penën dhe për atë që shkruajmë." (68:1)
"Betohem për Hënën, për natën që largohet e për agimin që zbardhëllon." (74:32-34)
"(Betohem) për ato që dërgohen njëra pas tjetrës, për ato që shpejtojnë shtrëngatën, për ato që shpërndajnë shiun, për ato që ndajnë saktësisht dhe për ata që përcjellin këshilla." (77:1-5).
"Për qiellin në yjësi, për Ditën e Premtuar, për dëshmitarin dhe atë që dëshmohet! (85:1-3) (Dita e Premtuar është Kiameti)."
"Për qiellin dhe për vizitorin e natës." (86:1)
"Për qiellin që kthehet pareshtur (në rrotullimin e tij) dhe për tokën që hapet për burimet e ujit dhe për të mbirë bimët)!" (86:11, 12)

historisë botërore të çlirimit shpirtëror të njeriut. Aty u shembën idhujt dhe idhujtaria. Aty zbriti për herë të parë (e edhe më pas) Kur'ani. Aty u rivendos adhurimi i një Zoti. Aty nisi triumfi i Islamit. Aty është Qabja – simboli i çdo faltoreje në botë, ku adhurohet Allahu.

Allahu betohet në Penën dhe në atë që shkruhet me penë (Kur'an 68:1). Simbolikisht, Pena është Shpallja, Fjala e Allahut, Mesazhi që përcolli Profeti Muhamed (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!). Gjithë urtësi (36:2). Gjithë qortime (38:1). Libri që i qartëson gjërat (43:1; 44:2). Kur'ani i lavdishëm (50:1). Urdhri (52:2). Por Allahu betohet edhe në ata që e lexojnë dhe e këndojnë Kur'anin dhe që e përcjellin Mesazhin e Allahut (37:3). Ky është një inkurajim i fuqishëm për ata që e mësojnë Kur'anin vetë dhe që ua mësojnë atë edhe të tjerëve.

Në suren 85 Allahu betohet edhe në atë që dëshmon dhe në atë që dëshmohet (shih 85:3). Cilët janë dëshmitarët? Allahu (3:81; 10:61); melekët që regjistrojnë veprimet e veprat e njeriut (50:21); profetët (3:81); gjymtyrët e njeriut (24:24); veprimet e veprat e regjistruara (17:14). Atëherë? Atëherë, njeriu të pendohet, të kërkojë falje, të korrigjojë veten.

Krejt natyrshëm, dikush mund të pyeste: Allahu betohet në krijesa të Tij të mëdha – në qiejt, Diellin, Hënën, melekët, Profetin, Mekën, njeriun etj. Po, edhe në kuajt (100:1-5)? Edhe në fikun e në ullirin (95:1)? Po. Për t'i thënë njeriut të mos jetë mosmirënjohës (100:6-11). Simbolizmi tek ajetet 2-5 (kuajt e luftës) duhet të jetë: e keqja dhe lufta kundër së keqes; trimëria dhe fitorja. Për fikun, ullirin,

malin Sinai, Qytetin e Sigurisë (qyteti i shenjtë i Mekës) Allahu betohet në ajetet 1-3 të sures 95 (Et Tin). Cili mund të jetë simbolizimi i fikut dhe i ullirit: Vlerat e frutës së fikut e të ullirit. Kur i kultivojmë. Të egër, jo. Kështu është edhe njeriu: duhet të kultivohet. Vlera e ullirit si ushqim (23:20). Vlera mjekësore e vajit të ullirit. Simbolizmi: era e mirë e vajit të ullirit. Simbolizmi tjetër: drita, sepse vaji i ullirit digjet edhe për dritë e më shumë se kaq: Drita e Allahut. Mund të jetë Kodra e Ullinjve jashtë Jerusalemit, ku profeti Isa (Paqja qoftë mbi të!) përshkruan Ditën e Gjykimit (shih Mateu, XXIV: 3, 4).

Krijuesi, më i Madhi betohet në Veten e Vet dhe në krijesat e Veta. Kjo ka, sigurisht përmbajtjen e vet fetare islame dhe vlerën e vet ideore islame: Allahu është më i Drejti dhe më i Drejti betohet. Atëherë, ti o njeri, nëse do që përmbajtja dhe vlera e betimit tënd në Allahun (siç do ta themi më poshtë, besimtari betohet vetëm në Allahun) të jenë tërësisht pozitive, betohu në drejtësi. Kur betimi bëhet me padrejtësi e në padrejtësi, përmbajtja dhe vlera e tij janë tërësisht negative. Në Suren 2, ajeti 224 thuhet: "Mos e bëni pengesë betimin në Allahun për kryerjen e veprave të mira, për largimin prej të këqijave dhe për pajtimin e njerëzve! Allahu i dëgjon dhe i di të gjitha". Ja, pra për çfarë mund të betohemi në Allahun. Kurse në suren 16, ajeti 94 thuhet: "Mos i përdorni betimet tuaja për të mashtruar njëri-tjetrin e kështu që t'i rrëshqasë këmba tjetrit, pasi e pati mbështetur fort atë dhe ju të mund të shijoni (pasojat) e këqija që i penguat (njerëzit) nga Rruga e Allahut e një Zemërim i madh të bjerë mbi ju!". Dhe ja se për çfarë nuk duhet t'i

bëjmë betimet tona. Sepse edhe Iblisi betohet në Allahun. Por ai betohet për të bërë keq: "Betohem në Madhërinë Tënde se unë do t'i mashtroj ata të gjithë". (38:82)[8] Po betimi i gënjeshtërt në Allahun? Betimi i gënjeshtërt në Allahun është njëlloj sikur të kërkosh mallkimin e Allahut mbi veten tënde. "Kur dikush shpif për të shoqen", - thuhet në Kur'an (24:6-9), pasi të betohet katër në Allahun se thotë të vërtetën, herën e pestë të kërkojë mallkimin e Allahut, nëse ka gënjyer". Një mësim i madh: Ta kërkojë vetë mallkimin e Allahut ai që shpif, ai që gënjen, ai që betohet në rrenë.

Allahu është Mëshirëmadh. Prandaj "Allahu ka urdhëruar për ju (o njerëz) një mënyrë për t'ju çliruar nga betimet tuaja (në raste të caktuara). Allahu është Mbrojtësi juaj". Kur, në ç'raste? Kur betimi që ke bërë, të pengon të bësh vepra të mira, të ndalosh të keqen, të bësh paqe midis njerëzve etj. Në raste të tilla njeriu e mohon betimin që pati bërë. Ky është, vërtet një çlirim i madh. Ja edhe dy çlirime të tjera të mëdha për njeriun. "Për Allahun! Ne qemë, vërtet në gabim të qartë". (26:97) Është betim kur kuptohet gabimi (dhe gabimi korrigjohet aq sa e njeh njeriu). Dhe betimi kur kuptohet e vërteta: "A është kjo e vërteta?" Ata do të thonë: "Po, për Zotin tonë!"

Betimi bëhet për çështje të mëdha. Nëse betimi bëhet për çështje të vogla e rëndom, nuk është më thirrje solemne (në parantezë, betimi në Allahun është njëherësh edhe thirrje solemne, apel solemn) për të tjerët.

8 Konkluzioni për njeriun: Por ti o njeri, mos e merr për mbrojtës Shejtanin. "Miqtë dhe mbrojtësit e tu janë vetëm Allahu, i Dërguari i tij dhe besimtarët që falin namazin dhe japin zekatin, duke qenë të përulur (në adhurim) ndaj Allahut" (5:55, 56).

Betimi bëhet me gjithë zemër. Allahu thotë: "Allahu nuk ju dënon nëse betoheni pa qëllim, por ju dënon për atë që vendosni në zemrat tuaja". (2:225)[9]

Betimi në Allahun mbahet deri në fund. Në Suren 3, ajeti 77, Allahu thotë: "Vërtet, ata që e shkëmbejnë premtimin dhe betimin e tyre ndaj Allahut me një vlerë të vogël, nuk do të kenë asnjë të mirë në Jetën Tjetër. Allahu nuk do t'u flasë atyre, as nuk do t'i shikojë Ditën e Gjykimit dhe as nuk do t'i spastrojë prej gjynaheve e për ta do të ketë dënim të dhembshëm". Betimi në Allahun nuk mund të thyhet: Allahu thotë: "Mos e thyeni betimin, pasi ta keni bërë atë, sepse e keni bërë Allahun dorëzanësin tuaj". (16:91). Nëse betohesh në Allahun dhe nuk e mban premtimin solemn (në parantezë, betimi është premtim solemn i dikujt, ndaj dikujt tjetër – në rastin tonë, ndaj Allahut, më të Madhit), atëherë ai jo vetëm nuk ka aspak përmbajtje solemne e vlera e tij është tërësisht negative, por është edhe mosrespekt i madh ndaj Krijuesit (Allahu na ruajtë!).

Përse nuk duhet të betohemi në askënd e në asgjë tjetër përveç Allahut? Sepse vetë Allahu na thotë: "Më besoni Mua! Ndiqni Fjalën Time!" Është një thirrje, një ftesë. Është Allahu Ai që i drejtohet njeriut që njeriu të mësojë të Vërtetën, të njohë Madhërinë e Allahut, ta njohë Atë si Zot, si Krijues, si Mbrojtës, si Ushqyes. Shih në Kur'an:

(4:65): "Për Zotin tënd!" (Ata nuk kanë besuar derisa ...)

(15:92): "Për Zotin tënd! (Ne do t'i thërrasim ata të japin llogari)".

9 Natyrisht, nuk mund të mbitheksohet betimi i njeriut. Edhe pa e shprehur me gojë betimin, besimtari bën më të mirën dhe përpiqet për më të mirën.

16:56: "Për Allah! (Ju do të thirreni të jepni llogari)".

16:63: "Për Allah! (Ne kemi çuar të dërguar)".

19:68: "Për Zotin tënd! (Ne do t'i tubojmë ata)".

34:3: "Po për Zotin tim! (Kjo / Ora e Kiametit do t'ju vijë)

51:23: "Për Zotin e qiejve dhe të Tokës! (Kjo është e Vërteta)".

64:7: "Po, për Zotin tim! (Pa tjetër do të ringjalleni)".

Përse duhet të betohemi vetëm në Allahun? Sepse Allahu është i Gjithëfuqishmi, sepse vetëm Ai e ka tërë Fuqinë ta përmbushë betimin tonë. Historia e betimit është e gjatë. Edhe paganët betoheshin. Betimi i tyre ishin idhujt. Idhulli ishte objekt i pajetë (gur, dru, shtatore etj.), të cilin njerëzit primitive e vishnin me fuqi të mbinatyrshme a magjike dhe e adhuronin si diçka të shenjtë. Sot, idhull janë kryqi, vende të ashtuquajtura të mira (varre, kisha etj.) etj. Sot idhulli është diçka që ngjall adhurim a respekt irracional, të pamotivuar e të pamerituar. Betimet pagane e ato të sotmet irracionale lidhen sigurisht edhe me format e mënyrat e gabuara të adhurimit, me zotat e gënjeshtërt, me mitet e padijen, me frikën nga fenomenet e natyrës etj. Nëse edhe sot dikush betohet, p.sh., me "për atë Diell!" a "Për atë zjarr!", do të thotë se Diellin a zjarrin i ka kthyer në diçka misterioze ose në panteon – mu ashtu si paganët, mu ashtu si në kohën e Profetit Ibrahim. Sigurisht, kjo është e papranueshme sepse është irracionale. Dielli dhe zjarri janë krijesa të Allahut. Prandaj ne adhurojmë Allahun e jo Diellin a zjarrin. Ky është koncepti kur'anor për adhurimin. Rrjedhimisht, nëse duam të betohemi, betohemi në Allahun

e jo në Diellin. Ky është koncepti kuranor për betimin. Ardhja e Kur'anit i përmbysi edhe betimet pagane – idhujtare të të gjitha kohëve. Edhe besimet e kota (në parantezë, betimet e kota janë edhe besime të kota).[10] Sepse ai përmbysi edhe zotat e rremë dhe format e mënyrat e gabuara të adhurimit.

Betimi në Allahun është pjesë e monoteizmit islam, me të gjitha kushtet dhe rrjedhojat e tij. Atëherë, përse nuk duhet të betohemi në krijesat e Allahut, por në Allahun? Sepse do të bënim shirk (Allahu na ruajttë!). Sepse ne besojmë vetëm tek Allahu. Sepse do të cenonim Teuhidin, thelbin e besimit, themelin dhe qëllimin e besimit, madje, edhe gëzimin që na vjen nga besimi (paqja dhe qetësia e çlirimi nga stresi). Në fund të fundit, çfarë ishte idhulli? Gur i gdhendur në trajtë njeriu. Pra, nuk ishte njeri, por gur. Njerëzit e shihnin si zot. Por ai nuk ishte zot; ai nuk fliste; ai nuk të bënte as mirë, as keq; ai ishte gur. Po të kishin qenë idhujt zota, Profeti Ibrahim (Paqja qoftë mbi të!) dhe Profeti Muhamed (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!) nuk do t'i kishin thyer. Thyerja e atyre gurëve ishte thyerje e konceptit që ha zemrën e njeriut. Ja si flet Profeti Musa (Paqja qoftë mbi të!): "Shikoje zotin tënd që ti e ke adhuruar vazhdimisht! Ne do ta djegim e pastaj hirin e tij do ta hedhim në det". (20:97). Dialogu i Ibrahimit (Paqja qoftë mbi të!) me adhuruesit e idhujve (shih në Kur'an Suren 21) është sinteza më e plotë e konceptit për idhujt.[11] Ky akt nuk ka të bëjë vetëm me idhujt e gurtë. Ai ka të bëjë edhe me idhujt njerëz. Si? Duke mos i adhuruar, çka do të thotë edhe duke mos u betuar në ta.

10 Shih H. Shehu-G. Asllani, *Ne jemi kundër besimeve të kota,* në "Drita e Kur'anit", 2013, 1.

11 Shih, gjithashtu në Kur'an 11:258; 28:38-40.

Në Allahun është betuar Profeti Muhamed (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!):[12] "Për Zotin tim! (ajo / Ora e Gjykimit do të vijë …"). (34:3) Dhe: "Thuaj: Për Zotin tim (ju do të ringjalleni …)" (64:7) Edhe Profeti Ibrahim (Paqja qoftë mbi të!) betohet në Allahun: "Për Allahun! Unë do t'i flak idhujt tuaj sapo të largoheni ju." (21:56) Është betimi kundër idhujtarëve. Betimin në Allahun e kërkon edhe Profeti Jakub (Paqja qoftë mbi të!): "Unë kurrsesi nuk do ta dërgoj me ju (Jusufin), derisa të betoheni në Allahun". (12:66) Betimin në Allahun e kërkojnë dhe e bëjnë besimtarët. Sepse besimtarët kanë nevojë për Allahun. Sepse ata kanë nevojë të adhurojnë Allahun dhe vetëm Allahun, sepse siç na mëson Kur'ani, nevoja për Allahun, frika nga Allahu dhe shpresa në Allahun është pjesë e natyrës së njeriut. Njeriu, nga natyra e tij e brendshme do ta njohë Allahun, do ta dijë ç'është Allahu. Si njihet Allahu? Allahu njihet me emrat dhe me atributet e tij. Emrat e Allahut janë 99.[13] Ata janë emrat më të bukur *(Al-Asmaa Al Husana)*. Emrat dhe atributet e Allahut përmenden thuajse në çdo sure të Kur'anit.[14] Çdo emër dhe çdo atribut përkufizon a përshkruan një veti a karakteristikë supreme të Allahut. Myslimanët besojnë në secilin prej emrave dhe atributeve të Allahut. Myslimanët besojnë edhe në të gjitha rezultatet që lidhen me këta emra e me këto atribute. Janë pikërisht këta emra e këto atribute që na thonë çfarë është Allahu (Një dhe vetëm Një + 98 emra të tjerë) dhe çfarë nuk është Allahu (Askush dhe asgjë nuk i ngjan atij / 42:11. Ai as nuk lind e as nuk është i lindur

12 Me urdhër të Allahut (shih foljen *kul* "thuaj").
13 Shih Hivzi Shehu, *99 emrat e Allahut,* "Drita e Kur'anit", 2013, 2.
14 Shih në Kur'an 20:8; 7:130; 59:22-24; 42:11, 12; 7:156; 5:54; 20:82 etj.

dhe askush e asgjë nuk është i barabartë (i krahasueshëm me Atë / 112:3, 4). Sa më shumë që ta njohë njeriu Allahun, aq më shumë do ta dojë Atë, do ta ketë frikë Atë dhe do të shpresojë në Atë. Për shembull, kur njeriu di se Allahu është i Gjithëmëshirshëm e Mëshirëplotë, atëherë ai e shumëfishon shpresën për Mëshirën e Tij. Kur njeriu e di se Allahu është Gjykatësi më i Drejtë, e ka frikë dhe e përnderon Atë. Kur njeriu e di se Allahu shikon e dëgjon gjithçka, atëherë është i kujdesshëm në veprimet e në veprat e veta. Kur njeriu e di se Allahu është Falës, atëherë i drejtohet Atij me pendim e me pendesë, çka do të thotë, njëherësh se nuk bën më vepra a veprime të këqija. Kur njeriu e di se feja është e Allahut, e vë në jetë ashtu siç thotë Allahu. Përfundimi: Kur njeriu e njeh Allahun dhe e di rezultatin që vjen nga kjo njohje, nuk mund të mos betohet në Allahun, për të treguar kështu me mendje dhe me zemër se ngulmon në atë që urdhëron Allahu. Në analizë të fundit, njeriu prandaj edhe është krijuar: ta njohë Allahun, ta adhurojë Allahun, të afrohet sa më shumë tek Allahu dhe nëse i duhet të betohet, të betohet vetëm në Allahun.[15]

15 Ai që falet me përkushtim, ndoshta, nuk ka nevojë të betohet.

**Hajri Mandri**

# ESTETIKA E LIGJËRIMIT NË KUR'AN

*Të folurit me paravoli është një veçori ligjërimore kur'anore, një stil i tij i veçantë i figurshëm. Nga ana përmbajtësore, paravolitë shfaqen në mënyrë specifike në Kur'an, si parakusht i kumtit që vjen pas. Në të vërtetë, kumti vjen pas paravolisë.*

*Estetikisht, njerëzit i pranojnë paravolitë si tregime të shkurtra, të këndshme, të bukura. Paravolia është mjeti bazë figurativ që përdoret në Kur'an. Të pafund janë shembujt, krahasimet, simbolet, që ndërtojnë sistemin alegorik të Kur'anit që na tregon se shëmbëlltyra dhe paravolia janë një gjedhe e ardhur nga letërsia kur'anore dhe si e tillë burimet dhe origjina e saj duhen kërkuar pikërisht në ato kumte. Edhe tregimet kur'anore, në të gjitha rastet e tubimeve jepen dhe interpretohen gojarisht. Ato shndërrohen në mesazhe të fuqishme në foltore në ritet dhe festat fetare, duke i pasuruar me shëmbëlltyra. Një ajet kur'anor thotë:* ***"Vërtet, Ne u kemi sjellë njerëzve shembuj në këtë Kur'an për çdo gjë, për t'ua vënë veshin."*** *Këtu parashkruhet në mënyrë mjaft të qartë funksioni i paravolisë, si shembull përngjasues. Me një strukturë gjuhësore koncize dhe me pak fjali paraqit kumtin dhe argumentin.*

Të folurit me paravoli[1] është një veçori ligjërimore kur'anore, një stil i tij i veçantë i figurshëm. Nga ana përmbajtësore, paravolitë shfaqen në mënyrë specifike në Kur'an, si parakusht i kumtit që vjen pas. Në të vërtetë, kumti vjen pas paravolisë.

Në aspektin filozofik, retrospektiva në paravolitë kur'anore shërben për të thirrur perspektivën, pasi përbëjnë një retrospeksion, duke lidhur të kaluarën me të tashmen, të sotmen me të ardhmen. Kështu në ligjërim, përmes paravolisë, si ilustrim dhe nevojë ngjashmërie, lexuesi dhe dëgjuesi fiton një përftesë kohore, shumëkuptimësi, kënaqësi estetike, ashtu si edhe paralelizëm figurativ në shkrimin letrar. Paravolitë në Kur'an janë një investim kulturor, për t'i dhënë komunikimit hijeshi dhe finesë, duke i përdorur ato në kohën e duhur dhe në vendin e duhur. Estetikisht, njerëzit i pranojnë paravolitë si tregime të shkurtra, të këndshme, të bukura. Ato janë kujtesë që shndërrohen në imazh dhe pastaj në kumt, në zë, në zërin tjetër që fle dhe zgjohet në thellësitë e njeriut. Ligjërimi me paravoli, si rregull nuk përftohet në një komunikim të rëndomtë, por në një komunikim solemn, që ka si kusht një audience-bashkësi, e cila nuk është asnjanëse në kontekst. Fuqia e audiencës është gjithëpranuese ndaj precedentit.

Prania e audiencës i jep paravolisë funksione kanonizuese. Në tregimet kur'anore, janë të dy modelet e parabolës: me porosi morale të drejtpëdrejtë dhe me porosi morale të

1 Paravolia, parabola dhe shëmbëlltyra janë i njëjti term, por me burim të ndryshëm gjuhësor. Nuk ka ndonjë kufi të prerë mes tyre, por zakonisht nuk e zëvendësojnë njëra-tjetrën.

nënkuptuar. Në shumicën e rasteve paravolia mbyllet me nënkuptime. Paravolia vë në provë urtësinë e rrëfyesit dhe të dëgjuesit. Gjithnjë ka një sekret, një kumt të kodifikuar, që rrëfyesi dhe audienca e ndajnë bashkë, nëse kanë urtësinë e mjaftueshme.

Paravolia është mjeti bazë figurativ që përdoret në Kur'an. Të pafund janë shembujt, krahasimet, simbolet, që ndërtojnë sistemin alegorik të Kur'anit që na tregon se shëmbëlltyra dhe paravolia janë një gjedhe e ardhur nga letërsia kur'anore dhe si e tillë burimet dhe origjina e saj duhen kërkuar pikërisht në ato kumte. Edhe tregimet kur'anore, në të gjitha rastet e tubimeve jepen dhe interpretohen gojarisht. Ato shndërrohen në mesazhe të fuqishme në foltore në ritet dhe festat fetare, duke i pasuruar me shëmbëlltyra. Ato krijojnë në publik situata mjaft tërheqëse ligjërimore, me forcën e ideve, bukurinë artistike dhe aftësinë shprehëse të gjuhës, që zakonisht citohen në arabisht dhe komentohen në shqip. Oratoria ligjërimore islame ka mjaft episode mahnitëse dhe të ndërthurur bukur me metafora, hiperbola, metonimi dhe simbole, me krahasime dhe paralelizma që krijojnë paravoli të këndshme, të cilat të mbeten në mendje, të rrënjosen thellë në shpirt dhe në kujtesë dhe të bëjnë të reflektosh thellë, duke u bërë më i vetëdijshëm, më human, më i sigurt. Kur'ani është një arsenal i madh paravolish. Dihet mirë se profeti Muhamed nuk dinte shkrim e këndim. Ai e përcolli gojarisht Kur'anin. Kur'ani u kthye në ligjërim shkrimor vetëm në shekullin e 8-të.

Në paravolinë për Profetin Ibrahim[2], ne marrim mesazhin se fëmijët janë fryt i Zotit. Profeti Ibrahim kishte dy gra. Njëra ishte Sara dhe tjetra, Haxhar, e cila ishte egjiptiane. Ai iu lut Zotit që t'i jepte një djalë të mirë, në moshën 86 vjeç. Allahu ia dëgjoi lutjen dhe ai u bë me djalë.

Pastaj vjen paravolia për sakrificën njerëzore dhe bindjen e profetit Ibrahim, kur ai u vu në provë nga Allahu duke u urdhëruar që të flijonte të vetmin djalë të tij. Babai e përcolli fjalën e Zotit tek i biri dhe djali e pranoi menjëherë, nëse ishte dëshira e Allahut. Babai nuk duhet të hezitonte ta sakrifikonte atë. Kur djalin 14 vjeç e shtriu për tokë me sy mbyllur, Allahu e zëvendësoi djalin, Ismailin, me një dash. Të dy, Profeti dhe i biri, Ismaili, dolën me sukses nga prova e bërë nga Allahu.

Mesazhi, për të cilin është ngritur paravolia, është ky: Allahu e ndaloi profetin Ibrahim që të sakrifikonte të birin. Në Islam nuk lejohet sakrifica njerëzore.

Figura e shejtanit është mjaft interesante në paravolinë e mëposhtme:

**"Shejtani do të na afrohet nga e djathta në të majtë, duke u betuar se është këshilltari më i sinqertë"** (Kur'an, 7:21)

Kumti i kësaj shëmbëlltyre është ky:

2 Profeti Ibrahim njihet si babai i profetëve dhe si khalilulla (khalil do të thotë *mik*). "**Allahu e provoi profetin Ibrahim në urdhrat e tij të ndryshëm. Profeti Ibrahim përmbushi secilën detyrë. Si rrjedhojë Allahu e bëri atë model për njerëzimin, në çdo gjë dhe në çdo akt me dëshirën e tij, ai përmbushi detyrën ndaj Allahut, pa pasur ndonjë frikë për ndonjë persekutim. Allahu ishte i njohur mirë me të"** (Kur'an, 21:51)

Shejtani, armiku ynë kryesor na sillet si shok. Ai është shumë i djallëzuar sepse ka miliona vjet përvojë në manovrat e tij… Kjo nuk do të thotë që ne të dorëzohemi. Profeti Muhamed kurrë nuk u dorëzua. Ne duhet të jemi të vendosur në mposhtjen e shejtanit.

Një ajet kur'anor thotë: "**Vërtet, Ne u kemi sjellë njerëve shembuj në këtë Kur'an për çdo gjë, për t'ua vënë veshin.**"[3] Këtu parashkruhet në mënyrë mjaft të qartë funksioni i paravolisë, si shembull përngjasues. Me një strukturë gjuhësore koncize dhe me pak fjali paraqit kumtin dhe argumentin. Shëmbëlltyrat kur'anore janë një arsenal mjaft i pasur estetik, për të ndjerë dhe kuptuar atë që nuk e shikon, nuk e percepton apo nuk e kupton. Paravolitë janë lejtmotiv i ligjërimit estetik në Kur'an. Për ta ilustruar këtë ide po japim ajetin e mëposhtëm:

**"Jepu atyre shembullin e jetës së kësaj bote: ajo është si uji që Ne e lëshojmë nga qielli; bimësia në tokë përzihet me të, por pastaj bëhet si bar i thatë,** të cilin e shpërndan era. Allahu është **i Fuqishëm për çdo gjë."** (Sure "Kehf", ajeti 45)

Në këtë shembullsim Zoti e ka përkrahasuar jetën e njerëzve mbi tokë me ujin që zbret nga qielli; ai u jep jetë bimëve e pas një kohe të shkurtër jete, bimët fishken. Mendojmë se pika më e bukur në këtë përngjasim është se jeta është ujë dhe uji është jetë.

Morali i frikës si porosi e drejtpërdrejtë jepet në paravolitë e mëposhtme:

3 Ez Zumer, 27, *Drita e Kuranit*, 2007. f. 115.

**"Rasti i tyre shëmbëllen me ata që, gjatë shtrëngatës**

**nga qielli, shoqëruar me errësirë, bubullimë dhe shkreptimë, i mbyllin veshët me gishtat e tyre, për të mos dëgjuar ushtimën nga frika e vdekjes. Kështu, Allahu i ka nën kontroll mohuesit."** (Sure "Bekare", ajetet 17-19)

Kur paravolia hyn në fushën e alegorisë, ajo merr një kuptim më të thellë për ta përthithur:

**" Mohuesit u shëmbëllejnë kafshëve, të cilat, kur i thërret dikush, dëgjojnë vetëm thirrje e zë, por s'kuptojnë asgjë. Ata janë të shurdhër, memecë dhe të verbër e nuk kuptojnë asgjë."** (Sure "Bekare", ajeti 171)

Veçori dalluese te paravolitë në Kur'an është mënyra unike e sqarimit të ideve, në mënyrën e të shprehurit në strukturën e fjalive. Vështrojmë paravolinë e mëposhtme:

**"Ata që e shpenzojnë pasurinë e vet në rrugë të Allahut, i shëmbëllejnë atij që mbjell një kokërr nga e cila dalin shtatë kallinj, ku secili kalli ka nga njëqind kokrra. Allahu ia shton** (shpërblimin) **edhe më shumë kujt të dëshirojë. Allahu është Mirëbërës i Madh dhe i Gjithëditur."** (Sure "Bekare", ajeti 261)

Në këtë paravoli, përmes një paralelizmi figurativ vihen përballë njerëzit që e shpenzojnë pasurinë e vet në rrugën e Allahut dhe bujku që mbjell një kokërr dhe që i qindrafishohet prodhimi. Këtu përftohet kuptimi për fuqinë e Allahut Mirëbërës. Shëmbëllesa këtu është mjeti shprehës që qëndron si bazë e figurës së paravolisë.

E kundërta do të ndodhte në rastin e shpenzimeve që bëjnë

jobesimtarët:
**"Gjithçka që jobesimtarët e shpenzojnë në jetën e kësaj bote, i përngjan erës së akullt, e cila godet** të lashtat e ndonjë populli, që **i ka bërë dëm vetes dhe ua zhduk t**ë lashtat. Allahu nuk u ka bërë **padrejtësi atyre, por ata i kanë bërë padrejtësi vetvetes."** (Sure "Ali Imran", ajeti 117)

Në këtë rast, ku njeriu hyn në marrëdhënie me natyrën, kemi një sistem simbolik që përbën paravolinë. Në pak rreshta kemi personifikime, metafora, metonimi. Në fund, paravolia mbyllet me porosinë, si kumt për t'u dëgjuar dhe përvetësuar: "**Këta janë shembuj që t'ua vini veshin."**

**"Ai i dërgon erërat si lajmëtare të mëshirës së Tij. Kur erërat lëvizin retë e rënda me shi, Ai i çon ato tek ndonjë vend i vdekur, ku lëshon shi dhe me anë të tij nxjerr lloj-lloj frutash; po kështu do t'i ringjallë edhe të vdekurit. Këta janë shembuj që t'ua vini veshin".** (Sure "A'raf", ajeti 57)

Në aspektin e ligjërimit, paravolitë përcjellin mesazhe botëkuptimore dhe estetike, si nevojë njerëzore për disiplinë, frymëzim dhe energji . "**Vallë, a nuk e sheh se si Allahu e përqas fjalën e mirë me pemën e mirë, e cila rrënjën e ka të fortë në tokë, kurse degët nga qielli? Me lejen e Zotit të saj** (pema) **jep fruta në çdo kohë. Allahu u tregon shembuj njerëzve, që t'ua vënë veshin. Fjala e keqe është si pema e keqe me rrënjë të shkulura, e paqëndrueshme për ekzistencë."** (Sure "Ibrahim", ajetet 24-26)

Përgjatë ligjërimit, paravolia kur'anore shkakton estetikisht një reaksion zinxhir të moralit: nxit ndjenjë, përfytyrim, ndijim, perceptim. Mesazhi paravolik themelor qëndron zakonisht te kumti: Nuk ka fitore të njeriut, të jetës, nuk ka sfidë dhe arritje që nuk përfaqësohet nga fitorja morale. Njeriu në jetë realizon më mirë atë që beson më shumë.

# TRASHËGIMIA KUR'ANORE TE SHQIPTARËT:

## Koment i sures "El-Gashije"[1] nga Sherif Ahmeti

Abstrakt

*Këtu do të lexoni suren* **El-Gashije,** *marrë nga Kur'an-i, Përkthim me komentim në gjuhën shqipe, i autorit Sherif Ahmeti. Surja El-Gashije sjell argumente të nevojës së domosdoshme për besim dhe ato i përqendron në dy pika si më kryesore:*
*-në argumentet që dokumentojnë për fuqinë e një Zoti krijues dhe numëron disa prej tyre,*
*-në faktet që dokumentojnë se kjo ekzistencë do të ketë fundin e vet, por katastrofa e saj do të jetë e tmerrshme.*

E zbritur në Meke, pas sures Edh Dharijati, ajete: 26. Kjo sure e shpallur në Mekë sjell argumente për domosdoshmërinë për besim. Argumentet përqendrohen në dy çështje si më kryesore:
- fuqia e një Zoti krijues
- kjo ekzistencë do të ketë fundin e vet dhe katastrofa e saj do të jetë e tmerrshme.

Quhet "Suretul Gashijeti" – kaptina e kaplimit, ngase

1 *Kur'an-i, Përkthim me komentim në gjuhën shqipe*, Sherif Ahmeti, f. 708-710, 1992 (1413 hixhreti).

beteja e Kijametit i kaplon njerëzit me ato veçoritë e tij.

## Me emrin e Allahut, Mëshiruesit, Mëshirëbërësit!

1. A të erdhi ty lajmi për belanë që kaplon (Kijameti)?
2. Atë ditë sheh fytyra të përulura.
3.Të lodhura e të rraskapitura (nga mundimi).
4. Ato hyjnë në zjarrin të ndezur fort.
5. U jepet të pijnë prej një kroi të valë.
6. Ata nuk kanë ushqim tjetër posnjë barishte me ferra helmuese.
7. Që as nuk jep fuqi, as nuk largon uri.
8. Atë ditë sheh fytyra të ndritshme.
9. Të kënaqura për veprimet e tyre,
10. Në Xhenet të shkallës së lartë,
11. Aty nuk dëgjon fjalë të pakëndshme,
12. Aty ka kroje që rrjedhin,
13. Aty kanë shtretër të lartë,
14. Dhe gastare të vëna pranë,
15. Edhe jastëkë të renduar për mbështetje,
16. Edhe qilima të shtruar.
17. A nuk i shikojnë devet se si janë krijuar?
18. Edhe qiellin se si është ngritur lart!
19. Edhe kodrat si janë venduar!
20. Edhe tokën se si është shtruar!
21. E ti pra, këshillo, se je vetëm përkujtues,
22. Ti ndaj tyre nuk je mbizotërues!

23. Përveç atij që zbrapset e nuk beson,
24. Allahu atë me vuajtje të mëdha e dënon.
25. Vetëm te Ne rikthimin e kanë.
26. Dhe vetëm detyrë Jona është llogaria e tyre.[2]

2 Dita e Kijametit quhet edhe Gashije, mbulim, kaplim, sepse e keqja e asaj dite përfshin të gjitha krijesat. Në atë ditë do të ketë fytyra të zbehta e të shëmtuara, sepse kanë punuar punë të këqija, janë munduar dhe janë lodhur dhe ato janë shkak që t'i fusin në Xhehenem, në zjarr me temperaturë të lartë, ku nuk kanë çka të pijnë tjetër, vetëm se ujë shumë të valë dhe ushqim të keq. Përmendet një bimë me ferra, që nuk e ha tjetërkush përveç deves, madje vetëm sa është e njomë. Ky lloj ushqimi as nuk jep fuqi e as nuk ngop.
Në anën tjetër, atë ditë ka fytyra të shkëlqyera, sepse janë të kënaqura me veprat e mira që kanë bërë, e tash janë shpërblyer me Xhenet.
"Ekvab" nënkuptojmë enët si gota pa vegë (e këtu përdorim termin "gastare").
Zoti (xh.sh) thërret njerëzit të shikojnë qiellin si është ngritur si kulm, por pa shtylla, tokën e përshtatur për jetë, kodrat e vendura si shtylla të tokës. Këto kujtime e krijesa janë përmendur në mënyrë sipërfaqësore, aq sa ai popull i atëhershëm ka mundur t'i kuptojë, përndryshe, çdo fjalë e thënë për këto krijesa ka një domethënie të thellë për të arriturat e tashme.
Në fund i thuhet Pejgamberit (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!) se detyrë jotja është këshillimi, përkujtimi, e jo me dhunë të pranojnë fenë e Zotin, sepse kundërshtarët nuk mund të ikin e të shpëtojnë; ata te Zoti do të shkojnë e Ai u jep atë që e meritojnë.
Falënderoj Allahun e Madhëruar!

# HISTORI E PROFETËVE

**Ali Muhamed Ali Duhajjil Dehili**

# PROFETI HUD

*(paqja e Allahut qoftë mbi të!)*

*Abstrakt*

*Në këtë artikull tregohet historia e profetit Hud (paqja qoftë mbi të!). Popullin e Hudit (paqja qoftë mbi të!) e goditi tufani dhe e shkatërroi. Ata pak njerëz që shpëtuan bashkë me Nuhun (paqja qoftë mbi të!), filluan të shtoheshin. Vlen të theksojmë se të gjithë ishin monoteistë, adhuronin dhe besonin vetëm një Zot. Por me kalimin e kohës, tek fisi Ad filloi të përhapej sërish idhujtaria. Si rezultat i mosbesimit të këtij populli, Zoti i Lartësuar dërgoi profetin Hud. Hudi ua kujtoi mirësitë dhe begatitë që u kishte dhënë Zoti. Hudi filloi t'i sfidonte. Ndëshkimi i Zotit për këtë popull ishte me një stuhi ere, që nuk ka të ngjashme me të në të gjithë historinë njerëzore.*

Një nga fëmijët e Nuhut (paqja qoftë mbi të!), ishte dhe Sami, prej të cilit rridhnin arabët dhe hebrenjtë. Një ndër pasardhësit dhe pinjollët e Samit ishte Hudi (paqja qoftë mbi të!). Emri i tij ishte Hud, i biri i Abdullahut, i biri i Rebahut, i biri i Xharudit, i biri i Adit, i biri i Ausit, i biri i Iremit, i biri i Samit, i biri i Nuhut (paqja qoftë mbi të!).

Shpeshherë, populli i Hudit, njihet edhe me emrin Ad dhe Irem, për shkak të gjyshërve të tij (Hudit).

Populli i Hudit (paqja qoftë mbi të!) jetonin në një rajon që njihej me emrin Ahkaf, emër të cilin e ka marrë dhe një nga suret e Kur'anit. Vetë fjala *Ahkaf*, do të thotë duna rëre. Ahkaf ndodhej në Jemen, mes Omanit dhe Hadramaut, në një vend që shtrihej mbi det dhe që njihej me emrin Shihr. Zoti në Kur'an thotë: **"Kujtoje vëllanë e fisit Ad** (Hudin), **kur e paralajmëroi popullin e vet në Ahkaf."** ("Ahkaf", 21)

Kjo popullatë, ndërtimin e shtëpive e kishin kthyer në art. Shtëpitë e tyre të preferuara ishin çadrat, por që nuk ishin aspak të zakonta. Ato ishin shumë të mëdha dhe plot dekoracione.

**"Vallë, a nuk e di ti se çfarë ka bërë Zoti yt me fisin Ad, banorë të Iremit me pallate shumështyllëshe, të atillë që nuk janë krijuar askund tjetër në tokë si ata?!"** ("Fexhr", 6-8)

Ata ishin mjeshtër të ndërtimit të shtëpive, rrugëve, fshatrave e qyteteve. Në vendet e sheshta, ata ndërtonin dhe banonin në çadra. Në kodra e male ndërtonin pallate dhe shtëpi të larta. Rrugët e qyteteve të tyre ishin të gjera dhe të bukura. Disa thonë që për dekoracionet e mureve përdornin flori dhe argjend, por këtë veç Zoti e di më mirë.

Gjuha që fliste populli i Hudit (paqja qoftë mbi të!) ishte arabishtja. Vetë Hudi ishte arab, gjë e cila ceket në një hadith të transmetuar nga Ibnu Hibani, sipas të cilit, Profeti (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!) po i fliste Ebu Dherit mbi profetët e Zotit. Veç të tjerash, ai i thotë:*"...Katër prej tyre janë arabë: Hudi, Salihu, Shuajbi dhe Profeti yt o Ebu Dher."*

Pas tufanit që goditi tokën dhe shkatërroi njerëzimin,

ato pak njerëz që shpëtuan bashkë me Nuhun (paqja qoftë mbi të!), filluan të shtoheshin. Ata banonin në veri të Shamit (Lanton), ose më saktë në jug të Turqisë. Që andej, ata filluan të shpërnguleshin në Sham, në Gadishullin Arabik, ku fisi Ad arritën në jug të Gadishullit Arabik. Vlen të theksojmë se të gjithë ishin monoteistë, besonin dhe adhuronin vetëm një Zot. Por me kalimin e kohës, tek fisi Ad filloi të përhapej sërish idhujtaria. Ata ishin të parët që filluan të adhuronin idhujt pas tufanit që goditi tokën në kohën e Nuhut.

Përveç se ishin të aftë dhe mjeshtër në ndërtim, Zoti u kishte dhënë dhe fizik të zhvilluar, gjë e cila përmendet dhe në Kur'an. Interpretuesit e Kur'anit i përshkruajnë me lëkurë të bardhë, të gjatë dhe të bëshëm. Zoti në Kur'an thotë: **"Kujtoni që Ai ju bëri zëvendës pas popullit të Nuhut dhe ju dha trup e fuqi të madhe. Kujtoni dhuntitë e Allahut, në mënyrë që të keni sukses!"** ("Araf", 69)

Zoti cek në Kur'an edhe zhvillimin në ndërtim të këtij populli. Zoti në Kur'an thotë, në gjuhën e profetit Hud (paqja qoftë mbi të!): **"A mos vallë në çdo kodrinë po ngrini përmendore, për t'u tallur dhe ngrini pallate, sikur do të jetoni gjithmonë?"** ("Shuara", 128)

Duke qenë se ndërtonin përmendore, pallate e vila në male, Hudi u thoshte: *"Përderisa banoni në fusha, përse ndërtoni vila e pallate në kodra e male?!"*

**"...dhe ngrini pallate, sikur do të jetoni gjithmonë? Edhe kur përdorni forcën, e shfrytëzoni atë si tiranë. Andaj, frikësojuni Allahut dhe bindmuni mua! Frikësojuni Atij, i Cili ju ka dhuruar ato që i dini: ju dhuroi juve bagëti dhe fëmijë, edhe kopshte, edhe burime."** (Shuara, 128-134)

Popullit të Adit nuk i mungonte asgjë, por nuk e falënderonte Zotin e Lartësuar për mirësitë që kishte derdhur mbi të. Sikur të mos u mjaftonte kjo, ata filluan të tregoheshin arrogantë dhe mendjemëdhenj. Zoti i Lartësuar

në Kur'an thotë:"**Sa i përket fisit Ad, ata u treguan arrogantë në Tokë dhe, pa kurrfarë të drejte, thoshin: "Kush është më i fortë se ne?" Vallë, a nuk e dinin ata se Allahu që i kishte krijuar, është më i fuqishëm se ata?! Kështu, ata i mohuan shpalljet Tona.**" ("Fussilet", 15)

Si rezultat i mosbesimit të këtij populli, Zoti i Lartësuar dërgoi profetin Hud.

**"Fisit Ad i dërguam vëllain e tyre - Hudin. Ai tha: "O populli im! Adhuroni Allahun, ju nuk keni zot tjetër përveç Tij. A nuk po i ruheni dënimit?" Paria e popullit të tij që nuk besonte, tha: "Ne shohim tek ti mendjelehtësi dhe mendojmë se je gënjeshtar". Ai tha: "O populli im! Unë nuk jam mendjelehtë, por jam i dërguar nga Zoti i botëve. Unë ju sjell shpalljet e Zotit tim dhe jam këshilltar besnik. A po çuditeni që këshilla e Zotit tuaj t'ju vijë nëpërmjet një njeriu prej jush, i cili ju tërheq vërejtjen? Kujtoni që Ai ju bëri zëvendës pas popullit të Nuhut dhe ju dha trup e fuqi të madhe. Kujtoni dhuntitë e Allahut, në mënyrë që të keni sukses!"** ("Araf", 65-69)

Hudi ua kujtoi mirësitë dhe begatitë që u kishte dhënë Zoti, por ata as që ia vinin veshin.

**"Fisit Ad** (Ne i dërguam) **vëllanë e tyre Hudin. Ai tha:"O populli im, adhuroni Allahun! Ju nuk keni Zot tjetër përveç Tij; ju jeni vetëm trillues."** ("Hud", 50)

**"O populli im! Unë nuk kërkoj nga ju shpërblim për këtë. Mua më shpërblen vetëm Ai që më ka krijuar! A nuk kuptoni?! O populli im! Kërkoni falje nga Zoti juaj dhe kthehuni tek Ai të penduar, se Ai do t'ju sjellë shi të begatshëm dhe do t'ju shtojë fuqi mbi fuqinë tuaj. Mos u shmangni prej Atij duke qenë keqbërës!"** ("Hud", 50-52)

Me gjithë tentativat e Hudit (paqja qoftë mbi të!), ata vazhdonin me idhujtarinë e tyre. Në vend që ta besonin

Hudin, ata filluan të talleshin dhe ta ofendonin. Ata i thanë: **"Paria e popullit të tij që nuk besonte, tha: 'Ne shohim tek ti mendjelehtësi dhe mendojmë se je gënjeshtar.'"** ("Araf", 66)

**"Ata thanë: 'O Hud! Ti nuk na ke sjellë kurrfarë prove të dukshme për fjalët e tua, ne nuk do t'i braktisim zotat tanë dhe nuk të besojmë ty! Ne themi vetëm se ty të ka goditur ndonjë e keqe nga zotat tanë'"** ("Hud", 53-54)

**"Por paria e popullit të tij, e cila nuk besonte dhe e mohonte takimin në Botën Tjetër dhe, së cilës, i kishim dhënë të mira në këtë botë, tha: 'Ky është vetëm njeri si ju, ha nga ato që hani edhe ju dhe pi nga ato që pini edhe ju! Nëse ju i bindeni një njeriu si ju, me siguri, do të jeni të humbur! A ju premton ai që, kur të vdisni e të bëheni pluhur dhe eshtra, do të ringjalleni vërtet?! Sa premtim qesharak që është! Nuk ka jetë tjetër përveç jetës së kësaj bote, ne jetojmë e vdesim e nuk do të ringjallemi më. Ai është vetëm një njeri që trillon gënjeshtra për Allahun, prandaj nuk i besojmë atij.'"** ("Mu'minun", 33-38)

Duke parë rezistencën e Hudit (paqja qoftë mbi të!) dhe pasionin e tij për t'i këshilluar, i thanë:

**"Ata thanë: 'Për ne është njëlloj: na këshillove ose nuk na këshillove ti. Këto janë vetëm doket e popujve të lashtë e ne nuk do të jemi të dënuar.'"** ("Mu'minun", 136-138)

Me këtë rast, Hudi filloi t'i sfidonte, ashtu siç e sfidoi më parë Nuhu popullin e tij idhujtar.

**"Ai tha: 'Unë kam dëshmitar Allahun, por dëshmoni edhe ju, se unë jam larg nga idhujt që ju i adhuroni në vend të Tij. Të gjithë ju bëni komplot kundër meje dhe mos më jepni afat aspak!'"** ("Hud", 54-55)

Hudi (paqja qoftë mbi të!) e luti Zotin e Lartësuar me fjalët:

“(I Dërguari) **tha: ‘O Zoti im, më ndihmo, sepse ata më akuzojnë se gënjej!’”**

“(Allahu) **tha: ‘Së shpejti do të pendohen!’”** (“Mu’minun”, 39-40)

## **Si e ndëshkoi Zoti popullin e Hudit** (paqja qoftë mbi të!)?

Ndëshkimi i Zotit për këtë popull ishte me një stuhi ere, që nuk ka të ngjashme me të në të gjithë historinë njerëzore. Si fillim, në atë rajon ndaloi shiu, gjë e cila shkaktoi një zinxhir pasojash të rënda. Të mbjellat dhe pemët filluan të thaheshin dhe kafshët filluan të ngordhnin. Të gjithë njerëzit prisnin me padurim të binte shi dhe të ringjallej ekonomia. Një ditë, nga larg ata dalluan një re të zezë. Këtë e komentuan si një sihariq të madh, pasi pritej të binte shiu i shumëpritur. Zoti në Kur’an thotë:

**“Dhe kur panë një ré që u duk se vinte në drejtim të luginave të tyre, ata thanë: ‘Kjo re po sjell shiun!’ ‘Jo!’ – u përgjigj ai – ‘Kjo është ajo që ju e keni shpejtuar: një erë që mbart një dënim të dhembshëm, që, me urdhrin e Allahut, shkatërron çdo gjë.’ E në mëngjes u panë vetëm shtëpitë e tyre të zbrazëta; ja, kështu e ndëshkojmë Ne popullin keqbërës.”** (“Ahkaf”, 24-25)

Gjithçka u rrënua, shtëpitë, fabrikat, pemët, bimët e të tjera, përveç shtëpive që kishin gdhendur në shkëmbinjtë malorë.

“(Mësim ka edhe në historinë) **e fisit Ad, kur i dërguam erën shkatërruese, e cila, ngado që kaloi, nuk kurseu asgjë, duke i kthyer në kalbësira.”** (“Dharijat”, 41-42)

**“Edhe fisi Ad e quajti gënjeshtar** (të dërguarin Tonë)**, por sa i tmerrshëm qe dënimi Im pas paralajmërimeve të Mia! Ne u dërguam atyre në një ditë fatkeqe një erë të**

**stuhishme të pandërprerë, e cila i nxirrte njerëzit, sikur të ishin trungje të shkulura hurmash. Eh, sa i tmerrshëm qe dënimi Im pas paralajmërimeve të Mia!"** ("Kamer", 18-20)

Stuhia i ngrinte njerëzit përpjetë dhe kur i përplaste, ua shkulte kokën nga trupi.

**"...kurse fisi Ad u shkatërrua nga një furtunë shungulluese të rreptë, të cilën Allahu ua dërgoi atyre shtatë net dhe tetë ditë pareshtur. Atëherë mund t'i vëreje njerëzit të përmbysur si trungjet e hurmave të kalbura. A sheh ndonjë gjurmë të tyre?"** ("Hakka", 6-8)

Lidhur me profetin Hud (paqja qoftë mbi të!), Zoti e shpëtoi nga ky dënim i frikshëm dhe i tmerrshëm. Stuhia e erës rrënonte dhe përpinte gjithçka tjetër, përveç vendit ku qëndronte Hudi dhe ithtarët e tij. Thuhet se ai bashkë me ithtarët dhe disa kafshë ndodheshin në një vathë.

**"Me mëshirën Tonë, Ne e shpëtuam Hudin dhe të gjithë besimtarët që ishin me të dhe i asgjësuam ata që i mohuan shpalljet Tona. Ata ishin të gjithë mosbesimtarë."** ("Araf", 72)

**"Kur erdhi urdhri Ynë, me mëshirën Tonë, Ne e shpëtuam Hudin bashkë me besimtarët e tij. I shpëtuam ata nga dënimi i rëndë. Ja, ky ishte fisi Ad. Ai i mohonte shenjat e Zotit të tij, nuk i dëgjonte të dërguarit e Tij dhe shkonte pas urdhrit të çdo keqbërësi kokëfortë. Ata i ndoqi mallkimi në këtë jetë dhe në Ditën e Kiametit. Me të vërtetë, fisi Ad e mohoi Zotin e tij. Qoftë larguar** (nga mëshira e Allahut) **fisi Ad, populli i Hudit!"** ("Hud", 58-60)

Hudi (paqja qoftë mbi të!) bashkë me besimtarët jetuan po në atë rajon. Ai vdiq dhe u varros në Hadramaut.

**Qani Banaj**

# PËR ÇDO SËMUNDJE KA ILAÇ: MJALTI

Abstrakt

*Mjalti ka një përdorim të gjerë, si në ushqim, edhe në mjekim. Mjalti del i përpunuar nëpërmjet gjëndrave të bletës, që janë të pasura me enzima të ndryshme. Allahu ua ka dhuruar njerëzve për nevojat e veta, si ushqim dhe si mjekim. Mjalti këshillohet në disa përdorime, si: Përdorimi nga pickimi i insekteve, përdorimi në artrit, përdorimi në rënien e flokëve Infeksione të fshikëzës së urinës, përdorimi në problemet me kolesterolin, përdorimi në infertilitet (sterilitet), përdorimi dermatogjik (puçrra), përdorimi për kancerin, përdorimi për erën e keqe të gojës, për ulçerën e stomakut etj.*

Mjalti ka një përdorim të gjerë, si në ushqim edhe në mjekim. Ai është një embëlsirë e gatshme që Allahu ua ka dhuruar njerëzve për nevojat e veta, si ushqim dhe si mjekim. Mjalti del i përpunuar nëpërmjet gjëndrave të bletës, që janë të pasura me enzima të ndryshme si psh: iventozë, katalozë. Ato marrin pjesë në proceset biokimike të shndërrimit në kthimin në saharozë (sheqer) glukozë (i ëmbël), fruktozë (sheqeri i frutave), lavulozë (lëndë organike që i përket grupit të karbohidrateve), ketoheksozë (që ndodhet në frutat e ëmbla). Mjalti përmban karbohidrate, proteinë, ujë, lëndë minerale (acide, azot etj.). Ai përmban vitamina B1, B2, B6, C, K, PP, acid pantotenik etj. Mjalti përmban edhe këto enzima: diastaza, peptidoza, peroksidoza, kataloza, fosfotoza, krozimoza. Karbokoilaza, peroksidoza dhe lipoza luajnë një rol të rëndësishëm në zbërthimin e lëndëve kryesore dhe në asimilimin nga organizmi. Mjalti përmban shumë mikroelemente, si: silica, alumini, hekuri, kalciumi, magnezi, natriumi, kaliumi, mangani, bakri, nikeli, kromi, zinku, kobalti, plumbi, fosfori dhe antivoni. Në përmbajtjen e këtyre

larmive që përmendëm më lart, mjalti ka një rëndësi të madhe ushqyese dhe mjekuese.

Mjalti përdoret në sëmundjet e lëkurës (Micine) Zhunge, bllunge, mllef, për këto sëmundje merret mjalti dhe përzihet me miell gruri të pasitur dhe bëhet përzierja. Vihen kompresa 2-3 herë në ditë dhe pas disa ditësh vjen shërimi. Ai përdoret edhe për sëmundjen e syve, duke hedhur disa pika mjaltë ose 3-4 pika mjaltë një herë në ditë. Ai përdoret për sëmundjen e shiatikut: Merret mjalti, përzihet me gëlqere të pashuar dhe vihet kompresa në vendin e dhimbjes. Kompresa mbahet disa orë.

Mjekësia popullore ka gjetur një përdorim të gjerë në mjaltin e përzier me kanellë. Mjalti është i ëmbël por po të merret në dozën e duhur, nuk përbën problem me të sëmurët diabetikë. Mjalti me kanellë gjen përdorim në sëmundjet e zemrës. Merret buka dhe lyhet me mjaltë me kanellë si në vend të marmalatës dhe hahet rregullisht në mëngjes. Këto ulin kolesterolin në arterie dhe e shpëtojnë pacientin nga kyçet e zemrës. Po kështu, ai që sapo ka kaluar një krizë, në rast se e kryen këtë proces përditë, do ta mbajë larg atakun e radhës. Përdorimi i rregullt i procesit të mësipërm e çliron nga vështirësia në frymëmarrje dhe i forcon rrahjet e zemrës.

## Përdorimi nga pickimi i insekteve

Merret një pjesë mjalti, dy masa uji të vakët, shtojmë një lugë të vogël pluhur kanellë, e përziejmë derisa të bëhët krem. E lyejmë vendin e pickuar ngadalë, duke bërë pak masazh dhe dhimbja pushon menjëherë dhe e enjtura ulet shpejt.

## Përdorimi në artrit

Pacientët që vuajnë nga artriti, marrin dy herë në ditë këtë kurë: në mëngjes dhe në darkë nga një filxhan me ujë të ngrohtë, mjaltë dhe pluhur kanelle. Duke e marrë rregullisht, artriti mund të rregullohet.

## Përdorimi në rënien e flokëve

Ato pacientë që vuajnë nga rënia e flokëve ose që janë tullacë, mund ta aplikojnë këtë pomadë: një lugë gjelle mjaltë, vaj

ulliri të ngrohtë dhe pluhur kanelle. Lyhet koka dhe pomada mbahet 15 – 20 minuta. Pastaj lahen flokët.

### Infeksione të fshikëzës së urinës

Merren 2 lugë gjelle kanellë dhe një lugë çaji mjaltë me një gotë me ujë të vakët. Këtë e pijmë çdo mëngjes esëll. Kjo shkatërron bakteriet në fshikëzën e urinës.

### Përdorimi për dhimbje dhëmbi

Merret një lugë çaji kanellë pluhur, 5 lugë çaji me mjaltë dhe aplikohet në dhëmb. Kjo bëhet 3 herë në ditë dhe dhimbjet pushojnë.

### Përdorimi në problemet me kolesterolin

Marrim dy lugë gjelle mjaltë dhe 3 lugë çaj me kanellë. Hidhen në 450-500 ml ujë ose çaj dhe kjo përdoret 3 herë në ditë. Kjo shëron çdo lloj problemi me kolesterolin.

### Përdorimi për të ftohurit

Marrim një lugë gjelle mjaltë dhe një lugë gjelle kanellë dhe e përdorim 3 herë në ditë. Kjo do të kurojë kollën kronike, të ftohurën dhe çliron sinuset.

### Përdorimi në infertilitet (sterilitet) - paaftësi për të lindur fëmijë të gjallë ose të aftë për jetesë.

Mjekësia e ka përdorur mjaltin që në lashtësi si forcues të farës mashkullore. Në qoftë se meshkujt impotentë (të pafuqishëm, që nuk janë të aftë nga ana seksuale) do të marrin nga 2 lugë gjelle mjaltë porsa të flejnë, problemi i tyre do të zgjidhet. Gratë që nuk mbesin shtatzanë, kanë nevojë për të forcuar uterusin (mitrën) e tyre. Ata duhet të marrin një përzierje me mjaltë dhe një cimbitje kanellë dhe ta mbajnë në mishrat e dhëmbëve gjatë gjithë ditës, në mënyrë që të përzihet me pështymën dhe dalëngadalë të futet në trup.

## Përdorimi për stomak të trazuar

Merret mjalti me kanellën pluhur, trazohen dhe përzierja hahet 3 herë në ditë nga një lugë gjelle. Kjo kuron stomakun dhe ulçerat e stomakut nga rrënja.

## Përdorimi për ndalimin e gazrave

Merret mjalti me pluhur kanelle, trazohet dhe përdoret 2-3 herë në ditë. Stomaku çlirohet nga gazrat.

Përdorimi për sistemin imunitar

Përdorimi i brendshëm i mjaltit me kanellën forcon sistemin imunitar dhe mbron trupin nga bakteriet dhe sulmet bakteriale.

## Përdorimi në influenca (grip)

Mjalti përmban ingredientë natyrorë që asgjësojnë bakteriet e gripit dhe kjo e ruan pacinetin nga gripi.

## Përdorimi për tretjen

Merren 2 lugë gjelle mjaltë që spërkaten me pluhur kanelle, duke e përdorur para ushqimit. Ai heq aciditetin dhe tret ushqimet më të rënda.

## Përdorimi për jetëgjatësinë

Çaji i bërë me mjaltë dhe pluhur kanelle, duke u përdorur rregullisht, ndalon veprimin shkatërrues të moshës së vjetër. Merren katër lugë mjaltë, një lugë kanellë dhe një filxhan ujë. Përzierja duhet thithur si çaj. Ajo pihet 3-4 herë në ditë. Kështu e mban lekurën të freskët dhe të butë dhe ndalon plakjen.

## Përdorimi dermatogjik (puçrra)

Merret një lugë gjelle mjaltë dhe një lugë kanelle dhe përzihet, bëhet si pastë ose si krem. Me të lyhet fytyra në darkë, para gjumit dhe në mëngjes lahet me ujë të ngrohtë. Bëhet çdo ditë për dy javë dhe puçrrat hiqen nga rrënja.

## Përdorimi në infeksione lëkure

Përdorim mjaltin dhe kanellën në pjesë të barabarta mbi pjesë të ndikuara. Ai kuron ekzemën, qeren dhe të gjitha infeksionet e lëkurës.

## Përdorimi në rënie të peshës

Merret çdo mëngjes esëll dhe në mbrëmje para gjumit mjalti me kanellë dhe një filxhan ujë i zier. Kjo ul peshën e një personi obez.

## Përdorimi për kancerin

Pacientët që vuajnë nga kanceri i stomakut dhe i kockave, përdorin çdo ditë një lugë gjelle mjaltë me një lugë gjelle kanelle, 3 herë në ditë për tre muaj.

## Përdorimi për lodhjen

Përmbajtja e sheqerit në mjaltë është më i dobishëm sesa i dëmshëm për forcimin e trupit. Të moshuarit që marrin mjaltë dhe kanellë në pjesë të barabarta, janë më syhapur dhe fleksibël. Doktor Milton, i cili ka bërë kërkimin, thotë se një gjysëm luge gjelle mjalti merret me një gotë ujë dhe spërkatet me kanellë, duke e pirë çdo ditë në mëngjes pas larjes së dhëmbëve dhe mbasdite rreth orës tre. Kur vitaliteti i trupit është i ulët, ai ngre gjallërinë e tij brenda një jave.

## Përdorimi për erën e keqe të gojës

Në mëngjes bëjmë gargara në fyt me një lugë gjelle mjaltë dhe kanellë të përzier me një gotë uji të ngro-htë. Era e gojës qëndron e freskët gjatë gjithë ditës.

## Përdorimi në humbjen e dëgjimit

Merren çdo ditë në mëngjes dhe në darkë pjesë të barabarta mjalti dhe kanelle dhe kjo rikthen dëgjimin.

Është edhe një tjetër mjekim me mjaltë për sëmundjen e kancerit të stomakut:

300 g lule Aloes
Calendra Officinalis
mjaltë i pa vënë në zjarr (Hoje)

Merret 500 g mjaltë, përzihet me lule të Aloes dhe bashkohet me Calendra të shtypur ose të grirë. Këto i ziejmë me ujë të valuar për 10-15 minuta dhe përdoret tre herë nga një lugë gjelle pas buke.

## Për ulçerën e stomakut:

Një kavanoz me mjaltë, një lugë kafeje sode buke dhe një gjysmë kokrre limoni i shtydhur përzihen dhe hahen çdo mëngjes nga një lugë gjelle esëll.
Një formulë tjetër:

Gjysmë kg mjaltë
Gjysmë kg gjalpë
3 kokrra hudhra
Hudhrat shtypen dhe përzihen bashkë. Kjo hahet çdo ditë çdo mëngjes. Për shërimin e kokrrave që dalin në lëkurën e kokës, marrim gjethet e njoma të duhanit, duke i lyer me mjaltë dhe i vendosim mbi kokërr. Kjo mbahet tërë natën.

Për kurimin e kapsllëkut, marrim një filxhan kafeje mjaltë, një lugë kafeje lule shtogu dhe një gotë ujë. Lulet e shtogut zihen në zjarr për disa minuta dhe gjatë zierjes shtohet mjalti. Masa hiqet nga zjarri, ftohet dhe kullohet. Pihet çdo mëngjes nga një filxhan.

## Për ulçerën e stomakut duhen:

1 kg mjaltë
1 kg bajame të shtypur
1 pako kanellë
1 pako piper i zi
Përzihen dhe hahet 3 herë nga një lugë gjelle.

## Për hemorroidet (majasëll) merret:

Grasa të jashtme 15 g
Camfur Tritae 3 g
Mjaltë 1 lugë gjelle
Një e verdhë veze

Përzihen dhe masa vendoset te vendi.

**Për ulçerat dhe kancerin e stomakut përdoret:**
300 g lëng Aloe-vera
20 g gjalpë
300 g mjaltë
2 lugë gjelle kakao
Përzihen dhe merret një lugë gjelle në mëngjes dhe në mbrëmje.

**Hoxha Tahsin**

# SEKRETET E UJIT

Abstrakt

*Në këtë artikull do të njiheni me disa prej sekreteve të ujit. Pse është quajtur element bazë? Cfarë përmban esenca e ujit? Filozofët e vjetër kanë pohuar se edhe përbërjet e plota, siç janë gjallesat dhe bimët, edhe përbërjet e mangëta, siç janë mjegullat dhe të ngjashmet me to, përbëhen prej katër elementëve bazë që janë: zjarri, ajri, uji dhe toka. Pikërisht kjo është quajtur teoria e katër elementeve.*

*Ujin e kanë quajtur element bazë për shkak të monopolit që ai ka në dukshmërinë e gjërave, ndërsa nuk e kanë ditur përbërjen esenciale të tij.*

E ngjashme si pika e Ba'së (shkronjës B) në besmelen (bismilahin),
Pika e ujit është provë e lumit të madh,
Zoti i ka sqaruar cilësitë e ujit,
Çdo gjë të gjallë e krijova prej ujit (mine'l-mai kul'le shej'in hajj)…[1]

Në mëngjes, në të shumtën e rasteve, shohim se gjethet e drurëve dhe kullotat janë të njoma dhe pikojnë

1 Vargjet janë shkruar nga Hoxha Tahsini (M.Halili).

pika uji, edhe pse e dimë që nuk ka rënë shi. Kjo begati e Zotit quhet vesë, e cila qëndron në mëngjes dhe shndrit mbi kullotën. Vesa ka të njëjtën substancë si uji, i cili u mundëson jetën gjallesave. Në thelb, ajo pikë uji është epiqendër e Urtisë dhe e Fuqisë së Zotit. I tërë ky realitet është mjaft i hapur për ata që thellohen në shkencë. Kjo pikë, e cila, në të shumtën e rasteve konsiderohet si asgjë, në momentin kur takohet me dritën diellore, ngrihet në ajër dhe humbet prej syve tanë. Vallë, ku shkon me kaq shpejtësi kjo pikë dhe si, në momentin kur kemi nevojë, na kthehet prapë? Si i viziton kullotat prej të cilave më parë ishte ndarë? Në momentin kur fshihet prej syrit tonë, a ndryshon vetëm forma e saj, apo shkatërrohet e tëra dhe bëhet asgjë? Ndoshta formësimi i kësaj pike uji në trajta të ndryshme është i pamundur të analizohet dhe të sqarohet, ashtu siç e kemi të pamundur të sqarojmë periudhat e ndryshme të transformimeve planetare dhe ekzistuese të gjithësisë. Sikur kjo pikë e lashtë të hapte gojën dhe të fliste për ngjarjet e të kaluarës dhe transformimet e lindura gjatë historisë, të gjithë dëgjuesit do të mahniteshin. Thënë ndryshe, kjo pikë e ujit ka marrë pjesë në të gjitha transformimet kohore; prej ditës së parë të krijimit të ekzistencës dhe është dëshmitare e të gjitha tufaneve dhe tërmeteve që ka përjetuar rruzulli tokësor. Ajo është bashkëkohëse e të gjitha llojeve të bimëve dhe shtazëve që janë zhdukur me këto tufane dhe tërmete dhe mbeturinat e të cilave sot gjenden në shtresat e ndryshme të tokës. Ajo ka vrojtuar lindjen dhe zhvillimin e shumë popujve, dhe, duke kaluar në lukthin e shumë të eturve, ka shëruar

etjen e tyre. Nga sot e deri në ditën e shkatërrimit të gjithësisë, kjo pikë do të vazhdojë të ndjekë vallëzimet dhe lëvizjet brenda kornizave të gjithësisë, derisa toka të ndërpresë lëvizjen dhe të përfundojë ciklin e saj.

Sikur të kishim aftësi të shihnim se çfarë ndodh me grimcat e vogla të avullit të tejdukshëm, të cilat kaplojnë gjethin e kullosës netëve të verës, çfarë do të vërenim vallë? Do të shihnim se gjatë natës nxehtësia e avullit shpërndahet dhe dalëngadalë ftohet, dendësohet e zvogëlohet. Atëherë, kur avulli i njomë, i cili rrethon gjethin, shkallë-shkallë zvogëlohet dhe merr formë 1700 herë më të vogël se normalja, përnjëherë trajtësohet në pika të vogla si margaritarë. Secila prej këtyre pikave shndërrohet në epiqendër që e kreh nga vetja njomësinë. Si pasojë, formohen pika të mëdha dhe të dukshme të ujit. Ja pra, pikat e vesës[2] që në mëngjes duken si gurë të çmueshëm mbi gjethet e bimëve dhe të luleve, janë formësuar në këtë mënyrë. Që gjethet e lakrës dhe të disa perimeve të ngjashme të mos kalben, Fuqia Krijuese ka vendosur një mbulesë të

2 Për herë të parë, shkencëtari i spikatur skocez, doktor Vil, ka vërejtur se vesa nuk është në të njëjtën lartësi me trupat dhe ka kuptuar gabimin e mendimeve të shfaqura më parë. Ai ka konstatuar se vesa, më së tepërmi, përqendrohet në trupat që nuk e pranojnë dhe e kthejnë të ftohtit. Vesa nuk përqendrohet mbi trupat si mineralet, të cilat janë përçuese të nxehtësisë dhe ftohtësisë; ndërsa vendoset mbi dheun, rërën, qelqin dhe mbi të gjitha llojet e bimëve. Nëse në një natë të ftohtë lëmë jashtë një copë qelqi dhe një copë llamarine, do të kemi mundësi ta vërejmë këtë realitet. Mjegullat që e bartin dhe e përhapin nxehtësinë në tokë nuk shihen në qiell. Gjithashtu, vesa nuk shihet në netët me erë që i lëvizin shtresat e ajrit. Në netët me erë të lehtë ka mundësi të duket. Gjithashtu, edhe në mbrëmje, në netët pa mjegull bie një shi shumë i hollë, që dallohet nga vesa për shkak se ky shi bie si rezultat i ftohjes dhe i tkurrjes së avullit në shtresat e ajrit. Vesa formohet në sipërfaqen e trupave. Bryma formohet prej ngrirjes së vesës mbi sipërfaqen e trupave.

yndyrshme dhe të lustruar. Pikërsiht për këtë arsye pikat e ujit nuk depërtojnë dot dhe për pasojë as nuk e kalbin atë. Pikëlat e ujit koncentrohen në trajtën e kokrrave në sipërfaqen e gjethes dhe lëvizin nga lart-poshtë. Në fillim të ditës, kur lind dielli, ai me rrezet e tij i fshin këto pika. Në netët e kthjellëta të verës, në degë dhe organet e freskëta të bimëve si kundërvlerë e nxehtësisë, që e kanë humbur me shpërndarjen në ajër, u kthehet avulli, i cili është shndërruar në vesë. Sikur të mos ishte kjo, shumica e kullotave do të ishin tharë dhe shkatërruar prej brymës para se të perëndonte dielli. Përkundrazi, kur qielli është me mjegull, ajo e pengon depërtimin e nxehtësisë e si pasojë nuk bëhet avullimi i ujrërave dhe formësimi i vesës. Kjo gjë është e njohur për të gjithë bujqit dhe vreshtarët. Zoti, Kimisti i përsosur, me ndriçimin dhe nxehjen e rrezeve diellore i avullon ujërat dhe njomësinë. Si pasojë, uji përfiton mundësinë e përpunimit në distilatorin e çmueshëm të natyrës, që do të thotë pastrohet dhe filtrohet prej materieve të dëmshme, të cilat nuk janë të dobishme për gjallesat. Uji i pastër, në këtë mënyrë transformohet dhe duke marrë formën e tejdukshme të ajrit, kthehet në trajtë avulli, i cili me cilësitë e tij të zhveshura (pa ngjyrë) depërton në hapësirën e dimrit të rëndë dhe sfondit të ftohtë e të ashpër. Në këtë platformë, nën ndikimin e të ftohtit përsëri tkurret dhe dendësohet dhe në trajtën e mjegullës nën peshën e barrës së saj lëshohet poshtë në formë shiu ose në të ftohtin e ashpër, në formën e borës ose të breshërit. Bora, në ditët e dimrit, në malet e larta paraqitet me krenari e përqëndrohet në vendin ku bie dhe bëhet

zotëruese e natyrës së atij vendi; ndërsa në stinën e verës, nën ndikimin e telegrafit të rrezeve diellore, anon drejt shkrirjes dhe përsëri kthehet në trajtën e ujit. Si rrjedhojë, duke vrapuar prej vargut të maleve të larta nëpër zinxhirin e rrafshnaltave, bëhet faktor jetësor për shumë të etur.

## *ESENCA E UJIT*

Filozofët e vjetër kanë pohuar se edhe përbërjet e plota, siç janë gjallesat dhe bimët, edhe përbërjet e mangëta, siç janë mjegullat dhe të ngjashmet me to, përbëhen prej katër elementëve bazë që janë: zjarri, ajri, uji dhe toka. Pikërisht kjo është quajtur teoria e katër elementeve. Ujin e kanë quajtur element bazë për shkak të monopolit që ai ka në dukshmërinë e gjërave, ndërsa nuk e kanë ditur përbërjen esenciale të tij. Pikërisht për këtë, ky supozim ka vazhduar afro dy mijë vjet në këtë trajtë. Filozofi grek Aristoteli tokën e ka menduar si fuqi natyrore. Edhe sot e kësaj dite, shkencëtarët e mëvonshëm, trupat që nuk kanë arritur t'i zbërthejnë, i kanë quajtur "trupa të thjeshtë". Substancat me cilësi të tillë, në bazë të librave të kimisë, deri më sot, kanë arritur numrin 67. Uji[3], si një prej elementëve të njohur të filozofëve të vjetër, është i përbërë prej dy gazeve: prej oksigjenit dhe hidrogjenit.

3 Uji ka edhe një karakteristikë tjetër interesante. Sipërfaqja e detit, për shkak të gjerësisë së saj në stinën e verës, e pranon shumë nxehtësinë e deponuar dhe e shpërndan më ngadalë. Pikërisht për këtë, ne nuk ndikohemi as prej nxehtësisë së verës e as prej ftohtësisë së dimrit.

Ajri është përzierje e oksigjenit dhe azotit, ndërsa toka, për shkak të ekzistencës së një numri të madh të llojeve të tokës, nuk është përcaktuar plotësisht, kurse zjarri nuk është një substancë në vete si elementët e tjerë, por është cilësi e veçantë që paraqitet në trupa. Për këtë janë dakort të gjithë filozofët. Trupat në natyrë nuk janë të përbëra vetëm prej një elementi, por ata janë të përbëra prej tubimit të disa grimcave individuale, të cilat nuk kemi mundësi t'i shohim me shqisat tona. Këto elementë, me ndikimin e fuqive natyrore, afrohen ose largohen prej njëri-tjetrit dhe trajtësohen me cilësi të ndryshme. Ashtu edhe uji, në bazë të klimës dhe stinëve, në bazë të nxehtësisë dhe ftohtësisë si dy ndikues të prodhimtarisë, i ndryshon cilësitë e veta dhe paraqitet në njërën prej tre trajtave: në trajtë të ngurtë, të gaztë ose të lëngët. Këto tre trajta paraqiten nën ndikimin e shtypjes dhe bymimit të forcës së gravitetit dhe mënjanimit e shpërndarjes së energjisë së nxehtësisë. Nëse i pari prej ndikuesve që është graviteti del ngadhënjyes, atëherë uji ngurtësohet; nëse fiton nxehtësia, atëherë uji merr trajtën e ajrit dhe të avullit; nëse të dy ndikimet janë ekuivalente, atëherë uji merr trajtën e lëngët. Dijetari i njohur anglez Kuandixh ka pohuar se në përbërjen e ujit ka një gjendje të gaztë, por këtë nuk ka arritur ta eksperimentojë dhe deri në vitin 1781, ka vepruar në bazë të teorisë së vjetër. Ky mendim ka mbetur vetëm si hipotezë. Përbërjen sasiore dhe cilësore të ujit, për herë të parë, e ka paraqitur kimisti francez Lavoisier. Ky nder dhe kjo krenari i takon këtij shkencëtari. Në bazë të asaj që u tha, inxhinieri Laplace dhe shkencëtari Munje e kanë

eksperimentuar këtë. Prej një sasie të caktuar kanë përfituar 160 gramë ujë. Më pas kanë përpunuar 20 gramë ujë të pastër dhe e kanë vendosur në fundin e një shisheje. Kjo shishe edhe sot e kësaj dite është në Muzeun Natyror. Në vitin 1800, kimistët e njohur Nisholoni dhe Karlisli e kanë analizuar ujin me mjetin e njohur "Voltmetër". Nxehtësia që nevojitet për analizën e ujit, sipas Dr.Vilit, është ndërmjet 1100 dhe 1700 gradë Celsius. Prej një pjesë hidrogjen dhe tetë pjesë oksigjen përftohen nëntë pjesë avull uji

# FJALOR KUR'ANOR: **IBLISI**

Djalli i mallkuar është armiku i përbetuar i njeriut deri në ditën e fundit të kësaj jete. Allahu i Madhëruar thotë në Kur'an: **"Me të vërtetë, djalli është armik për ju, andaj vështrojeni si armik! Ai vetëm i josh ithtarët e vet, që të bëhen shokë të zjarrit të përflakur."** (Sure "Fatir", ajeti 6).
Dhe: "**O ju që keni besuar! Hyni të gjithë në paqë dhe mos shkoni gjurmëve të djallit, se ai është armiku juaj i përbetuar"** (Sure "Bekare", ajeti 208)
Dhe: **"...Hani nga ato që ua ka dhuruar Allahu dhe mos ndiqni gjurmët e djallit. Ai është për ju armik i hapur."** (Sure "En'am", ajeti 142)
Në Kur'anin e shenjtë, djalli njihet me emrin *shejtan* dhe *iblis*.
Iblisi është i madhi i shejtanëve sipas fesë islame. Ai ka qenë prej xhindeve adhurues të Allahut. Thuhet se origjina e fjalës "*iblis*" është arabe dhe vjen nga folja "*belese*" që do të thotë "*turide*" (i dëbuar). Kështu, kuptimi i fjlaës "*iblis*" është "*i dëbuari nga mëshira e Allahut*". Disa komentues thonë se kuptimi i foljes "*belese*" është "*jeise*". Që këtej, kuptimi i fjalës "*iblis*" është "*ai që humbet shpresën nga mëshira e Allahut*". Disa orientalistë kanë mendimin se origjina e fjalës "*iblis*" është nga gjuha greke "*Diabolos*". Iblisi është krijuar nga zjarri, njësoj si xhindet, siç thotë Kur'ani i shenjtë: **"... Mua më ke krijuar prej zjarrit, kurse atë prej balte."** (Sure "Sad", ajeti 76)
Disa dijetarë thonë se fjala "*shejtan*" përmendet 64 herë në Kur'anin e shenjtë, kurse fjala "*iblis*" përmendet 11 herë në Kur'anin e shenjtë. Pra, fjala "*djall*" përmendet 75 herë.
Fjala "*shejtan*" vjen nga fjala "*esh shetan*", e cila ka disa

kuptime gjuhësore: Ka kuptimin e litarit, e të së shtrembërës, të së largëtit dhe të kundërshtimit. Ata njerëz, të cilët ndjekin rrugën e shejtanit, quhen "*shejatin*" (djajtë), që është shumësi i fjalës shejtan (djall). Në Kur'an thuhet: **"...Ne i kemi bërë djajtë** (shejtanët) **roja të atyre që nuk besojnë."** (Sure "A'raf", ajeti 27)

Iblisi ishte adhurues, mirëpo kur Allahu e urdhëroi për t'i bërë sexhde Ademit, iblisi e kundërshtoi urdhrin e Tij. Në Kur'an lexojmë: "**Kur u thamë melekëve: 'Përuluni në sexhde para Ademit!', ata të gjithë iu përulën në sexhde, përveç Iblisit!..."** (Sure "Isra", ajeti 61)

Dhe: "**Kur u thamë melekëve: 'Përuluni në sexhde para Ademit!', ata u përulën, përveç Iblisit, i cili nuk deshi, u tregua mendjemadh dhe u bë jobesimtar."** (Sure "Bekare", ajeti 34)

Dhe: **"Kur u thamë melekëve: 'Përuluni në sexhde para Ademit!', ata u përulën, përveç Iblisit. Ai ishte një nga xhindet dhe nuk iu bind urdhrit të Zotit të vet..."** (Sure "Kehf", ajeti 50)

Dhe: **"Kur u thamë melekëve: 'Përuluni në sexhde para Ademit!', të gjithë u përulën, përveç Iblisit, i cili nuk pranoi."** (Sure "Ta Ha", ajeti 116)

**"Ne ju krijuam e pastaj ju dhamë formën; e u thamë melekëve: 'Përuljuni në sexhde Ademit!' – Të gjithë iu** përulën, përveç Iblisit. **Ai nuk ishte nga ata që u përulën."** (Sure "A'raf", ajeti 11)

Shkaku i kundërshtimit të tij ishte se ai pretendonte që ishte më i mirë nga njeriu: **"Iblisi tha: 'Unë jam më i mirë se ai.'"** (Sure "Sad", ajeti 76)

Ai ka qenë shkaku i nxjerrjes së Ademit dhe Havasë nga Xheneti, pasi i mashtroi ata që të hanë prej pemës së ndaluar. Në Kur'an lexojmë: **"Djalli u pëshpëriti, për t'ua zbuluar pjesët e turpshme të mbuluara të trupit të tyre dhe u tha: 'Zoti juaj jua ka ndaluar pemën, vetëm që të mos bëheni melekë ose të pavdekshëm.'"** (Sure "A'raf", ajeti 20)

Kur Allahu e dëboi shejtanin nga mëshira e Tij, ai i kërkoi

Zotit që t'i jepte afat deri në Ditën e Kiametit: "**Ai tha: 'O Zoti im, më jep afat deri në Ditën kur do të ringjallen ata!'"** (Sure "Sad", ajeti 79)
Ai është betuar se do t'i mashtrojë bijtë e Ademit, përveç të sinqertëve dhe të përkushtuarve ndaj Allahut. Kur'ani thotë: **"Ai tha: 'Betohem në madhërinë Tënde se unë do t'i mashtroj ata të gjithë, përveç robve të Tu të sinqertë!'"** (Sure "Sad", ajeti 82)
Dhe: **"Iblisi tha: 'Zoti im, për shkak se më çove në humbje, unë do t'ju zbukuroj atyre** (njerëzve) **rrugën e gabuar në Tokë dhe të gjithë do t'i shpie në mashtrim", përveç robërve të Tu të sinqertë.'"** (Sure "Hixhr", ajetet 39 - 40)
Ai është i mallkuar deri në Ditën e Kiametit, siç thuhet në Kur'an: "**Allahu tha: 'Atëherë, dil prej Xhenetit! Ti je vërtet i mallkuar! Le të jetë mallkimi mbi ty deri në Ditën e Kiametit.'"** (Sure "Hixhr", ajetet 35-36)
Ai nxit urrejtje mes njerëzve dhe i shtyn ata që të gabojnë, siç thotë Allahu në Kur'an: **"Shejtani i shtyu të gabojnë e i nxori nga lumturia ku ishin. 'Zbritni - u thamë Ne - do të jeni armiq të njëri-tjetrit…'"** (Sure "Bekare", ajeti 36)
Dhe: **"Ata prej jush që kthyen shpinën ditën kur u ndeshën dy ushtritë, në të vërtetë, djalli i shtyu në gabim, për shkak të disa gjynaheve që kishin bërë…"** (Sure "Ali Imran", ajeti 155)
Ndjekësit e rrugës së tij janë të humbur dhe prej banorëve të Zjarrit, siç thotë Allahu në Kur'an: **"Me të vërtetë, hamendja e Iblisit për ata u vërtetua; ata shkuan pas tij, përveç një grupi besimtarësh të vërtetë."** (Sure "Sebe", ajeti 20)
Dhe: **"Kështu, ata do të hidhen në zjarr bashkë me mohuesit, si dhe të gjithë ushtarët e Iblisit."** (Sure "Shuara", ajetet 94-95)
Dhe: **"Disa Ai i ka udhëzuar në rrugë të drejtë, kurse disa të tjerë e kanë merituar humbjen. Ata kanë zgjedhur djajtë për mbrojtës në vend të Allahut dhe mendojnë se janë në rrugë të drejtë."** (Sure "A'raf", ajeti 30)
Ai urdhëron për veprime të këqija. Në Kur'an lexojmë:

**"O njerëz! Ushqehuni me të gjitha ato gjëra të lejuara e të mira që gjenden në Tokë dhe mos ndiqni gjurmët e djallit, sepse ai është njëmend armiku juaj i hapur. Ai ju nxit vetëm në të këqija, në vepra të turpshme dhe të flisni për Allahun gjëra që nuk i dini."** (Sure "Bekare", ajetet 168 - 169)

Dhe: **"O ju që keni besuar! Mos ndiqni gjurmët e djallit! Kush ndjek gjurmët e djallit, do të nxitet nga ai të bëjë vepra të këqija e të shëmtuara."** (Sure "Nur", ajeti 21)

## Fjala "shejtan" përmendet në këto sure:

Sure "Bekare", ajetet 36, 168, 208, 268, 275.; Sure "Ali Imran", ajetet 36, 155, 175.; Sure "Nisa", ajetet 38, 60, 76, 83, 119, 120; Sure "Maide", ajetet 90 dhe 91.; Sure "En'am", ajetet 43, 68, 142.; Sure "A'raf", ajetet 20, 22, 27, 175, 200 dhe 201.; Sure "Enfal", ajetet 11 dhe 48.; Sure "Jusuf", ajetet 5, 42 dhe 100.; Sure "Ibrahim", ajeti 22.; Sure "Nahl", ajetet 63 dhe 98.; Sure "Isra", ajetet 27, 53 dhe 64.; Sure "Merjem", ajeti 44.; Sure "Ta Ha", ajeti 120.; Sure "Haxh", ajeti 52 dhe 53.; Sure "Nur", ajeti 21.; Sure "Furkan", ajeti 29.; Sure "Neml", ajeti 24. Sure "Kasas", ajeti 15.; Sure "Fatir", ajeti 6.; Sure "Jasin", ajeti 60.; Sure "Fusilet", ajeti 36.; Sure "Sad", ajeti 41. Sure "Zuhruf", ajeti 62.; Sure "Muhamed", ajeti 25.; Sure "Muxhadele", ajetet 10 dhe 19.; Sure "Hashr", ajeti 16.

(Shënim: Në tetë prej këtyre ajeteve, fjala "*shejtan*" përmendet dy herë.)

## Fjala "iblis" përmendet në këto sure:

Sure "Bekare", ajeti 34.; Sure "A'raf", ajeti 11.; Sure "Hixhr", ajetet 31 dhe 32.; Sure "Isra", ajeti 61.; Sure "Kehf", ajeti 50.; Sure "Ta Ha", ajeti 116.; Sure "Shuara", ajeti 95.; Sure "Sebe", ajeti 20.; Sure "Sad", ajetet 74 dhe 75.

**Vullnet Merja**

**Liseda Ramaj**

# BIBLIOGRAFI E REVISTËS "DRITA E KUR'ANIT", 2013

**2013/1**

1. **Abdul-Daim Al-Kahil:** *Gënjeshtra e madhe e astrologjisë,* "Drita e Kur'anit", nr. 1/2013, f. 54-59.
2. *Argumente shkencore nga Kur'ani:* "Drita e Kur'anit", nr. 1/2013, f. 43-50.
3. *Bibliografi*: *"Drita e Kur'anit", 2007-2012,* "Drita e Kur'anit", nr. 1/2013, f. 94-110.
4. Bismil-Lahir-Rahmanir-Rahim, "Drita e Kur'anit", nr. 1/2013, f. 91-94.
5. **Hajri Shehu:** *Kur'ani për gjuhën,* "Drita e Kur'anit", nr. 1/2013, f. 59-63.
6. **Hilmi Selaloglu:** *Industria e organizuar e qelizës,* "Drita e Kur'anit", nr. 1/2013, f. 50-54.
7. *Koncepti i adhurimit në fenë islame*: "Drita e Kur'anit", nr. 1/2013, f. 23-30.
8. **Marhum Ahmed Sheriff Deuji:** *Agjërimi-zekati i trupit,* "Drita e Kur'anit", nr. 1/2013, f. 30-36.
9. **Muhamed Ali Dukhail:** *Profeti Daud,* "Drita e Kur'anit", nr. 1/2013, f. 78-91.
10. **Muxhtaba Musavi Lari:** *Pranimi i ekzistencës së padukshme,* "Drita e Kur'anit", nr. 1/2013, f. 36-43.

11. **Sejjid Ebul A'la Maududi:** *Histori e shkurtër e profetësisë*, "Drita e Kur'anit", nr. 1/2013, f. 70-78.
12. **Vullnet Merja:** *Imazhi i Profetit në Kur'an*, "Drita e Kur'anit", nr. 1/2013, f. 9-23.
13. **Xhemal Balla:** *Njeriu, qenie sociale*, "Drita e Kur'anit", nr. 1/2013, f. 63-70.

**2013/2**

1. **Abduldaem Al-Kahiil:** *Argumente shkencore nga Kur'ani*, "Drita e Kur'anit", nr. 2/2013, f. 61-84.
2. **Abduldaem Al-Kahiil:** *Njeriu dhe përgjegjësia në Kur'an*, "Drita e Kur'anit", nr. 2/2013, f. 84-91.
3. **Ajetullah Xha'far Sukhani:** *Shqyrtimi i kontekstit të ajeteve të Kur'anit,* "Drita e Kur'anit", nr. 2/2013, f. 109-116.
4. **Ali Kaja:** *Zgjerimi i universit dhe shpërthimi i madh*, "Drita e Kur'anit", nr. 2/2013, f. 36-44.
5. **Hafiz Ali Korça:** *Tefsiri i sures "Fatiha"*, "Drita e Kur'anit", nr. 2/2013, f. 125-132.
6. *Hytbja e Lamtumirës*: "Drita e Kur'anit", nr. 2/2013, f. 9-19.
7. *Karakteri i Profetit*, "Drita e Kur'anit", nr. 2/2013, f. 30-36.
8. **Muhamed Ali Dukhail:** *Profeti Sulejman*, "Drita e Kur'anit", nr. 2/2013, f. 99-109.
9. **Muhsin Keraeti:** *Mësime kur'anore nga surja "Bekare"*, "Drita e Kur'anit", nr. 2/2013, f. 116-125.

10. **Musavij Lari:** *Besimi në pavdekshmërinë*, "Drita e Kur'anit", nr. 2/2013, f. 52-61.
11. *Pozita e prindërve në Kur'an:* "Drita e Kur'anit", nr. 2/2013, f. 91-99.
12. **Sejjid Ebul A'la Maududi:** *Besimi në Librat e Allahut*, "Drita e Kur'anit", nr. 2/2013, f. 24-30.
13. **Vullnet Merja:** *Feja e vërtetë tek Allahu është vetëm Islami*, "Drita e Kur'anit", nr. 2/2013, f. 19-24.
14. **Xhemal Abdel Naser:** *Ylli që shpon errësirën dhe vrimat e zeza*, "Drita e Kur'anit", nr. 2/2013, f. 44-52.

**2013/3**

1. **Abduldaem Al-Kahiil:** *Argumente shkencore nga Kur'ani III*, "Drita e Kur'anit", nr. 3/2013, f. 40-57.
2. **Abdul Azis Al-Fauzan:** *Mëkati i madh i homoseksualizmit*, "Drita e Kur'anit", nr. 3/2013, f. 76-83.
3. **Hafiz Ali Korça:** *Tefsiri i sures s'Idolatrevet*, "Drita e Kur'anit", nr. 3/2013, f. 103-107.
4. **Harun Jahja:** *Dëshmia e ekzistencës së Allahut mund të shihet përmes ndërgjegjes*, "Drita e Kur'anit", nr. 3/2013, f. 21-30.
5. **Mamarinta Mubabaja:** *Epidemia e Sida-s – një holokaust*, "Drita e Kur'anit", nr. 3/2013, f. 66-72.
6. **Muhamed Ali Dukhail:** *Profeti Idris*, "Drita e Kur'anit", nr. 3/2013, f. 83-91.

7. **Muhsin Keraeti:** *Mësime kur'anore nga surja "Bekare"*, "Drita e Kur'anit", nr. 3/2013, f. 91-101.
8. **Muxhtaba Musavi Lari:** *Islami* është *kundër racizmit*, "Drita e Kur'anit", nr. 3/2013, f. 30-34.
9. **Qani Banaj:** *Për* çdo *sëmundje ka një ilaç*, "Drita e Kur'anit", nr. 3/2013, f. 57-66.
10. **Sejjid Abul A'la Maududi:** *Teuhidi: Besimi në një Zot,* "Drita e Kur'anit", nr. 3/2013, f. 9-21.
11. **Sumejeh Bint Joan:** *Durimi – fronti i parë i mbrojtjes së myslimanit përballë vështirësisë,* "Drita e Kur'anit", nr. 3/2013, f. 72-76.
12. **Sheuki Ebu Halil – Hani El Mubarek:** *Roli i qytetërimit arabo-islam në Rilindjen Europiane,* "Drita e Kur'anit", nr. 3/2013, f. 34-40.
13. **Vullnet Merja:** ***L**a Ilahe Il'lallah,* "Drita e Kur'anit", nr. 3/2013, f. 101-103.

**2013/4**

**1.Syed Ali Ibnulhussain Baqri**: *Kur'ani depërton në të gjitha udhët e jetës,* "Drita e Kur'anit", nr. 4/2013, f. **9-14.**

**2. Sejjid Ebul a'la Maududi***: Fundi i profetësisë,* "Drita e Kur'anit", nr. 4/2013, f. 14-20.

**3. R. L. Gulick***: Qëndrimi i Muhamedit ndaj diturisë,* "Drita e Kur'anit", nr. 4/2013, f. **20-28.**

**4. Abduldaem al – Kahiil***: Argumente shkencore nga Kur'ani IV,* "Drita e Kur'anit", nr. 4/2013, f. **28-46.**

**5. Qani Banaj***: Për* çdo *sëmundje ka një ilaç II,* "Drita e Kur'anit", nr. 4/2013, f.**46-58.**
**6. Muxhtaba Musavi Lari***: Dëmet e mosmirënjohjes,* "Drita e Kur'anit", nr. 4/2013, f.**58-66.**
**7. Umm Idris Abduallah***: Gruaja e përkushtuar,* "Drita e Kur'anit", nr. 4/2013, f.**66-79.**
**8. Harun Jahja***: Islami shkon krah për krah me artin dhe bukurinë***,** "Drita e Kur'anit", nr. 4/2013, f.**79-86.**
**9. Ali Muhamed Ali Duhajjil – Dehili***: Profeti Junus (paqja qoftë mbi të!)***,** "Drita e Kur'anit", nr. 4/2013, f.**86-94.**
**10. Muhsin Keraeti***: Mësime nga surja "Bekare",* "Drita e Kur'anit", nr. 4/2013, f.**94-106.**
**11. Vullnet Merja***: Melekët,* "Drita e Kur'anit", nr. 4/2013, f.**106-113.**
**Salih Ferhati***: Lukmani (lukman),* "Drita e Kur'anit", nr. 4/2013, f.**113-116.**

# BOTIME

**Fondacioni i Kur'anit**, Muhsin Keraeti, "Mësime nga ajetet e Kur'anit", vëll. 2, Tiranë, 2013. E përktheu nga persishtja Agim Abdullahu. Në libër jepen mësime që nxirren nëpërmjet ajeteve të Kur'anit të sures Ali Imran, të tilla si; pastërtia është vlera më e madhe e femrës; devotshmëria nuk është izolim nga shoqëria, por largim nga mëkatët, urdhërimi për të bërë vepra të mira; kryerja e detyrës është me rëndësi; martirizimi nuk është fundi i jetës etj. Zoti i Madhëruar thotë në Kur'an: "Ai (Kur'ani) është dritë dhe udhërrëfyes për njerëzit."




***

**Shoqata Flladi**, "Lartësimi i shpirtit" (ribotim), Tiranë, 2014. E përktheu nga arabishtja Selim Stafa. Libri përcjell lutje prej burimit më të pastër, prej familjes së uruar të Profetit Muhamed (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!). Janë lutje, vetëm me Emrat e bukur të Allahut e me cAtributet e Tij të larta; prandaj ata qëndrojnë sigurisht më lart se fjalët e të gjithë oratorëve e të letrarëve të marrë së bashku.




***

**Shoqata Flladi,** Xhafer Subhani, "Në tryezën e Kur'anit dhe të Synnetit", Tiranë, 2014. E përktheu nga arabishtja Vullnet Merja. Libri u bën ftesë myslimanëve që t'i kthenen Kur'anit dhe Synetit të Profetit Muhamed (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!). Allahu i Madhëruar thotë: "Bindjuni Allahut dhe të Dërguarit të Tij dhe mos u grindni ndërmjet jush, sepse do të humbni guximin e do t'ju lërë fuqia! Bëhuni të durimtarë, se Allahu, me të vërtetë, është me durimtarët."




***

**Shoqata Flladi,** Imam Khomeini, "Mposhtja e egos", Tiranë, 2014. E përktheu nga persishtja Redis Sheko. Libri i kujton njeriut se ai është krijesa më e mahnitshme e Zotit. Ai ka një natyrë të lindur (fitret) dhe personalitet shpirtëror. Ky është privilegji që e dallon nga krijesat e tjera të gjalla. Mirëpo, në përpjekjet e njeriut për të përmbushur prirjet dhe synimet e veta dhe për të shfrytëzuar natyrën, lihet në harresë personaliteti njerëzor, edukimi dhe pastrimi shpirtëror i njeriut. Njeriu nuk duhet ta harrojë që Krijuesi i Gjithësisë e quajti atë "Më i nderuari i të gjitha krijesave."




***




**Shoqata Flladi,** "Namazi", Tiranë, 2014, përktheu nga gjuha perse Sabrie Feza. Libri "Namazi" (mësimi i faljes së namazit) sqaron me detaje mënyrën e kryerjes së faljes. Zoti i Madhëruar thotë në Kur'an në suren "Nisa", ajeti 103: "Sigurisht, namazi është detyrë për besimtarët në kohë të caktuar."

***

## Kur'an i veçantë për të verbrit në Iran





Botimi gjendet në Fondacionin e të verbërve në Esfahan. Ky Kur'an është përzgjedhur si më i miri për të verbërit në tubimin shkencor, me temë "Studimi i metodave të shkrimit të Kur'anit për të verbrit", i mbajtur në Turqi.

Vjollca Karaj (Feza)

# VEPRIMTARI KUR'ANORE

## Organizohet në Indonezi kongresi "Kur'ani - boshti i unitetit"

Në Xhakarta, kryeqyteti i Indonezisë, është mbajtur kongresi me temë: "Kur'ani - boshti i unitetit.". Në kongres u fol për domosdoshmërinë e kthimit në Kur'an dhe për marrjen e tij si pikë referimi për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve të ndryshme.

***

## Organizohet në Vjenë panairi shkencor për mrekullitë shkencore në Kur'an dhe në Synet

Në Vjenë është hapur panairi për mrekullitë shkencore në Kur'an dhe në Synet. Në panair u paraqitën shumë postera që nxirrnin në pah mrekullitë shkencore të Kur›anit dhe të Synetit në kimi, fizikë dhe matematikë. U paraqitën disa ajete nga suret "Mu'minun", "Nahl", "Gashije", "Tijn" dhe "Dukhan", të cilat flasin për argumente shkencore në Kur'an.

***

## Organizata "Mrekullitë shkencore në Kur'an" kërkon të vihet në programet mësimore lënda "Mrekullia shkencore e Kur'anit"

Sekretari i përgjithshëm i organizatës **"Mrekullitë shkencore në Kur'an"**, dr. Abdullah ibn Abdul Aziz El

Muslih, u ka kërkuar ministrive të arsimit dhe të edukimit në vendet islame që të vërtetat shkencore që përmenden në Kur'an të jenë pjesë përbërëse e programeve mësimore në të gjitha nivelet e studimit. "Kjo, - ka thënë ai ndër të tjera, - është e domosdoshme sepse ndihmon në forcimin e programeve mësimore. Kjo do të ndihmojë, gjithashtu në forcimin e lidhjeve mes myslimanëve dhe fesë së tyre islame si dhe në njohjen e jomyslimanëve me të vërtetën e besimit dhe të mesazhit të Islamit. Cilido që mohon mrekullinë shkencore në Kur'an dhe Synet, është mohues i së Vërtetës ndriçuese."

***

## Muzeu i Universitetit Miçigan do të organizojë një ekspozitë të arteve islame

Muzeu i Universitetit Miçigan do të organizojë një ekspozitë të arteve islame. Në ekspozitë do të paraqitet estetika e arteve islame përgjatë shekujve VIII-XIX. Ajo do të quhet "Thesari i së kaluarës: Arti islam". Sipas fjalëve të organizatorëve, kjo ekspozitë konsiderohet një cikël arsimor fillestar në fushën e artit islam.

***

## Qëllimi kryesor i Universitetit Ndërkombëtar "Al Mustafa" është përgatitja e thirrësve kur'anorë

Sipas Agjensisë së Lajmeve Ndërkombëtare Kur'anore (IKNA), përgjegjësi i departamenti të Kur'anit dhe Hadithit në Universitetin Al Mustafa, Iran, Husein Esedij ka thënë në një intervistë në një emision televiziv në Iran, të cilin e ka transmetuar edhe radioja "Ufuk" se qëllimi kryesor i Universitetit "Al Mustafa" është përgatitja e thirrësve kur'anorë dhe intelektualë me grada shkencore në

shkencat e Kur'anit. Universiteti po punon për përgatitjen e kuadrove të kualifikuar në fusha të ndryshme të shkencave të Kur'anit dhe të Hadithit." Ai ka në gjirin e tij studentë nga 108 vende të botës. Universiteti ka shumë degë, ndër to, katër degë kur'anore. Themelimi i Universitetit "Al Mustafa" është prej mirësive të Revolucionit Islamik, i cili i solli këtij vendi shumë e shumë begati. Pa dyshim, ky Universitet është prej arritjeve të Imam Khomeinit (Allahu qoftë i kënaqur me të!) dhe e dëshmorëve të këtij Revolucioni.

***

## Hafizi më i vogël në botën islame

**D**jali algjerian, Abdurrahman Farih, ka bërë për vete miliona myslimanë në botën arabe dhe në atë islame. Ai është 3 vjeç. Është hafiz i të gjithë Kur'anit.

Kanali televiziv MBC, i cili ka bërë një reportazh në familjen e fëmijës, e përshkruan Abdurahmanin si një fenomen. Abdurrahmani ka një aftësi të paparë në këndimin e sureve të Kur'anit. Ai nuk bën asnjë gabim në rregullat e këndimit.

Ajo që ka habitur personelin e televizionit ishte se Abdurahmani nuk pati folur dy vjet. Kur i erdhi goja, ai shqiptoi suren "Kehf", siç ia shqiptuan në familje. Abdurrahmani e fillon këndimin me shqiptimin "Eudhu bilahi mine shejtani rraxhijm".

Sipas babait të Abdurrahmanit, fëmija është ndikuar shumë nga dëgjimi i Kur'anit.

Më e habitshmja është se Abdurrahmani nuk ka shkuar në asnjë shkollë a xhami për të mësuar hifzin e Kur'anit. Në Algjeri e kanë kurorëzuar me epitetin "Kalorësi i Kur'anit". Kënduesi i Kur'anit në xhaminë "El Ekas", shejkh Muhamed Reshad Sherif, i ka veshur atij xhyben e artë.

# SUMMARIES

## The Concept of Love for God

The concept of love for God and the benefits that this concept brings forth to human society is common to all religions in the Abrahamic tradition. Moreover, it is a common in the spiritual traditions of humankind about the philosophical bases related to the concept of love for God. '*Love*' in the definitions under Islamic thought and practice presents a clearance (*improvement*) of the concept in keeping with the implementation of God's message to the mankind. Here, '*love*' is not considered as an abstract concept confined in the relationship between the Creator and Creation. On the contrary, it bears the weight of a complete understanding of *Ad-Din* (the religion/faith), creating and restoring a communion that is defined in an organic dual relationship, firstly, with the Creator, and secondly, among all His creatures.

**Umm Abdur Rahman Hirchfelder**

## The Rights of the Prophet Mohammad

**(Peace and Blessings of Allah be upon him!)**

There is no doubt that the first right of our Prophet (Peace and blessings of Allah be upon him!) is to believe in him and in the Message he was sent with. Allah says: "Therefore, believe in Allah and His Messenger (Muhammad), and in the Light (this Qur'an) which We have sent down." (Surah 64:8) Hence, to believe in the Prophet (Peace and blessings of Allah be upon him!) means to live under the God's

commands. To believe in the Prophet (Peace and blessings of Allah be upon him!) is much more than a simple recognition of the fact that he is a Prophet. Another right that belongs to our beloved Prophet (Peace and blessings of Allah be upon him!) is that we have to obey him. Allah says: "O you who believe, obey Allah and His Messenger!" (Surah 8:20) The love for the Prophet (Peace and blessings of Allah be upon him!) is an obligation that is followed with a great reward. To hold in high regard the Prophet (Peace and blessings of Allah be upon him!) means to honor his family, too. A very important right of the Prophet Muhammad (Peace and blessings of Allah be upon him!) is to follow him, to love him, to respect him, to judge according to his Shariah and to send him salawats and salaams.

**Abduldaem al Kahiil**

## Scientific Arguments from the Qur'an IV

In this article are included some scientific arguments from the Qur'an, such as: *The Clouds and the Lightning, The Location of the Stars, The Stars that Explode, the Cosmic Smoke, The Black Holes, the Night Covers the Day, the Bees and the Sleep, The Sea on Fire, The Pillars of the Mountains, the Moon is Rent Asunder, Healing through the Colors etc.*

**Vullnet Merja**

## The Morality in the Qur'an

The morality is one of the significant issues of the Qur'an. It has been among the highest intentions of the Prophets, because if there was not morality, the human life would become a hell and it would disappear. The man is a man, in the full sense of the word, only through his morality, otherwise it would turn into a missing animal.

The mission of the prophets in general, and their seal in particular, of the prophet Muhammad (Peace and blessings

of Allah be upon him and his family!) has been the purification, teaching and the education of the people. This sublime mission is clarified to us through the Last Word of Allah revealed to Prophet Muhammad, the Holy Qur'an. In this article you will read about **endurance** or **patience**, as a confronting force so that the man would not be impinged by anger, stress and depression, as well as you will read about the **hastiness**. There is no doubt that the deprivations that befall a man, a family, or a society due to hastiness are so numerous that it is difficult to define them. The Holy Qur'an orders and advises people for a genuine, authentic program in their lives. He advices them not to be hasty in words and deeds and to study the lives of the prophets, the leaders and their people, in order to get acquainted with the damages of the hastiness or being impulsive.

**Xhemal Balla**

## The Human Personality in the Light of Qur'an

Personality includes individual human characteristics, religious beliefs, concerns and interests in life, ability to face them, special inclinations and the character. Everyone occupies a certain place in the family and in the society. It is important the role that everybody plays in completing the assigned task. Islam, from this standpoint, pays special attention to interpersonal relations by the constitutional article of the Holy Qur'an **"All the believers are brothers."** The education of man with the lessons of the Qur'an and prophetic tradition enriches the spiritual feelings that becomes the basic regulator of his behavior and provides active relationship with the living reality. Faith to God determines all the psychic personality of the believer, his behavior and his attitude in life, at work and elsewhere, as well as the targets in the active life

position. Individual personality features provide explicit conduct and activities related to mental process, including the intellectual, cognitive and observational skills, the qualities of thinking, speaking, volition etc.

**Hajri Shehu**

## About Swearing Solemn Oaths in the Qur'an

There are many verses in the Qur'an that start with solemn oaths. They are swearings of Allah. Allah, the Creator of the Universe and everything he has in the universe swear solemn oaths. Allah, The Most Mighty, the Most Majestic reveals before the man His solemn oath. There does not exist any better persuasion for man: I am your Lord. Your Lord swears for what He says. Then, just trust in me and follow my Word! Your Lord swears for what He says. Then, don't you believe, yet?! Prophet Muhammad (Peace and blessings of Allah be upon him!) swears a solemn oath in Allah: ***"By my Lord! (it / The Hour of Judgment will come ... ").*** (34:3) And: "***Say (O Muhammad ): "Yes! By my Lord, you will certainly be resurrected...)"*** (64:7) Even the Prophet Ibrahim (Abraham) (Peace be upon him!) swears a solemn oath in Allah***: "And by Allah, I shall plot a plan (to destroy) your idols after you have gone away and turned your backs."*** 21:57) It is the solemn oath against idolaters. Swearing a solemn oath in Allah is asked by the Prophet

Ya'qub (Peace be upon him!): ***"I will not send him with you (Joseph) until you swear a solemn oath in Allah".*** (12:66) The believers require and perform the swearing of solemn oaths in Allah because the believers need Him. Because they need to worship Allah and Allah alone, because, as the Qur'an teaches us, the need for Allah, the fear of Allah and the hope in Allah is a part of human nature.

**Hajri Mandri**

# To Further Recognize the Qur'an

## The Aesthetic Discourse in the Qur'an

Parabolical[1] speech is a Qur'anic discourse feature, a particular figurative style. From its content parables specifically appear in the Qur'an, as a precondition of the tidings that come after. In fact, the information comes after parable or allegory.

Aesthetically, people consider the parables as beautiful, nice and short stories. Parable is the basic figurative means that is used in the Qur›an. The examples, comparisons, symbols are endless and they create the allegorical system of the Qur›an that explains us that parables and allegory are a specimen that come from the Qur'anic literature and as such, the resources and its origins must be requested in those tidings. Even Qur'anic narratives, in all cases of gatherings are provided and interpreted in an oral manner. They become strong messages in the pulpits of the religious festivals and rituals, being enriched with parables. A Qur'anic verse says: **"And indeed We have put forth for men, in this Qur'an every kind of similitude in order that they may remember."**[2] Here, it is prescribed in a comprehensive manner the parable function, as a resemblance example. With a concise

linguistic structure and with a few sentences it presents the information and the argument.

## Qur’anic Heritage to Albanians
### Surah Al-Ghashiyah

Here you will read **Surah Al-Ghashiyah**, taken from the Qur’an, a translation with commentary in Albanian, authored by Sherif Ahmeti.

**Surah al- Ghashiyah** brings forth arguments for indispensable necessity for religious belief and they are focused on two main points as follows:

-arguments documenting the power of God, the creator, and enumerates some of them,

-the facts documenting that this existence will come to its end, and its calamity would be terrifying.

## The Prophet Hud (Peace be upon him!)

In this article is presented the history of the Prophet Hud (Peace be upon him!). The people of Hud (Peace be upon him!) was swept over by a windstorm and destroyed. Those few people who survived together with Noah (Peace be upon him!), began to increase in number. It is worth mentioning that they all were monotheists, who worshiped and believed only one God. But with the passing of time, idolatry started to spread again among the Ad tribe. As a result of disbelief of this people, God Almighty sent the Prophet Hud. Hud reminded them of the bounties and blessings that God had bestowed them. Hud started to challenge them. God’s punishment for the nation was a windstorm that was never seen before throughout the human history.

**Qani Banaj**

# The Honey

The honey is widely used as a food and medication. The honey comes refined through the bee glands, which are rich in various enzymes. Allah has granted the honey to the humans for their needs, as food as well as a medication. Honey is advisable in some treatments, such as the use in the stings or insect bites, the use in arthritis, treatment of the hair loss, treatment of bladder infections, treatment of cholesterol problems, the use in infertility (sterility) and in the dermatological treatments (exanthema/acne), treatment of cancer disease, the bad-smelling of the mouth or the ulcerous stomach etc.

**Hoxha Tahsin**

# The secrets of water

In this article we will introduce some of the secrets of water. Why it is called the essential element? What does the essence of water contain? Old philosophers have claimed that the full structures, such as the wildlife and the plants, and the deficient structures, such as the mists and the like, are composed of four basic elements which are: the fire, the air, the water and the earth. This is precisely called the theory of the four elements.
They have called the water the basic element because of the monopoly it holds in the visibility of things, whereas they did not know it's essential composition.

# ملخصات

## مفهوم الحب لله

مفهوم الحب لله والخيرات التي يجلبها هذا المفهوم في المجتمع البشري هو مشترك لجميع الأديان في التراث الإبراهيمي. علاوة على ذلك، إنه مشترك بين التقاليد الروحية البشرية حول الأسس الفلسفية المرتبطة بمفهوم محبة الله. "الحب" في التعاريف – حسب الأفكار والممارسات الإسلامية – يعرض تطهيراً (تحسيناً) للمفهوم في وئامٍ مع تحقيق رسالة الله إلى البشرية. "الحب" لا يُرى هنا كمفهوم مجرد يقتصر على العلاقة بين الخالق والخلق، بل إنه يحمل ثِقْلَ فهمٍ كاملٍ للدين، مكوّناً وواضعاً لمجتمع محدودٍ في علاقة مزدوجة العضوية، مع الخالق أولاً، وبين مخلوقاته ثانياً.

أم عبد الرحمن هرتشفَلْدَر

## حقوق النبي (عليه الصلاة والسلام)

ليس هناك شك في أن أول حقوق نبينا (صلى الله عليه وسلم) هو أن نؤمن به وبالرسالة التي أرسل بها. قال تعالى: "فئامنوا بالله و رسوله و النور الذى أنزلنا (سورة التغابن، الآية ٨). إذن، أن تؤمن بالنبي (صلى الله عليه وسلم) يعني أن تعيش في ظل ولاية الله. أن تؤمن بالنبي (صلى الله عليه وسلم) هو أكثر بكثير من مجرد الاعتراف البسيط بحقيقة أنه نبي. حقٌّ آخر لنبينا الحبيب (صلى الله عليه وسلم) هو أن نطيعه. قال تعالى: " يَا أَيُّهَا الَّذِينَ آمَنُوا أَطِيعُوا اللَّهَ وَرَسُولَهُ ..." (سورة الأنفال، الآية ٢٠). حب النبي (صلى الله عليه وسلم) واجب يأتي بثواب عظيم. أن تؤمن بالنبي (صلى الله عليه وسلم) يعني أيضاً أن تحترم أهله. ومن الحقوق المهمة جداً للنبي محمد (صلى الله عليه وسلم) أن تصلي وتسلم عليه.

عبد الدائم الكحيل

## أدلة علمية من القرآن (٥)

تتضمن هذه المقالة بعضَ الحجج العلمية من القرآن، مثل: السحاب والبرق، ومواقع النجوم، والنجوم التي تنفجر (تنتثر)، والدخان الكوني، والثقوب السوداء، والليل يغشى النهار، والنحل والنوم، والبحر التي تسعّر، والجبال كالأوتاد، وانشقاق القمر، والمعالجة بالألوان، إلخ.

وُلْنَتْ مَرْيا

## الخُلُق في القرآن الكريم

الخُلُق من الأمور المهمة في القرآن. لقد كان الخلق واحداً من أسمى أهداف الأنبياء، وذلك لأنه لو لم يكن الخلق موجوداً لأصبحت حياة الناس جحيماً ولاندثرت. يكون الإنسان إنساناً بكل معنى الكلمة من خلال أخلاقه فقط، وإلا لكان حيواناً ضالاً.

لقد كانت مهمة الأنبياء عموماً ومهمة خاتمهم – النبي محمد (صلى الله عليه وسلم) – خصوصاً، تطهيرُ الناس وتعليمُهم وتربيتُهم. وهذه المهمة العظيمة توضحها لنا كلام الله الأخير، القرآن الكريم الذي أُنزِل على النبي محمد (صلى الله عليه وسلم). ستقرؤن في هذه المقالة عن الصبر كقوة مواجهة، كي لا يُضرَبَ الإنسان بالغضب، والإجهاد، والاكتئاب، وستقرؤون عن التسرّع أو العجلة أيضاً. لا شك بأن الخسائر التي تصيب إنساناً، أو أسرة، أو مجتمعاً بسبب التسرع عديدةٌ بحيث يصبح من الصعب تحديدها. لذلك نجد القرآن الكريم يعظ الناس وينصحهم بوضع برنامج حقيقي لحياتهم. إنه يعظهم بعدم التسرع في أقوالهم وأفعالهم، وأن يدرسوا حياة أنبيائهم وقادتهم وشعوبهم من أجل التعرّف عن كثب على أضرار التسرّع أو العجلة.

جمال بالا

## شخصية الإنسان في ضوء القرآن الكريم

تشمل الشخصيةُ خصائصَ الإنسان الفردية، والمعتقدات الدينية، ومصالح الحياة، والقدرة على مواجهتها، وتشمل الاتجاهات الخاصة والطابع أيضاً. فكل شخص يترك مكاناً معيناً في الأسرة، وكذلك في المجتمع. المهم هو الدور الذي يؤديه كل إنسان في المهمة الموكلة. والإسلام، في هذا الصدد، يولي اهتماماً خاصاً للعلاقات الشخصية من خلال المادة الدستورية من القرآن الكريم: "إنما المؤمنون إخوة". فتربيةُ الإنسان بتعاليم القرآن والسنة النبوية يثري المشاعر الروحية، التي بدورها تصبح المنظّم الأول لسلوكه، والتي تضمن له علاقةً نشطةً مع الواقع الذي يعيشه. الإيمان بالله يحدد كل النشاط النفسي لشخصية المؤمن، سلوكه وموقفه في الحياة، في العمل وفي أماكن أخرى، وكذلك أهدافه في موقفه الحيوي النشط. خصائص الشخصية كفَرْدٍ توفر سلوكيات وأنشطة صريحة تتعلق بالعملية العقلية، بما في ذلك القدرات الفكرية والمعرفية والرصدية، وميزات التفكير والتحدث والإرادة، إلخ.

خيري ماندري

## لنتعرف أكثر على القرآن
## جمالية الخطاب في القرآن

من ملامح الخطاب القرآني التحدّث بالأمثال، وهو أسلوبٌ مجازيٌّ فريد. من حيث المحتوى، تظهر الأمثال، في القرآن تحديداً، كشرط مسبق للخطاب الذي يأتي بعدها. في الواقع، الخطاب يأتي بعد المثل.

جمالياً، الناس يقبلون الأمثال كقصص قصيرة، ولطيفة، وجميلة. المثَلُ هو بمثابة الأداة المجازية الأساسية التي تستخدم في القرآن. لا تنتهي الأمثلة والمقارنات والرموز التي تبني النظام المجازي في القرآن والتي تخبرنا أن المقارنة والمثَل نوعٌ أدبي

يأتي من الأدب القرآني. بالتالي، فمواردُها وأصولها ينبغي أن تُبْحَثَ خصوصاً في تلك الخطابات. حتى القصص القرآنية، تُسرَد وتُفَسّر شفوياً في جميع التجمعات. إنها، أي القصص، تُخصَب بالأمثال وتصبح رسائل قوية على المنابر أثناء العبادات والأعياد الدينية. هناك آية قرآنية تقول: "وَلَقَدْ ضَرَبْنَا لِلنَّاسِ فِي هَٰذَا الْقُرْآنِ مِنْ كُلِّ مَثَلٍ لَعَلَّهُمْ يَتَذَكَّرُونَ" (سورة الزمر، الآية ٢٧). هذا نص واضح على وظيفة المثَل كنوع من التشبيه. إنها تقدم الخطاب والحجة بواسطة هيكل لغوي دقيق ومن خلال بعض الجمل.

## التراث القرآني عند الألبانيين

سورة الغاشية

سوف تقرؤون هنا سورة الغاشية، والتي أُخِذَتْ من "القرآن، وترجمة معانيه إلى اللغة الألبانية"، للكاتب شريف أحمتي.

سورة الغاشية تأتي بأدلة عن الحاجة الماسة للإيمان، وتركزها على نقطتيْن أساسيتيْن على النحو التالي:

– الآيات التي تشهد على قدرة إلهٍ خالقٍ، هو الله، وتعدّ عدةً منها،

– الآيات التي تشهد على أن هذا الوجود له نهايته، ولكن القيامة سوف تكون رهيبةً.

على محمد على الدحيل

## النبي هود (عليه السلام)

في هذه المقالة قصة النبي هود (عليه السلام). لقد ضربت العاصفةُ قومَ هود (عليه السلام) ودمرته. بدأ القليل من الناس الذين نجوا مع نوح (عليه السلام) يزدادون. والجدير بالذكر أن جميعهم كانوا موحّدين، يعبدون إلهاً واحداً ويؤمنون به. لكن مع مرور الوقت، بدأت عبادة الأصنام تنتشر في قبيلة عاد مرة أخرى. ونتيجة لكفر هؤلاء الناس أرسل الله سبحانه وتعالى النبي هود (عليه السلام).

ذكر لهم هودٌ فضل الله ونعمه التي أنعمهم بها. بدأ هود يتحدّاهم. وكان عقاب الله لهذا القوم عاصفة ريح التي لم يكن لها مثيل في التاريخ البشري كله.

تشاني باناي

## العسل

العسل له استخدام واسع كغذاء وكدواء. يستخرج العسل مكرراً من خلال غدد النحل، والتي هي غنية بالعديد من الإنزيمات. وقد وهب الله العسل للبشر لاحتياجاتهم كغذاء وكدواء. ينصح باستخدام العسل في بعض الحالات: كاستخدامه بعد لدغ الحشرات، واستخدمه في التهاب المفاصل، واستخدامه في سقوط الشعر، واستخدامه في التهابات المثانة، واستخدامه في مشكلات الكولسترول، واستخدمه في حالات العقم، والاستخدم الدَرْماتولوجي (في الحبوب)، واستخدامه للسرطان، واستخدامه لإزالة رائحة الفم الكريهة، واستخدامه في قرحة المعدة، إلخ.

حوجا تحسين

## أسرار الماء

في هذه المقالة ستتعرفون على بعض أسرار الماء. لماذا يُدعى العنصرَ الأساسي؟ علامَ يحتوي جوهرُ الماء؟ زعم الفلاسفة القدماء أن المركّبات الكاملة مثل الكائنات الحية والنباتات، وحتى المركبات الناقصة مثل الضباب وما شابه ذلك، تتألف من أربعة عناصر أساسية وهي النار، والهواء، والماء، والتراب. هذا ما يسمى بالضبط نظريةَ العناصر الأربعة.

سَمُّوا الماء عنصراً أساسياً بسبب احتكاره على رؤية الأشياء، مع أنهم لم يعرفوا تكوينه الأساسي.

## المعجم القرآني

إبليس

كلمة "شيطان" تأتي من كلمة "شطن"، التي لها بعض المعاني اللغوية: لها معنى الحبل، والانحراف، والبعيد (أو المبعَد)، والمعارض. فأولئك الذين يتبعون طريق الشيطان يُدعَون "شياطين" والتي هي صيغة الجمع للكلمة "شيطان" (إبليس). يقول الله تعالى في القرآن الكريم: "... إِنَّا جَعَلْنَا الشَّيَاطِينَ أَوْلِيَاءَ لِلَّذِينَ لَا يُؤْمِنُونَ (سورة الأعراف، الآية ٢٧). إنه أقسم أنه سيغوي بني آدم إلا الصادقين لله والمخلَصين. يقول الله تعالى في القرآن الكريم: " قَالَ فَبِعِزَّتِكَ لَأُغْوِيَنَّهُمْ أَجْمَعِينَ إِلاَّ عِبَادَكَ مِنْهُمُ الْمُخْلَصِينَ " (سورة ص، الآية ٨٢-٨٣).

**نور قرآن**

فصلنامه علمي قرآني

صاحب امتياز: مؤسسه قرآن كريم آلباني

مدير مسئول: شيخ وُلْنَتْ (عباس) مريا

سردبير: پروفسور دكتر خيري شهو



**اعضاي هيئت تحريريه:**

پروفسور دكتر بدري بولوكو

پروفسور دكتر فتحي مهديو استاد دانشگاه پريشتينا (كوزوو)

حاج افندي سليمان رجبي – رئيس مشيخه اسلامي كشور مقدونيه

حاج سليم اصطفى

خانم صبريه فزا

حاج يتمير چيلا



**ويرايش ادبي:** خانم ليسيدا راماي

**صفحه آرايي:** خانم صبريه فزا

شماره: ۲۰۱۴/۱ (۲۸)

# KUJTESË PËR AUTORËT

Revista pranon me kënaqësi bashkëpunimin e të gjithë teologëve e të studiuesve të Kur'anit dhe të fushave të tjera të shkencës. Prandaj, janë të lutur autorët që të sjellin në redaksi artikuj studimorë që kanë të bëjnë me Kur'anin dhe kur'anologjinë.

Që të shqyrtohen artikujt nga redaksia, autorët janë të lutur të ndjekin udhëzimet e mëposhtme:

● Shkrimi nuk duhet të jetë më shumë se 10-12 faqe kompjuteri, bashkë me një abstrakt.

● Është e detyrueshme gjuha shqipe standarde.

● Nuk pranohet zëvendësimi i shkronjave ë dhe *ç* me e dhe *c*.

● Të mos përdoret shkronja e madhe i aty ku nuk duhet.

● Midis shenjës së pikësimit dhe fjalëve pasardhëse të lihet vetëm një hapësirë.

● Citimet në tekst të jepen me shkrim të pjerrët.

● Referencat në tekst të jepen me numra arabë dhe të numërohen sipas rendit që citohen. Ja, si mund të ishte një shembull citimi: Shih M. Golshani, *Kur'ani i Shenjtë dhe shkencat e natyrës*, Tiranë, 2007, f. 73. Librat e pabotuar e dorëshkrimet nuk citohen, por mund të jepen në tekst në kllapa.

● Artikulli të jetë i radhitur në "Word" dhe të dorëzohet në CD, USB ose të dërgohet nëpërmjet postës elektronike (e-mail): (f_quran114@yahoo.com).

● Shkrimi nuk duhet të jetë botuar askund tjetër.

● Shkrimi nënshkruhet nga autori dhe jepet adresa e plotë, numri i telefonit dhe e-maili.